


HEJZA



Khahid Bushati, shkrimtar

LETËRSIA PËR FËMIJË ËSHTË MISION...

Nën thjerrë

KULTURA NË KAZANIN POLITIK SHQIPTAR

A e di kryeministri "historik" shqiptar i Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, se kohë më parë u publikua një Program vjetor për kulturë, i cili me gjasë do të ngelë më diskriminuesi për shqiptarët dhe, historikisht më i padebatueshmi nga vetë shqiptarët për këto tri dekada jetë pluralizmi?



Nga Avni HALIMI

Më vitin 2007, ish-kryeministri i Maqedonisë së Veriut, N. Gruevski, një javë pas shpalljes së Programit vjetor për kulturë, e shpalli "program të manipuluar" dhe, urdhëroi ribërje të tij! Mediat maqedonase nuk po mund të pajtoheshin që garnitura shqiptare që po drejtonte për herë të parë këtë ministri, -Programin e paskëshin bërë sallatë, lakra-lakra, duke ndarë buxhet për projektet kulturore shqiptare më shumë se sa "Marrëveshja e Ohrit", që për shqiptarët garantonte jo më shumë se 25 për qind! Atë vit, për herë të parë u vendos që nga buxheti i përgjithshëm për kulturë, për shqiptarët të ndahen 25përqind, ndërsa segmentet nacionaliste maqedonase këmbëngulnin që të ndahen 25 për qind nga buxheti i caktuar nëpër sektorë, kurse kishte shumë sektorë ku shqiptarët nuk mund të konkurronin apo ku nuk kishin asnjë projekt!

Ofendimi me "Program" i kulturës shqiptare

A e di kryeministri "historik" shqiptar i Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, se kohë më parë u publikua një Program vjetor për kulturë, i cili me gjasë do të ngelë më diskriminuesi për shqiptarët dhe, historikisht më i padebatueshmi nga vetë shqiptarët për këto tri dekada jetë pluralizmi? Thjesht, a e di kryeministri i parë "historik" shqiptar se inaugurimi i tij u përcoll me publikimin e Programit vjetor për kulturë që është tepër shumë ofendues për kulturën shqiptare! Profesorët, intelektualët, krijuesit, kulturologët shqiptarë të Maqedonisë së Veriut - të gjithë heshtën, nuk e thanë asnjë fjalë, as më të voglin shqetësim, ndërsa ka pasur syresh që kanë intervenuar dhe kanë shprehur shqetësim për (mos)kallimin e projekteve maqedonase nga "komisionarët" shqiptar! Të gjithë personalitetet akademike, të gjithë ata të thirrur e të vetëthirrur për të bërë art, letërsi e kulturë shqiptare në RMV - të gjithë "u shtangën" kur kuptuan se kjo ministri kishte ngelur pa zv./ministrin shqiptar! Të gjithë këta "poçarë" të kulturës, u mrekulluan kur kuptuan se sekretari shtetëror i

kësaj ministrie qenka emërtuar drejtor i Qendrës kulturore maqedonase në Stamboll! Që të gjithë këta "akademikë", profesorë, intelektualë, krijues, ranë në delir nga "kënaqësia kombëtare" sapo morën vesh se një shqiptar i Maqedonisë së Veriut do t'i pasurohet CV-ja me suksesin personal në uljen e kolltukut të kryeministrit jo të votuar, jo të zgjedhur, por të ujdur, të cilin sukses madje e shitën si "sukses historik" të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut! U kuptua, të gjithë intelektualët, krijuesit e kulturologët shqiptarë të RMV-së qenë në ethe të pritjes se cili do të fitojë në duelin irracional në mes Taravarit dhe Selës, se cili do të dalë më vmro-istë e cili më lsdm-istë! I gjithë ky komunitet butakësh heshti dhe nuk "lejo" të konfrontohen as me "pozitën" e as me "opozitën", nuk "lejo" të fëlliqet në asnjë tabor, sepse që të dy taboret ishin me llupë në dorë dhe, nëpër këta butakë, po kërkonin kandidat për "president të RMV-së"! Pse të kundërshtohet Programi vjetor për kulturë, pse të humbet shansi për të qenë i përzgjedhur për garën për president shteti! Pra,

dalja me kaq vonesë e Programit vjetor për kulturë që tempuar për këtë periudhë pikërisht pas analizimit maqedonas të kazanit politik e intelektual të shqiptarëve të mbushur me lloj-lloj interesash meskine e të dëmshme për kombin shqiptar! Heshtja makabre e shqiptarëve po e vërteton këtë sjellje të politikave nacionale maqedonase. Tash e tutje do të kemi një Program për kulturë i cili do të shërbejë si model për vitet e ardhshme! Në të ardhshmen do të thonë: për kulturën shqiptare u nda po aq sa vitin e kaluar kur kjo ndarje ishte ideale për vetë ata! Për pasurimin e CV-ve personale të njerëzve, të cilët jashtë çadrave partiake do të dukeshin si pulat e lagura në shi, po flijohet një "strategji", e cila, ndonëse jo institucionale, ndonëse jo si program kombëtar, megjithatë kishte krijuar një bazë të shëndoshë për avancimin kulturor të shqiptarëve në këtë shtet. Tash e tutje nuk do ta kemi, sepse edhe kulturë edhe kryeministër historik shqiptar, do të ishte shumë për shqiptarët!

Analfabetët funksionalë në kulturë

Një prej zërave të buxhetit vjetor të Ministrisë së Kulturës në RMV është zëri i investimeve kapitale, nga i cili shqiptarët "fitojnë" pothuajse zero për qind! Buxheti i këtij zëri shërben për rinovime, meremetime, por edhe për ndërtime të reja. Ministria e Kulturës ndërton strategji për investime kapitale, apo edhe i merr parasysh shumicën e kërkesave që vijnë nga qytetet dhe komunat e ndryshme të vendit, kryesisht për meremetim apo edhe për konservim të objekteve të vjetra të shtëpive apo qendrave kulturore, për renovim të skenave, për shtim-aneks të objekteve ekzistuese, për ndreqje të kulmit, për ndërrim të dritareve, madje edhe për ndërtim të qendrave për kulturë. Natyrisht, ky zë i buxhetit del të jetë shumë më i madh se tërë buxheti për aktivitete kulturore. Shqiptarët në Qeveri, shqiptarët në Parlament, shqiptarët në pushtet lokal; shqiptarët në pozita të larta në Ministrinë për Kulturë në RMV: me zëvendësministër e me sekretar shtetëror, me mbi 50 administratorë të punësuar nëpër sektorë e njësi të ndryshme! Asnjë reagim e asnjë shqetësim publik për këtë diskriminim kulturor të llojit të apartheidit! Apo ndoshta, në rastin konkret, kjo heshtje e shqiptarëve (në të gjitha nivelet) flet për analfabetizmin funksional në sferën e kulturës! A e dinë shqiptarët e Qeverisë, të Kuvendit, të pushtetit lokal, shqiptarët e Ministrisë së Kulturës, shqiptarët intelektualë e akademikë të institucioneve të ndryshme kulturore e arsimore se vetëm për sallën e re të Shtëpisë përkujtimore të ASNOM-it (KAÇPM) në Dellçevë, Ministria e Kulturës në fillim të këtij viti ndau 9.6 milionë denarë, buxhet ky gati sa ai i ndarë për botimet, artin pamor dhe për aktivitetet kulturore amatore të shqiptarëve të Maqedonisë! Tutje, po në fillim të këtij viti, ministrja e kulturës nënshkroi marrëveshje me kryetarin e Komunës së Vevçanit për ta përkrahur financiarisht Karnavalin kontravers të kësaj komune me 1.8 milionë denarë, ndërsa njërin prej festivaleve më të vjetër në Maqedoninë e Veriut, "Teatri Shqiptar në Maqedoni" që mbahet në Dibër, ku marrin pjesë dhjetëra trupa teatrale shqiptare, financohet me 3-400 mijë denarë! Në fillim të vitit 2024, në Qeveri, ministrja për kulturë nënshkroi edhe marrëveshjen për Programin për shfrytëzimin e subvencioneve kapitale nëpër komuna, me qëllim për ta zhvilluar identitetin kulturor lokal. Subvencionet kapin shifrën mbi 50 milionë denarë! Dhe, për vitin 2024 nga kjo shumë do të përfitojnë 11 komuna maqedonase, si: Manastiri, Krusheva, Krivogashtani, Velesi, Çashka, Dojrani, Demir Kapia, Bogdanci, Mavrova dhe Rostusha, Dellçeva si dhe Çuçer Sandeva! Sipas ministres, për këto dy vite të fundit, Ministria e Kulturës ka ndarë mbi 90 milionë denarë (mbi 1.5 milionë euro) edhe atë "për zhvillim të barabartë kulturor të vetëqeverisjes lokale"! Asnjë projekt apo iniciativë për themelimin e qendrave kulturore shqiptare nëpër komuna që drejtohen prej shqiptarëve: në Çair, në Haraçinë, në Saraj, në Likovë, në Dollnen, në Bogovinë, në Tearcë, në Zhelinë, Vrapçisht, Studenican, në Zajaz etj. Qendrat kulturore i mbled-

hin të rinjtë, i nxjerrin në pah afinitetet dhe talentet kulturore në mesin e të rinjve, zhvillojnë identitetin e tyre kulturor, përgatisin kuadro për asociacione kulturore profesionale! Fundja, kjo dukuri nuk është se duhet t'i brengosë maqedonasit, qoftë si popull, qoftë si drejtues të institucioneve shtetërore. Kjo brengë duhet të jetë ekskluzivisht e shqiptarëve të cilët më me ëndje e kanë të mrizojnë nëpër dikastere qeveritare e nëpër funksione shtetërore se sa t'i ngrënë kulturalisht shqiptarët e Maqedonisë. Vetëm në këtë pozitë të mjerë, shqiptarët do të jenë në gjendje që të votojnë për analfabetët e tyre funksionalë në rrafshin kulturor, të cilët, do t'i rehatojnë nëpër pozita e funksione, ku në vend të identitetit kombëtar, prioritet i jepet identitetit shtetëror: këta janë funksionarët tanë maqedonas që nuk mund (nuk dinë dhe nuk duan!) të bëjnë asgjë për identitetin kulturor shqiptar!

Heshtja si "ves nacional" para diskriminimit

Sa jemi të singertë, fillimisht si institucione shtetërore e pastaj edhe si njerëz të kulturës, kur themi se ministria përkatëse, nisur nga Programi vjetor për kulturë, ka financuar projekte që janë me interes nacional! Nisur nga praktikat e deritanishme, katërçipërisht dëshmohej se ne as që e dimë se çfarë është interes nacional! As që kemi shprehur më të voglin reagim, qoftë si subjekt juridik e qoftë si subjekt fizik, apo edhe si pushtet lokal, kundër të gjithë atyre që manipulojnë me këtë nocion, por dhe kundër atyre që lejojnë tallje me interesin nacional! Le të ndalemi vetëm te sektori i veprimtarisë teatrore, te kjo veprimtarë që në botën e civilizuar konsiderohet si vlerë estetike që shpërfaq nivelin aristokrat të popullit! Për vitin 2024 Ministria e Kulturës na paskësh kaluar 53 projekte të institucioneve lokale, të subjekteve fizike si dhe 15 manifestime teatrore të institucioneve lokale dhe të subjekteve fizike. Gjithsesi, në Programin vjetor nga kjo veprimtari janë përfshirë edhe 25 institucione nacionale me gjithsej 64 projekte teatrore si dh 9 manifestime teatrore të institucioneve nacionale! Nga ky numër i projekteve del se në Maqedoninë e Veriut për vitin 2024 do të kemi 24 manifestime, që i bie në çdo dy javë nga një manifestim! Ose, 117 vepra dramatike, që i bie gati në çdo të tretën ditë nga një shfaqje! Në shikim të parë, ky rezultat i Ministrisë për Kulturë është mjaft impresionues (!), serioz dhe sfidues në të mirë të interesit nacional! Por, sapo të hulumtohen shumata e ndara për këto projekte teatrore, sakaq do të vërehet se diçka nuk është në rregull! Në pah del amatorizmi, tallja, përçmimi i këtij "arti të aristokracisë", loja jo e ndershme që bëhet me artistë, autorë, regjisorë dhe me të gjithë ata që angazhohen rreth përgatitjes së një shfaqje. Ndarja e buxhetit për secilën shfaqje apo manifestim sipas logjikës së kësaj ministrie, flet për një gjest qesharak që mund të manifestohet vetëm nga analfabetët funksional! Kjo flet se në këtë ministri nuk mbahet llogari për vlerën, nuk mbahet llogari për mundin autorial si të autorit ashtu edhe të regjisorit, nuk mbahet llogari për aktrimin, për ekipin që mundëson

lojën teatrore. Mbase kanë shpikur ndonjë aparat llogaritës në të cilin e fusin projektin dhe vetë aparatit ua nxjerr se akcili projekt teatror duhet të financohet me, për shembull, 175.665 denarë, apo me 148.151 denarë, apo me 100.276 denarë aq sa është vlerësuar manifestimi teatror i "K'tu fest" që mbahet në Strugën turistike! Në çdo shumë të ndarë, kemi edhe para të shkoqura deri në 1 denarë, 5 denarë, 4 denarë, 6 denarë etj! Dhe, me këtë "singëritet" ministrja disa herë u mburr për transparencën që paskan përdorur kësaj radhe! Ndarja e buxhetit në këtë formë, me këtë "makinë llogaritëse" jo që është qesharake, por është edhe ofenduese, poshtëruese dhe, mbi të gjitha, alarmante për botën e artistëve! Për çfarë kujdesi për interesin nacional mund të flasim nëse një festival teatrorshqiptarfinancohetmevetëm 100 mijë denarë dhe pjesa tjetër e shkoqur sa 3 red bulla! Cila shfaqje teatrore e subvencionuar me 83 mijë denarë paraqet angazhim për interesin nacional? Një ekip solid (shfaqja është art ekipor) që angazhohet minimum 60 ditë resht për ta realizuar një shfaqje që paguhet me 83.119 denarë?! Ministria për Kulturë këtë ekip e ka paguar vetëm nga 1.5 litër coca cola në ditë! Me lëmoshë nuk bëhet art, me lëmoshë nuk tregohet serioziteti i dikasterit shtetëror për kulturën për interesat nacionale. Tjetër është problem më vete ndikimin partiak në subvencionimin e projekteve! Bartësit e projekteve që janë më afër pushtetit natyrisht që paguhet "më mirë", ndërsa të tjerët trajtohen si pacienti me serum në prag të dhënies shpirt! Ndërsa habit pikërisht heshtja e këtyre "kulturogëve sizifianë", të cilët, përçdo vit të lume e përjetojnë të njëjtin injorim institucional! Si është e mundur që "festivalet" e mbira si kërpudhat pas shiut të financohen me miliona denarë, kurse Festivali Teatror i Dibrës, i cili është ndër festivalet më të vjetra në Maqedoninë e Veriut, tash e mbi 20 vite vazhdimisht financohet me shumë qesharake! Në këtë Festival çdo vit marrin pjesë dhjetëra trupa teatrore shqiptare, ndërsa me buxhetin që ndanë ministria nuk mund t'u sigurohet pjesëmarrësve as nga një gotë ujë minerali! Këtë diskriminim të hapur e hesht drejtorja e Manifestimit, e hesht pushteti lokal, e hesht bota artistike shqiptare! Të gjithë heshtin sepse u vije keq që t'ua prishin komoditetin pushtetarëve. Dhe, s'duhet të habitemi nëse kjo heshtje para diskriminimit të shndërrohet në ves nacional!

"Heshtje mortore" në muze

Këto ditë kryeministri i parë shqiptar në RMV, Talat Xhaferi, dhe ministrja për kulturë, Bisera Kostadinovska-Stojçvska, paskan dalë për një shëtitje propagandistike në zonë e Manastirit. Ministria shënon se kishin vizituar dy muzetë më të rëndësishëm në këtë qytet: IN "Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeu" – Manastir, si dhe IN "Muzeu i Alfabetit Shqip" – Manastir! Pa dyshim, muzetë janë strehë e vlerave të padiskutueshme të lashtësisë, të periudhave e të ngjarjeve të ndryshme që i japin përmbajtje identitetit të çdo et-

nie. Është detyrë shtetërore e kombëtare përkujdesja ndaj muzeve, është obligim shtetëror e kombëtar respekti ndaj këtyre institucioneve! Kryeministri i parë shqiptar i RMV-së mbase nuk e ka pasur pozitën shtetërore të përshtatshme për t'i vizituar muzetë, por ama e ka pasur pozitën shumë të rëndësishme për ta shprehur përkujdesin maksimal ndaj muzeve! Pa dyshim, nuk është hera e parë që e viziton Muzeun e Alfabetit Shqip në Manastir, porse është hera e parë që e viziton në cilësinë e kryeministrit, madje është hera e parë që e viziton së bashku me ministren për kulturë të RMV-së! Dhe, për çfarë i vizituan këto dy Muze shumë të rëndësishme, si për maqedonasit ashtu edhe për mbarë shqiptarët (dhe jo vetëm për shqiptarët e RMV-së, siç shprehet ministrja)? Vetëm sa për t'u fotografuar e për të pasur pamje që do të flasin se këtu, në Maqedoninë e Veriut funksionon bashkëjetesa, sidomos ajo bashkëjetesë që diktohet nga koalicioni qeveritar LSDM-BDI! Ky ishte qëllimi i kësaj vizite propagandistike? Pa dyshim, kryeministri dhe ministrja e kulturës (sikundër të gjithë qytetarët e vendit) duhet t'i vizitojnë institucionet nacionale dhe në cilësinë e funksionarëve të lartë, duhet të japin ndonjë deklaratë, pse jo, shpresëdhënëse! Çka tha kryeministri i parë shqiptar në RMV, Talat Xhaferi, kur hyri së bashku me ministren në Muzeun e Alfabetit Shqip? Si kryeministër, a pati ndonjë vërejtje, ndonjë premtim, ndonjë sugjerim, a shprehu ndonjë habit, ndonjë pakënaqësi kundër politikave nacionale maqedonase që këtë Muze ta nënçmojnë me dyqane brenda godinës së Muzeut? Ose, për shembull, a e dinte kryeministri i parë shqiptar i RMV-së se ministrja që e kishte në krah, për sivjet (2024) Muzeut të Alfabetit Shqip kishte ndarë vetëm 400 mijë denarë për programin vjetor? Muzeu i një ngjarje më të rëndësishme për kombin shqiptar, nga buxheti i përgjithshëm i Programit Vjetor të Ministrisë për Kulturë të RMV-së, ka shkuar për pjesën "e keq" që nuk kushton më shumë se 400 mijë denarë, ose 7 mijë e ca euro për aktivitet vjetor! Kurse Muzeut maqedonas në të njëjtin qytet ministria për vitin 2024 i ndau 1.940.000 denarë, apo rreth 330 mijë euro! Ministria dhe kryeministri i parë shqiptar në RMV, do të thoshin që këta dy Muze nuk mund të krahasohen dhe se tjetër peshë ka ai i muzeut nacional maqedonas! Megjithatë, është një institucion tjetër, madje lokal, "Muzeu lokal-galeria" në Kavadar, të cilit i është ndarë buxhet gati dyfishi i atij që i është ndarë si buxhet vjetor për Institucionit Nacional "Muzeu i Alfabetit Shqip" në Manastir! Kryeministri i parë shqiptar i RMV-së, nëse nuk do që të jetë "kryeministër teknik", atëherë do të duhej që me këto të dhëna të shkelte në Manastir dhe publikisht t'ia tërhiqte vërejtjen ministres për kulturë për buxhetin diskriminues ndaj kulturës shqiptare, ashtu siç u tregua "trim" në zyrat e policisë në Tetovë, pas së cilës ngjarje, vizitoi muzetë në Manastir sa për të propaganduar "bashkim-vëllazërimin" që diskriminon kulturën shqiptare.

Probleme shqetësuese

KUR PIRATËT E BOTIMEVE BËJNË KËRDINË!

Ndërsa botuesit piratë vazhdojnë të qetë punën e tyre të pistë, duke numëruar fitimet, botuesit seriozë përballen me rrezikun e falimentimit



Agim BAJRAMI

Në një nga panairët lokalë të librit, diku në Kosovë, një nga botuesit më të njohur në Shqipëri, në bisedë e sipër, na njohu me një nga shqetësimet e shumta, me të cilën përballlet ai dhe shumë shtëpi botuese këtej dhe andej kufirit tonë shtetëror, botimet pirate. Gjatë një vizite rutinë që botuesi në fjalë kishte bërë në disa nga libraritë e Prizrenit, kishte konstatuar jo pa dëshpërim se disa nga veprat e shkrimtarit tonë më të njohur I. K. (ekskluzivitetin e veprave të të cilit e gëzon vetëm ai), ishin kopjuar në mënyrën më të keqe dhe hedhur në treg pa pikë përgjegjësie nga pronarët e një shtypshkronje aty rrotull, pa bërë asnjë marrëveshje ose kontratë me të. Ishte një konstatim që nuk mund të kalonte pa debat, pasi një veprim i tillë prekte jo vetëm botuesin në fjalë, por edhe prestigjin e veprave të shkrimtarit të shquar. Vijimi i historisë më pas i ngjan një labirinti, ku hyn dhe s'ë gjen më udhën e kthimit. Meqë me njerëz të tillë nuk mund ta gjes

fjalën asnjëherë, dhe në mungesë të një zgjidhje tjetër, botuesi iu drejtua organeve përkatëse të drejtësisë. Bëri kallëzimin e duhur dhe priti muaj të terë. Logjika na e do se përballë një fenomeni të tillë organet e drejtësisë do të vënin në lëvizje reagimin, por për fat të keq edhe aty u ndesh me indiferencë skandaloze. Është e qartë se me krizën dhe korrupsionin që i karakterizon institucionet tona të drejtësisë, nuk mund të presësh ndonjë gjë të madhe prej tyre, por jo gjer në këtë nivel papërgjegjshmërie. Është afërmendsh, ata që mbyllin sytë përballë shkeljeve flagrante me ligjin dhe abuzimeve skandaloze me tenderë korruptive dhe milionave të vjedhur, nuk mund të shqetësohen dhe të vihen në lëvizje për "çështje kaq të parëndësishme" për ta, siç është kjo e abuzimit me të drejtat e autorit. Duke u njohur me shembujt e panumërt të abuzimeve që kanë ndodhur dhe vijojnë të ndodhin në këtë fushë, s'është e vështirë të krijojmë një ide se në çfarë gjendje është katandisur kjo e drejtë e tyre në vendin tonë. Është kjo fry-

më tolerance dhe indiference e pa precedent, që fenomeni i piraterisë së botimeve të jetë në ditët e tij më të mira, duke sfiduar me këmbëngulje ligjin dhe drejtësinë. Ndërsa botuesit piratë vazhdojnë të qetë punën e tyre të pistë, duke numëruar fitimet, botuesit seriozë përballen me rrezikun e falimentimit. Dihet që individët e botimeve pirate si tregtarë të pandershëm dhe matrapazë janë njerëz që nuk kanë asnjë lidhje me librin, përveç tregtisë së pandershme me të, karakterizohen nga fudullëku dhe papërgjegjshmëria. Janë tipa të tillë që nuk mund ta konceptojnë dëmin dhe krimin që bëjnë ndaj letërsisë dhe seriozitetit të botimeve, ndaj nuk e kanë për gjë ta vendosin në të njëjtën peshore librin me specat dhe turshitë. Më tepër se kaq, ata ecin me parimin famëkeq k.ç.k dhe s'ua ndjen fare për dispozita dhe për zbatime ligjesh. Rasti që me tregoi botuesi i njohur dhe shumë raste të tjerë, janë tregues se në çfarë klimë aspak të ndershme vazhdojnë të përpëliten autorët e njohur dhe botuesit e tyre. Ka vite e vite që mak-

ineritë pirate të abuzimit vazhdojnë të botojnë pa asnjë lloj ngurrimi male të tërë veprash dhe botimesh të autorëve tanë dhe të huaj, pa ju hyrë gjemb në këmbë. Nga njohuritë që kemi mund të konstatojmë se vetëm në Tiranë dhe në rrethet e mëdha ushtrojnë aktivitetin e tyre të dyshimtë mbi dyqind e ca shtëpi botuese dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre është e licencuar dhe punon brenda rregullave dhe dispozitave të përcaktuara me ligj, të tjerat vazhdojnë të mbrohen nga "Maliqi dhe të shijnë në lëmë", Gjithkush që ndeshet me këtë realitet, ka të drejtë të pyes vetveten apo organet ligj-zbatuese. Përse jemi katandisur në këtë gjendje? A ekzistojnë te ne një politika botimesh dhe ligje për mbrojtjen e të drejtave të autorit? Natyrisht që po. Si në gjithë vendet rreth nesh edhe këtu, për rregullimin e marrëdhënieve mes autorit dhe botuesve, ekzistojnë një sërë dispozitash dhe direktivash, njëra më e fortë se tjetra, shoqëruar nga një batalion me juristë ekspertë dhe rrogëtarë të çdo lloji. Që në hyrje të këtij legjislacioni njihesh me di-

rektivën 2006/116/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, si dhe direktivën tjetër 2001/29/KE, po të Parlamentit Evropian mbi harmonizimin e disa aspekteve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me shoqërinë e informacionit, të cilat e vendosin mbi bazatëfortaligjorembrojtjenekëtyre të drejtave nga abuzimet e kësaj natyre. Neni tre i këtij ligji shkruan, e zezë mbi të bardhë, se: Të drejtat e autorit i përkasin nga natyra personit fizik, i cili ka krijuar veprën. Zyra e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe gjithë stafi i saj, e di fort mirë se: Të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, mund të kufizohen kundër vullnetit të mbajtësit të tyre vetëm në kushtet dhe në mënyrat e rregulluar me ligj. Gjithashtu në nenin 27 të këtij ligji, që bën fjalë për të drejtën e përdorimit dhe shpërndarjes së veprës, shkruhet qartë se kjo e drejtë është ekskluzivitet vetëm i autorit dhe i përket vetëm atij, për të autorizuar ose ndaluar vënie në mënyrë të ligjshme në dispozicion të publikut origjinalet ose kopjet e veprës dhe të drejtave të tjera, të lidhura me të. Në rast të kundërt, për shkelësit parashikohen një draft

masash dhe dënimesh të rrepta (gjë në heqje të licencës). Ligjet janë për t'u pirë në kupë, por në vendin tonë ku Maliqi është më i fortë se ligji, ndëshkimet ndaj elementeve të tillë abuzues vazhdojnë të jenë akoma me pikatore. Deri më sot pak ose aspak herë kemi dëgjuar të dënohet apo të bëhet shembull dikush për këtë punë. Edhe përkundër protestave të vazhdueshme të botuesve, si rasti në fjalë, dhe hartimit me bujë e zhurmë i strategjive antipirateri, dukuria e piraterisë vazhdon të bëjë të vetën. Në këtë situatë kaq të vështirë, ku të gjithë ia lënë fajet njëri tjetrit, vendosja e rregullave të caktuar për këtë çështje, po bëhet një mision gjithnjë e më i vështirë dhe një dhimbje koke e vazhdueshme e botuesve. Nëse do të bënim një sondazh sipërfaqësor në listat e abuzimeve dhe shënjestrave të piraterisë, do të konstatojmë se një sërë autorësh të letërsisë latino-amerikane dhe veprat e Kadaresë zënë ballin e oxhakut dhe shërbejnë si shpella Sezami për botuesit piratë. Ai që guxon fiton, do të më pohonte para ca kohësh si pa të keq një botuesi tillë. Dikur, ai kishte vetëm një shtypshkronjë të vogël, të licencuar vetëm për përgatitjen e mjeteve kancelar-

ike, si ftesa dasmash, reklama restorantesh dhe biznesesh të ndryshme, por duke parë se ç'bënin të tjerët, ia nisi dhe ai. Iu vu botimeve të librave me aventura për fëmijë, dhe ia pa goxha hajrin kësaj pune. Përfundimi: Nga një shtypshkronje e vogël diku në një qoshe të kryeqytetit, sot është bërë me goxha para dhe makineri nga më modernet. Fatkeqësisht në situatë të tilla, të paudhët shtohen, ndërsa botuesit e ndershëm që besojnë te ligji dhe shteti, mbeten gjithmonë në pritje të "Godosë". Është e qartë se kjo klimë mbyltese dhe kjo lojë pa rregulla nuk dëmton rëndë vetëm librin dhe autorin, por e shton edhe më shumë rrëmujën dhe konfuzionin në tregun e brishte të botimeve tona. Si mund të dilet nga kjo gjendje Përgjigja është e qartë, Kur prokuroria dhe zyra e mbrojtjes së të drejtave të autorit që paguhet me paratë e taksapaguesve shqiptarë të zgjohen nga dremitja (edhe pse një mendje më thotë se mund të jenë bërë palë me piratët) dhe t'i dalin autorëve dhe botuesve në krah. Në të kundërt, shpresat për ta vënë mbi shina të shëndosha ligjin e mbrojtjes së të drejtave të autorit, do të mbeten thjesht iluzione. Botuesit që të vetme

armë mbrojtje kanë fjalën dhe ligjin, përbaljen dhe sherrin me njerëz të tillë e kanë të vështirë. Në kushte të tilla, i përket Shoqatës së Botuesve të tregohen më aktivë dhe më të rreptë përballë kësaj piraterie, duke mbledhur të gjitha energjitë dhe konsumuar të gjithë të drejtat që iu njeh ligji, sepse në fund të fundit funksioni i saj nuk është vetëm organizimi i panairëve dhe dhënia e çmimeve të kësaj ngjarje autorëve të tyre. Tashmë kur në industrinë e botimeve të jashtëligjshme deti është bërë kos dhe se merr vesh qeni të zotin, zgjimi i saj duhet të jetë një emergjencë. Në të kundërt, braktisja e autorëve dhe botuesve të tyre në mëshirë të fatit si deri më tash, do të ishte me pasoja të pariparueshme. Shembuj praktikë se si vendet fqinjë me ne aplikojnë mbrojtjen e të drejtave të autorëve të tyre, nëpërmjet një legjislacioni dhe një sërë mekanizmash funksionalë, janë të njohur për të gjithë dhe mund të na hynin në punë, por kur mungon vullneti i duhur dhe në krye të këtyre institucioneve vendosen militantë partiakë dhe jo profesionistë, kjo odise fatkeqësisht do të vazhdojë edhe më tej.

Dita Botërore e Poezisë

"SI MUND TË SHKRU- AJ, KUR NUK MUND TË MARR FRYMË..."

(Përkujtim për të gjithë poetët që kemi njohur dhe kemi dashur, të gjallë e të vdekur)

Aziz MUSTAFA

"A e ke ditur se edhe Jul Cezari ka shkruar poezi? – më pyeti miku im Xh. L., derisa po rruftim kafetë në kafenenë e lagjes së tij. Nuk e kisha ditur, e pranoj. "Janë zhdukur që të gjitha" – vazhdoi ai të tregonte për gjeniu e burrëshëtitasë e antikitetit, duke përzier tymin e cigares së tij me tymin cigareve që thithnin punëtorët të krahut nëpër tavolinat ku bluhej përditshmëria e cepit të kasabasë së Gjilanit. Si duket ishte pikërisht e njëjta ditë e ftohtë e marsit kur vrasësit e kishin qëlluar Cezarin me thika në të hyrë të Senatit. Ndërsa shikoja ende tymin që vizatonte arabeska me natyrshmërinë e tij tymtore, m'u kujtuan orët letrare të viteve të 90' të shekullit XX, kur shkonim nëpër sallat e stërmbushura të shkollave, aty ku edhe ishim njoftuar me mikun tim, mbase të vetëm. Tollovi e madhe. Shumica rrinin në këmbë. Një popull poet. Një popull që ishte i okupuar, por që lirisë i këndonte më shumë se asnjë popull tjetër. Secili ishte poet: nxënësi, punëtori i krahut, mërgimtari, mjeku, bariu, studentja, arsimitari, i burgosuri politik, amvisja, akade-

miku. Nga A deri në Zh. Nga akademiku deri te zhavorr-përzierësi. Nga të gjithë profesionet e para të këtyre poetëve, më së miri m'u kujtua një poet nallban apo mbathtar lopësh e kuajsh, që ia kam harruar emrin, por kurrë nuk ia kam harruar fytyrën dhe plisin e bardhë dhe pasionin me të cilin i deklamonte poezitë e veta. Edhe pse nëpër tym të duhanit, si nëpër mjegull më dalin para syve pamjet e asaj ore letrare dhe duartrokitjet frenetike, të tilla që tani po u thonë "standing ovation". Dypika në dyskajetë botës, në skajetë ndryshme të kokës dhe hapësirës: Jul Cezari dhe poeti nallban, pak shekuj në mes dhe shumë, një det poezi... ***

Sot im vëlla, Hevziu, promovoi librin e tij të parë me poezi. Një vëlla në moshë të pjekur, me një libër të pjekur. "Dhembja mban emrin tënd". Shumë titull poetik. Edhe libri me vlera të mirëfillta letrare. Edhe ora letrare, edhe pse nuk kishte as tymin e duhanit, as duartrokitjet frenetike për poetin nga pjesa e parë e këtij triptiku. Ishin aty nusja e tij, djali dhe vajza e tij, secili më yll se tjetri. Ishte motra jonë, djali im, djali i dajës tonë, shoku im, mbase i vetëm

dhe disa artdashës që nuk ishin familje. Ishin në fakt familja e artit letrar. Njerëz të mirë, pa përjashtim. Aparatet digjitale dhe i-phonat e shumë kapnin pamje që luftojnë harresën me shekuj. U folën fjalë të mira nga redaktorët e recensentët. Unë nuk fola. Po të kisha folur, do të kisha thënë se të vetmen ndihmë që ia kam dhënë vëllait tim poet, njëmbëdhjetë vjet më i ri se unë, është se i kam dhënë të lexojë libra të mirë, më të mirët. Mos më pyesni a ka libër të keq se nuk përgjigjem. Pra, nuk e kam lënë tim vëlla të endet nëpër pyjet e errëta të leximit, por i kam dhënë një fanar në dorë. Kur e mendoj këtë fanar që mua më ka munguar, më dhimbsen mijëra orë të humbura në libra që i kam filluar dhe nuk i kam kryer deri në fund. Por, nuk fola. Po të kisha folur do të kisha thënë se unë dhe im vëlla nuk jemi poetët e vetëm të fisit tonë, se kemi pasur edhe një Mixhën Ali, një axhë të babës së Gjyshit Pajazit, që nuk ka pasur fëmijë dhe gjyshit tim ia ka dhuruar tokën ku kemi shtëpinë, atë shtëpi ku jemi lindur unë dhe im vëlla, shtëpinë që sheh kah maja e Lubotinit, shtëpinë ku ndodhin agimet dhe muzgjet më të bukura dhe më spektakulare të

botës. Ky Aliu, që nuk po e di saktë çka e kemi pasur, paska pas thurur bejte. Një nga ato bejte (vjersha, vargje poetike) që i ka mbijetuar kohës, ka qenë një që e ka thurur për dy kunata që grindeshin shpesh. Më kujtohet se Gjyshja Rabije, nëna e babës tim na i recitonte këto vargje të Aliut: "Sallko, Sallko, me një kundër, Kcen pej toke e hypë në kumbull' E kthen kryet e yshyrë kah vada, Ka u rrehshin Xhema e Kada" Nuk duhet shumë njohuri të kuptosh se këto dy kunatat paskan qenë Xhemilja dhe Kadirja, që shkurt i kanë quajtur Xhemë dhe Kadë, kurse Sallkoja me një këpucë, që edhe sot në fjalorin lokal i themi "kundër", është personi që i drejtohet autori, Ali Bejtexhiu. Por, këto janë vetëm hamendësime, asgjë e shkruar nuk ka mbetur. Nuk dihet as a ka ditur shkrim e lexim në atë xhungël alfabetizmi. Me një fjalë, çështja e tij ka aq shumë pikëpyetje, sa që nuk mbetet vend për asnjë shenjë tjetër pikësimi. Po një diçka që nuk ka as pikë dyshimi se një kombinim i gjeneve të ndonjë stërgjyshi si Aliu ka mbërritur deri në gjakun dhe gjenet tona. Pikë.

Është bërë traditë që pas promovimit të pihet kafe. I gjithë publiku i promovimit kaloi rrugën nga biblioteka e bukur dhe e re e Gjilanit dhe u fut në kafenenë përballë. Vendi im ishte afër ballit të tavolinës, ku kisha afër letrarë dhe artdashës. Biseda u soll rreth emrave të mëdhenj të poezisë kosovare që ishin nga Gjilani: Beqir Musliu, Musa Ramadani dhe Rexhep Elmazi. Ky i fundit është figura më tragjike jo vetëm e poezisë gjilanasë, por edhe asaj kosovare e kombëtare. I përndjekur dhe i burgosur politikisht nga regjimi komunist serbo-sllav. Vjehri im ka punuar me të në Entin e Sigurimit Social të atëhershëm. Nga ai

kam dëgjuar për plagosjen e tij të palavdishme në qafë, kurse për ditët e tij në Klinikën e ORL-së në Prishtinë dhe vdekjen e tij, përtëcilënkanë bërë festë UDB-ashët, kam dëgjuar nga kolegët mjekë, në po atë klinikë ku kam kaluar dy dekada të punës sime si mjek. Poeti dhe prozatori M.R., filloi të tregonte për mprehtësinë e tij në të folur. I mësuar të jetë përherë i përcjellë dhe i spiunuar nga sigurimi shtetëror, në vitin e largët 1980, kur ky e kishte pyetur: Rexhep, a do të vish në koncertin e Orkestrës së Valleve të Radio-Televizionit Shqiptar, që do të mbahet sonte këtu në Gjilan? Ai iu kishte përgjigjur:

Jo, se do ta shikoj serialin televiziv Kuda idu divlje svinje (Ku shkojnë derrat e egër). Kuptohet, nuk i kishte besuar askujt, as këtij djali të ri që sapo ishte futur në hullitë e poezisë, i cili vazhdoi të tregonte, kurse poetët S. Rr. e S.S. të pohonin se Beqir Musliu e kishte dashur dhe çmuar shumë Rexhep Elmazin dhe se vdekja e tij i kishte hapur plagë në zemër. Gjilani nuk e din ende mirë se çfarë Charl Bodleri ka ecur nëpër rrugicat e tij me kalldrëm. Por, kjo që tregoi në fund miku im M.R., më bëri më së shumti përshlyetje: Njëherë, Mazllum Saneja, poet dhe përkthyes nga polonishtja, mik i përbashkët i Rexhës dhe Beqës, i

kishte pas treguar një profesorit të tij maqedonas, njëfarë Gj. Stardellov se një poet i përndjekur gjilanas, dmth. Rexhep Elmazi ka thënë: "Kako mogu pisati, kad ne mogu disati?" ("Si mund të shkruaj, kur nuk mund të marrë frymë?") A ka pyetje më pa përgjigje që mund të bëjë një poet në tërë botën, poeti i robëruar, i burgosur dhe i vrarë mizorisht në tualet të vendit të punës nga pushteti okupues e shtypës? A ka testament më të madh dhe më të dhembshëm letrar se kjo pyetje që bën poeti në një varg të vetëm poezie? A ka më shumë forcë vargu që ka lënë poeti apo arma e që e ka vrarë atë? Gjykoni vetë. Poetë.



Xhahid Bushati, shkrimtar

LETËRSIA PËR FËMIJË ËSHTË MISION...

Disa shkrimtarë, që sot nuk jetojnë, kanë lënë si testament një bibliotekë librash me krijimtarinë e tyre. Mesazhet e veprave të tyre i përkasin të sotmes edhe të ardhmes

Avni HALIMI

Xhahid Bushati është njëngashkrimtarët tanë më produktiv sa i përket letërsisë për fëmijë. Me shkrime filloi të merret që kur mbushi 10

vjeç. Është autor i rreth 40 veprave dhe prezent në të gjitha revistat për fëmijë. Për punën e tij të vyer ai është nderuar me shumë shpërblime, pjesëmarrës në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, refer-

ues në sesione shkencore. Bushati shkruan prozë dhe poezi, pjesë për kukulla, merret me publicistikë e studime të letërsisë për të rritur e fëmijë etj. Por, kryesisht i është përkushtuar fushës së letrave për fëmijë.

HEJZA: Shumë krijues letrarë e pak nga ata që krijojnë për fëmijë! Krijuesit për fëmijë janë ata që e rrisin dashurinë tek fëmijët për librin, që e ngacmojnë tek fëmijët fantazinë për t'u bërë shkrimtar,

dhe e turpërojnë letërsinë cilësore nacionale. Për të qaj e për të qesh kjo punë. Nuk e di kur do të fillojmë ne shqiptarët të merremi më shumë me veten. Përse duam aq shumë ta vrasim veten e t'ubëjmë elozhet tjerëve. Po ua kujtoj qëndrimin konformist të politikave kulturore në Shqipëri, Maqedoni e Kosovë, jo seriozitetin e shumicës që japin dezinformata, që ngatërrojnë lexuesin dhe krijuesin në rrugën drejt bashkimit kulturor të trojeve tona. Disa nga brezi i ri, haptas shkëpusin kontaktin me letërsinë që krijohet në këtë periudhë kohore. Kjo të ngjall tmerr. Edhe pse qysh në fillim të tranzicionit, bashkë me bashkimin ekonomik filloi edhe bashkimi kulturor, ai sot po zbehet më shumë se kurrë. Politikën nacionale kulturore duhet të formojnë strategji kombëtare për bashkimin kulturor. Libra leximi të përbashkëta, lektura shkollore të përbashkëta nga autor bashkëkohor për shkollat nëntëvjeçare dhe për shkollat e mesme. Edhe pse i domosdoshëm si ajri që e thithim, shpesh më duket më i rëndë se shkrepat e malit ky projekt. Mendoj se gjithçka duhet të nis nga politikën kulturore, nga institucionet arsimore e kulturore, nga shoqatat serioze të shkrimtarëve dhe nga disa asociacione tjera, me qëllim që, për një kohë jo shumë afatgjate, gjithçka të vjen në vend të vet. Ne jemi një komb me të njëjtën kulturë, prandaj nuk duhet të sundohejmi nga banaliteti, nuk duhet t'i harrojmë të vdekurit nën bli që lanë pas vetes vepre cilësore letrare e shkencore dhe të gjallët që përpëliten flatra-këputur për t'i lënë kombit perla e për ta mbajtur gjallë shpirtin kombëtar. I hapin dyert e botës fëmijërore ku mbruhet motivi për të shkru-

ar, për të krijuar, për të dashur gjuhën... Cili është ai çelës që u mundëson shkrimtarëve për të depërtuar në botën fëmijërore për të ndihmuar në këtë mbrujtje?

XH. BUSHATI: Shkrimtarë të vërtetë të Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj, aktualisht, kemi pak, shumë pak; ndërsa libra për fëmijë të gjinive e zhanreve të ndryshme letrare kemi shumë, e, botohen paresh-tur... Librat për fëmijë, veçanërisht, ato që përkasin letërsisë parashkollore "shëtisin" me shumicë mes pedagogjisë, skollastikës e biznesit. Pra, përgjithësisht, nuk mund të flasim për vlerat artistike që dhuron një libër letrar. Ndërsa për letërsinë që i përgjigjet moshës shkollore, pak vlera të vërteta gje, pa dashur të bëhem nihilist. Sepse mungojnë disa çelës, si: talenti, njohja e psikologjisë dhe botës së fëmijëve, origjinaliteti, autoktonia, guximi krijues dhe besimi në të, kulturologjia, temat aktuale dhe perspektive... etj., etj. Letërsia për fëmijë është mision. Nuk është e lehtë. Jo, dokushdo mund "të trokasë" në këtë portë të shenjtë, ndonëse trokasin çdo ditë, më shumë të pataleuar sesa të talentuar.

HEJZA: Gjyshet tona na kanë rrëfyer përralla të cilat nuk i kemi hasur askund në letërsinë për fëmijë, as në letërsinë shqiptare, por as në letërsinë botërore! Na kanë rrëfyer gjyshet tona se i kanë të dëgjuara nga gjyshet tyre, të cilat, nuk e kanë ditur as shkrim dhe as lexim! Janë autore të rrëfimeve origjinale vetë gjyshet dhe stërgjyshet tona, apo ka ekzistuar dikur shkrimtari për fëmijë, i cili ka shkruar për vëllain e vogël të mençur, për kuçedren, dra-

goin, bajlozin, pusët e thella, degëzimet nëntokësore të puseve, për zogun e madh që ka bartur mbi flatra një popull të mirë, për vetëtimën që ka çarë kodra, për murmurimën që ka gurëzuar luftëtarë etj., etj.

XH. BUSHATI: Gjyshja është një figurë-emblemë, e dashur dhe e shtrenjtë për djalin dhe vajzën, nipin dhe mbesën. Është magjike si figurë, po magjike në rrëfimin e saj përrallor. Është origjinale, po aq e mençur dhe e ditur. Për t'u mos u plakur dhe humbur identitetin e saj, rrëfimin e saj përrallor e ka trashëguar te bijtë e saj; ndonëse, vërejmë aktualisht, vende-vende zbehje dhe harresë. Kësisoj, gjyshja si model, mbetet e fisnikëruar dhe e adhuruar, ndërsa kur hyn në rolin e shkrimtarit, ajo është shumëdimensionale. Duke pasur këtë pasuri të gjyshë-shkrimtares, që shpesh nuk njihet, po hedh një vështrim historik të udhëtimit të përrallës shqipe, për të parë ecurinë e saj, dhe pse e kemi "larguar" shpesh here gjyshe-shkrimtaren. -Në vitin 1945, krijuesit e parë që formuan traditën e parë të letërsisë shqipe, sytë i kthyen nga përralla popullore, e ajo si gjini mori më hov se të tjerat. Sukseset qenë të vogla, në përshtatjen e tyre apo mbi bazë motivesh, nuk arritën të përçonin vlerat që kishin përrallat origjinale popullore. -Pas vitit 2000, ky fenomen u përsërit. Sukseset nuk qenë aq të pritshme, ndonëse në letërsi po hynin disa shkrimtarë të talentuar. Përsëri ishin larg rrëfimit të gjyshe-përrallës, si: në magji, problematikë, personazhe, fantazi, imagjinatë... etj., etj. -Deri në vitin 1990, përralla shqipe

nuk arriti të kuptonte esencien e rrëfimit dhe prurjet e gjyshe-shkrimtares. Nuk arritëtëzgjidhte: simbolikat dhe mitin e saj, raportin e fantazisë me realitetin, karakterin popullor të përrallës, të cilën e denigroi dhe e quajti "përrallë socialiste", etj. etj. -Afërsisht ka një dekadë që përralla në zhvillimin e saj si gjini letrare ka një hallakatje në problematike e në rrëfim, në thurjen kompozicionale dhe në të kulturën e të shkruarit... etj. Shquhen, veçanërisht vështrime e motive anakronike, plagjiatura, ka moralizime, prurje të fantashkencës pa vend, mungon estetika përrallore, etj. Lind pyetje: A ka modele përralash në shumështrimitet e saj që na kanë dhënë shkrimtarët? Lexoni librin "Tregimet e moçme shqiptare" të Mitrush Kutelit, dhe do të kuptoni si shkruhet përralla shqipe.

HEJZA: Në ç'nivel dhe në ç'pozita e kemi sot letërsinë për fëmijë? Cili është raporti i shoqërisë sonë me krijuesit letrarë për fëmijë?

XH. BUSHATI: Letërsia shqipe për fëmijë është letërsi e vogël e një vendi të vogël. Botohen libra të mirë, mesatarë dhe pa vlerë. Këto të fundit me shumicë. Është një letërsi që ka zhvillim, por jo njohje. Duhet përkthyer që të njihet. Mendoj se dinjitet e vlerë mund t'i japin kësaj letërsie Shtëpitë Botuese të vërteta. Shoqëria dhe shkollat pak i njohin krijuesit e letërsisë për fëmijë se pak kanë mbetur. Shpesh për të kujtuar një shkrimtar, prindërit apo të rriturit i bëjnë zë fëmijërisë së tyre. Mesatarja e shkrimtarit për fëmijë në Shqipëri varion 65-75 vjeç.



HEJZA: Sa janë të vetëdijshëm shkrimtarët për fëmijë për rolin dhe peshën e tyre në shoqërinë tonë shqiptare! Këta shkrimtarë bëjnë shumë për ata që janë ardhmëria e shoqërisë sonë, por sa këta bëjnë për vetveten? Apo, zëri i tyre është i papërfillshëm, sepse janë shumë pak! Si pak që janë, a e gëzojnë respektin e "shumicës"?

XH. BUSHATI: Ata janë shumë të vetëdijshëm. Disa shkrimtarë, që sot nuk jetojnë, kanë lënë si testament një bibliotekë librash me krijimtarinë e tyre. Mesazhet e veprave të tyre i përkasin të sotmes edhe të ardhmes. Shumë prej tyre që unë i quaj Patriarkë dhe shpesh nuk mund të arrihen në vlera artistike, janë "shkrirë si qiriri" për brezat e Shqipërisë, që shqipja të mos humbasë. Që të respektohet shkrimtari më parë duhet të njihet ai dhe vepra e tij. Në këtë drejtim kërkohet investim.

HEJZA: Në ç'nivele e kemi kritikën letrare për letërsinë për fëmijë? Kush e vlerëson këtë letërsi? Në ç'mendime kritike objektive, apo, në ç'fakte mbështetemi kur konstatojmë se kemi (aponukkemi) letërsi për fëmijë!

XH. BUSHATI: Pothuajse nuk kemi kritikë letrare për fëmijë. Kritika

është në gjendje informacioni dhe recensionit. Me pakicë kemi studime, ndonëse, ata, kanë vlerë të pazëvendësueshme. Në gjykimet e mia janë interesante. Zakonisht kritikës letrare i kanë dalë për zot poetët e jo kritikët. Fondi i kritikës letrare për fëmijë është pothuajse inekzistent. Syri i njerëzës është evident, përsëri, syrin e saj e shohim shpesh edhe në mbarëvajtjen e letërsisë për fëmijë. Pse themi, duhet të ketë kritikë letrare, sepse duhen evidentuar vlerat dhe problematikat që paraqet ajo gjatë procesit të saj zhvillimor.

HEJZA: Kontakti i parë i fëmijëve të diasporës sonë me gjuhën letrare janë pikërisht librat apo rrëfimet elektronike të shkrimtarëve tanë për fëmijë! Cila është njohja e drejtpërdrejtë e këtyre fëmijëve me krijuesit shqiptarë të letërsisë për fëmijë dhe, anasjelltas?

XH. BUSHATI: Teknologjia ka zhvillimin e përhershëm të saj. Po të funksionojë ka dobi të madhe. Mendoj se kjo marrëdhënie shumë çalon e ka mosnjohje. Njohjet janë të rantsishme dhe kush është dashamir dhe prind i interesuar për fëmijët e tij, ia del disi në breg. Sot që flasin, nuk njohim librat dhe shkrimtarët që jetojnë në diasporë. Nuk njo-


him letërsinë për fëmijë që botohet në Kosovë. Pra, Letërsia shqipe për fëmijë nuk njeh letërsinë shqipe për fëmijë. Institucionet t'i kthejnë sytë nga kjo pasuri brezash. Të vendosen ura komunikimi. Kjo është urgjente!

HEJZA: Sa ka evoluar krijimtaria për fëmijë në kohën kur fëmijët po sfidohen menjë "modernitet", icilijose po kuptohet aq shumë nga të rriturit?

XH. BUSHATI: Është një trinitet ekzistues që jeton dhe përherë bëhet agresiv: -Celulari, -Fëmija, - Libri. I ndodhur mes këtyre dy problematikave, fëmija në të shumtën e herës bëhet rob i celularit. Libri "harrohet". Është detyrë e prindërve, mësuesve, punonjësve të bibliotekave, shkrimtarëve, institucioneve... etj., të mos çuditen, një ditë nga fjalët: "Ky nxënës nuk di të lexojë. Ky nxënës është analfabet. Ky nxënës..." Më shumë se kurrë fëmijët e Shqipërisë e Kosovës... etj. duhet ta mbështetin kokën në prehrin e diturisë dhe të përkunden gjatë viteve të rritjes me të.

HEJZA: A e shihni si problem faktin që, fëmijët tanë sot, më shumë i njohin shkrimtarët e huaj se sa shkrimtarët shqiptarë për fëmijë. Pse ndodh kjo? Si të arrihet e kundërta?

XH. BUSHATI: Pohimi juaj është i drejtë dhe evident. Për mua është i dhimbshëm. Shpresoj të mos bëhet tragjik. Me tragjik kuptoj tkurrjen e letërsisë shqipe për fëmijë. Në të vërtetë po tkurret çdo ditë. Nga një sondazh imi, më rezultoi se raporti i botimeve është i tillë: 3 libra me autor të huaj e 1 libër me autor shqiptar. Ndoshta ky raport edhe mund të thellohet. Shtëpitë botuese e kanë një prirje të tillë drejt autorëve të huaj. Nuk ka gjë të keqe t'i sjellësh, është kulturë, e kultura duhet njohur. Universalja duhet njohur. Por, librat duhen zgjedhur. Ka përkthime shkel e shko. Ka përkthime me gabime ortografike, që jo vetëm nuk njohin gjuhën e huaj por as shqipen me strukturat sintaksore të saj. Botimet e librave me autorë të huaj, mendoj se është e lidhur me përfitime financiare. E pastaj, ca botues për t'u shfaqësuar, thonë: "Nuk ka autorë shqiptarë". Unë mendoj se ka dhe të talentuar bile, por duhet t'i kërkojnë. E kanë për detyrë për derisa mendojnë, flasin e jetojnë shqip. Të mendojnë për një çast se Shqipja është gjuhë e zemrës. E, siç thoshte poeti i talentuar Petrit Ruka: "Atdheu fillon nga zemra!"



Në fokus

SUBSTANCA LETRARE

Metoda e realizmit socialist që një shpikje ideologjike e kritikëve zyrtarë, që pati ndikime negative sidomos në krijimtarinë e talenteve mediokër



Moikom ZEQO

Në rrafshin e krijimtarisë së mirëfilltë letrare mund të shikohet substanca letrare. Në mënyrë absolute në këtë substancë letrare nuk mund të ngurtësohemi as me formula dhe as me përcaktime jashtë-letrare. Substanca letrare i përket kohës shpirtërore dhe jo kohës kronologjike. Substanca letrare është e vetëmjaftueshme, ajo s'ka pse të tjetërsohet në rrafshin e shpjegimit. Shpjegimi është jashtë-letrar. Shpjegimi lidhet me ideologjitë, botëkuptimet, krahasueshmërinë. Shpjegimi është interpretim i tekstit në 100 pika shikimi. Kështu substanca letrare mund të dyzohet. Por ajo që mund të thuhet për substancën letrare nuk është asnjëherë identike me substancën letrare. Kjo optikë konceptuale është kryesore. Substanca letrare nuk njih kohë dhe emra autorësh në mënyrë të ngushtë, as hapësira, etni dhe gjuhë të ndryshme. P.sh. Homeri ka shkruar në epokën e skllavopronarisë të bazilënjeve dhe të skllavëve. Substanca letrare e Homerit nuk është e përcaktuar nga metodat as nga sistemi ekonomik-shoqëror i kohës së tij. Substanca letrare e Homerit është po aq e lexueshme sot dhe ndoshta do të jetë më e lexueshme në shek. XXII. Dalim këtu tek një rrafsh tepër i diskutuar, ai i metodave artistike dhe letrare. Në ç'metodë do të fusim krijimtarinë e tragjedianëve të mëd-

henj grekë, Eskilit, Euripidit dhe Sofoklit? A mund të bëhet një formulë për ta? Cilës metodë letrare i përkasin poetët e mrekullueshëm botërorë kinezët Du Fu dhe Li Bo? Apo Lao Ce? Po metoda letrare e Dantes si mund të klasifikohet? A është kultura dhe arti barok i shek. XVII një metodë? Bogdani dhe Budi janë shkrimtarë të mëdhenj, të nivelit evropian të shkrimit barok. Cilës metode letrare i përkasin? Si quhet metoda letrare e Uanishadave apo e librave të shenjtë iranikë të Zarathustrës, apo e vargjeve të "Librit të të vdekurve" të Egjiptit, apo Psalmet poetike të Biblës së Shenjtë? "Libri i Jobit" mund të quhet sot një vepër postmoderniste. Si mund të klasifikohet krijimtaria e Shekspirit apo e Servantesit, apo e Billeikut dhe e Erza Paundit? Me ç'metodë ka shkruar Uollt Witmani dhe Sent Xhon Persi. Kritikët dhe historianët e artit të bëjnë klasifikimin. Të gjitha këto janë një mbishtresë e dytë. Të gjitha ikonografitë formojnë shkollat e metoda, p.sh. ikonografia babilonase, egjiptiane, bizantine, por arti është diçka tjetër. Metoda e klasicizmit e ka një kult që quhet Moliere. Nga mënga e Moliere doli Balzaku, që klasifikohet si i realizmit kritik. Bajroni dhe Kitci janë romantikë, por Oskar Uajllidi ka më shumë lidhje shpirtërore me Niçen, është po aq rebel sa Herakliti duke qenë poet si Shekspiri. Xhek London është ithtar i letërsisë socialiste si hermetizëm në fillim të shek. XX. Por kjo nuk do

të thotë që Gorki është tërësisht emblema e realizmit socialist në krijimtarinë e tij. As Majakovski dhe as Kadare dhe as Agolli. As Aragoni dhe as Pablo Neruda nuk mund të emblementohen me një metodë të caktuar. Nuk ka pasur metodë artistike më të përcaktuar gjeometrisht dhe nga pikëpamja heriatikesa ikonografia bizantine. Po ama ne sot mahnitemi nga një Onufër dhe nga Panselinosi. Metoda e realizmit socialist që një shpikje ideologjike e kritikëve zyrtarë, që pati ndikime negative sidomos në krijimtarinë e talenteve mediokër. Talentet nuk varen nga metodat as nga epokat, as nga politikat. Nëse Shekspiri lindi në periudhën elisabetiane, kjo nuk do të thotë që në periudhën e sotme postindustrialiste të Anglisë të lindë medoemos një talent më i madh se Shekspiri. Migjeni është një gjeni konceptual që nuk mund të klasifikohet me formula letrare. As Xhojsi dhe as Gabriel Markezi, as Borgesi dhe as Saragomago nuk mund të klasifikohen në emër të metodave letrare. Metodot letrare janë konvencionale, por janë më tepër një mundësi e pakufishme interpretimi dhe nuk janë një realitet i mirëfillt letrar. Shkrimtarët e ndryshëm në kohëra të ndryshme mund t'i përjetosh dhe t'i lexosh në çdo çast. Ata janë gjithnjë si tërësi dhe sintezë dhe jo veç e veç. Unë nuk besoj tek metodat letrare, nuk kam besuar kurrë tek real-

izmi socialist. Metodot letrare le t'ua lemë atyre që nuk janë letrarë, por që shpesh duan monopol mbi letërsinë d.m.th. kritikëve dhe historianëve të artit. Ka diskutime të skajshme për përcaktimin e letërsisë dhe artit dhe të esencës së talenteve. Një tezë e vjetër e Brynetierit, që thotë se në art bëhet fjalë për kanone estetike par excellence, pra kanone morfologjike-estetike të disa modeleve artistike, imitime që janë primordiale dhe për artistët, gjithsesi subjektivisht më të rëndësishëm se sa baza ekonomike, apo marrëdhëniet shoqërore në një sistem politik. Kjo tezë ngjalli mërinë e polemistëve të ashtuquajtur të majtë në gjysmën e shek. XX, siç ishte Aragoni apo dhe Malroja, që nisur nga një dogmatizëm i egër e quajtën tezën e Brynetierit si tezë idealiste dhe kundërrevolucionare. Kjo polemikë të kujton diskutimet e egra teologjike të Bizantit, ku merrej seriozisht çështja nëse kishin apo nuk kishin seks engjëjt apo dhe vetë Krishti. Karakteri subjektiv i artit nuk mund të përcaktohet nga një objektivitet shoqëror thjesht ekonomik. Kjo do të thotë që realiteti ekonomik i realizmit totalitar në Shqipëri nuk mund të modelohet lehtësisht dhe të përcaktonte artin dhe substancën letrare. lizmit totalitar në Shqipëri nuk mund të modelohet lehtësisht dhe të përcaktonte artin dhe substancën letrare. Kështu Brynetieri do të tallej nga ata që duke hedhur poshtë me të dre-

jtë metodën e realizmit socialist, të mohonin letërsinë e vërtetë të krijuar nën këtë epidermë artificiale, sipërfaqe politike e propagandës zyrtare. Letërsia shqipe ka një lloj autonomie të saj, që nga Buzuku e deri më sot dhe kryeveprat e letërsisë shqipe ndonëse janë të ndryshme dhe të dallueshme, kanë më tepër lidhje brenda për brenda këtij sistemi autonom letrar, pa përjashtuar këtu edhe vetë letërsinë e quajtur si të realizmit socialist. Kështu, ndikimi i Gjon Buzukut dhe Bogdanit, i De Radës dhe Naim Frashërit ka qenë i pashmangshëm brenda për brenda të njëjtës substancë letrare, pavarësisht pro-

fileve të ndryshëm artistikë. Kjo autonomi e brendshme e vetë letërsisë shqipe duhet studiuar seriozisht. Ajo mund të shpjegojë gjithçka. Një çështje tjetër shumë e ndërlikuar është ajo e lindjes së talenteve. Kombi shqiptarë kanë magmën e tij sekretin që e di vetëm ai, kur duhet të nxjerrë nga gjiri talentet e mëdha dhe ato të zakonshmet. Nuk mund të thuhet pse Kadare dhe Agolli lindën në gjysmën e parë të shek. XX dhe nuk lindën fjala vjen në gjysmën e dytë të shek. XXI. Nuk mund të thuhet pse Onufri lindi në shek. XVI, dhe nuk lindi p.sh. në shek. XII, ashtu siç nuk mund të thuhet pse Servantesi lindi pikër-

isht në Spanjë dhe nuk lindi në Kinë, ose pse Witmani lindi në Amerikë dhe nuk lindi në Norvegji. Këto janë sekretet e magmës së vetë njerëzimit. Përsa i përket artit të programuar, ai bazohet në sistemin e mbyllur dhe jo të hapur. Është e çuditshme që në historinë e artit dhe të letërsisë ka ekzistuar me fuqi të gjatë në hapësirë dhe në kohë një shumësi ikonografish programore. Ikonografite programore shpesh janë modeluar nga struktura perandorake të mëdha si p.sh. në Egjipt, Romë dhe në Bizant. Ikonografia programore që në mesjetë gati totalitare. Ikonografia programore që edhe në perandorinë ko-

muniste. Por këto më tepër i përkasin superstrukturës politike. Letërsitë dhe artet kombëtare dhe të njerëzimit përherë e më shumë synojnë drejt autonomive të mëvetëshme, qoftë edhe në epokën globale e mbase edhe në epokën postglobale. Një kthjelltësim i tillë na bën më të matur për të mos bërë përmbysje të kota dhe pa asnjë kuptim të vlerave të mirëfillta letrare dhe artistike, pavarësisht nga tiranitë dhe dogmat e metodave të ndryshme artistike. Kjo vlen edhe për Shqipërinë, siç vlen edhe për vetë njerëzimin. (Janar, 1991)

Xhevdet Bajraj: ANGELUS NOVUS

FILOZOFIA E NJERIUT TË LIRË

ANGELUS NOVUS (ENGJËLLI I RI) sipas traditës hebraike, është një krijesë qiellore e krijuar vetëm për të kënduar një këngë të përjetshme përpara Zotit. Pasi ta këndojë himnin para Zotit, përfundon dhe tretet në hiç. Po çfarë lidhje ka kjo me Xhevdet Bajrën?

Drita MIFTARI

"Ndryshe nga vëllimet e tjera poetike të Xhevdet Bajrajt, vëllimi i fundit, ANGELUS NOVUS apo ENGJËLLI I RI, është pagëzuar para se të merrte formën finale. Madje, edhe para se të përzgjidheshin poezitë që do të përfshiheshin brenda këtij vëllimi. Titulli i librit zakonisht lind pas përfundimit të të gjitha fazave. Kësaj radhe vetë Xhevdeti e kishte përzgjedhur atë shumë më herët dhe i kishte lënë në dorëshkrim."

Zyrafete Shala, redaktore e librit thotë se vëllimi ANGELUS NOVUS është dorëshkrimi i fundit që Xhevdeti ma ka dërguar pak ditë përpara se të ikte nga kjo botë. Ishte i papërfunduar. Kur them i papërfunduar, nënkuptoj faktin që poezitë kanë qenë, por ai nuk i ka përzgjedhur se cilat do të hyjnë në këtë vëllim me poezi. Do të thotë, ka përzgjedhë një pjesë të tyre dhe nuk është marrë pastaj më, siç e ka pasur atë metodën e punës, me radhitjen e tyre, me ndarjen nëpër cikle. Ai, edhe këtyre iu ka

dhënë një rëndësi shumë të madhe, se cila poezi duhet të vijë pas tjetrës, me cilën hapet vëllimi, me cilën mbyllet, ndaj dhe këto vetë e kanë krijuar një lloj figurë poetike në një vëllim të Xhevdetit. Punën e mbetur u desh ta përfundoj unë, por falë atij bashkëpunimi që e kemi pasur për vite të tëra, pak a shumë kisha arritur ta kuptoj mënyrën e punës së tij dhe jam përpjekur që ta bëj përafërsisht ashtu siç e ka bërë ai. Megjithatë, librit i mungon dora e fundit e vet poetit. Pikërisht kjo edhe e shtyu bot-

imin e librit, sepse nuk isha e sigurt, a jam duke shkruar në atë vijën, në atë rrugën që ai kish dashtë të shkoj. Megjithatë, duke i marrë edhe vlerësimet e kolegëve, miqve, krijesë që e kanë njohur Xhevdetin dhe krijimtarinë e tij, mbretëron bindja se puna e bërë është tamam e denjë për të qenë një vepër e Xhevdet Bajraj. Më gëzon fakti, që kemi arritur edhe një herë ta kthejmë Xhevdetin te lexuesi. Ky është libri i dytë që botohet pas vdekjes së tij. Ai ka lënë edhe poezi të tjera, mirëpo ato nuk e



di se si do t'i organizojmë, sepse Xhevdeti këtë vëllim e ka titulluar vetë, përderisa nuk ka arritur ta përfundojë. Kjo ka qenë diçka e rrallë në punën e tij, sepse zakonisht ai e ka përfunduar një herë radhitjen e poezive dhe pastaj e ka vendos titullin. Por, kësaj radhe nuk pati sqarim se pse e zgjodhi këtë titull, pse e emërtoi librin përpara se ta përfundonte. Ndoshta duket si rastësi, por, megjithatë, tani e të qartë se pse e la këtë titull. Është e qartë se ai ka dashur të na thotë që ka qenë një lloj engjëlli i ri, që ka ardhur në botë për ta krijuar poezinë. ANGELUS NOVUS (ENGJËLLI I RI) sipas traditës hebraike, është një krijesë qiellore e krijuar vetëm për të kënduar një këngë të përjetshme përpara Zotit. Një legjendë talmudike thotë se në çdo moment, një legjion engjëjsh të rinj krijohen që, pasi të këndojnë himnin e tyre para Zotit, të përfundojnë dhe të treten në hiç. Po çfarë lidhje ka kjo me Xhevdetin? Duket se, edhe Xhevdeti është krijuar me një mision të veçantë, është krijuar që ta na sjellë një poezi

mjeshtërore, që ta ngrehë nivelin e poezisë shqipe, në nivel universal, ta bëjë të njohur në botë, dhe përmes asaj poezie të na mësojë se si duhet të jetë njeriu, si duhet të jetë atdheu, si duhet të jetë kjo botë, që ne e kemi sjellë në këtë nivel, çfarë po e shohim tani dhe çfarë do t'ua lëmë brezave në vijim. Poezia e Xhevdetit do të vazhdojë të lexohet dhe ne do të kemi shumë nevojë për të, sepse para së gjithash ajo i dedikohet popullit tonë, brezave që vijnë, neve, që kemi përgjegjësi të ju lëmë një botë më të mirë. Arsim Hamiti, kritik letrar thotë se ANGELUS NOVUS është një përmbledhje poetike, e cila përveç se mbanë vulën artistike të autorit, po ashtu na mahnit me bukurinë e vargut, mjeshtërinë e fjalës, figurën e bukur dhe kuptimet e shumta. Hamiti vlerëson se, duke qenë se ky libër na erdhni kur autori nuk është fizikisht me ne, dhe poezitë janë të shkruara pak para se ai të ikte nga kjo botë, domosdo se secilit lexues ia krijon idenë se brenda vargjeve duhet të ketë diç-

ka të veçantë që nuk shihet në lexim të parë. Mbase një parandjenjë të autorit, një fjalë të fundit të tij apo ndoshta një kod sekret që vetëm ai dinte ta fshihte ashtu qetë-qetë mes vargjeve të bukura e të çiltra. Por, a nuk kishte gjithmonë poezia e Xhevdetit këtë mision që lexuesin ta befasonte, o me një varg predikues, o me figura të përmbysura që natyrshëm krijojnë mesazhe plot fuqi brenda vargjeve të tij? Natyrisht se po. Të gjitha përmbledhjet poetike të Bajrajt kishin misionin fisnik që lexuesin ta bëjë që të mahnitet me kuptimet e reja që marrin ngjarjet dhe gjërat në jetën tonë dhe ta shohë botën plot me ngjyra të reja. Njëkohësisht ta trondit atë me idetë artistike që shndërrohen në mesazhe kuptimplota, ushqejnë shpirtin tonë dhe na bëjnë herë pas here të ndjehemi të sigurt se është dikush që na transmeton atë dimensionin e pashpjegueshëm të botës. Shkrimtari Kliton Nesturi vlerëson se Xhevdet Bajraj tashmë ka kaluar kufijtë kombëtar. Edhe në vëllimin e fundit poetik, ANGELUS NOVUS,

ai qëndron shumë, shumë më lartë dhe me këtë vepër është çimentuar piedestali i tij. Filozofia e Xhevdetit është filozofi e njeriut të lirë, i cili është gjithmonë në rrezik. Është i papajtueshëm me realitetin në të cilin jeton. Ai do një realitet më të bukur dhe për këtë lufton. E gërshtuar kjo edhe me stilin dhe gjetjen, dy elementet më thelbësore, pa të cilët nuk bëhet një krijimtari letrare. Ky gërshtim: stil, vepër dhe filozofi e gjetje, plus talentit, i jep atij të drejtën dhe vulën për t'u quajtur një poet i kalibrit botëror. Vetë krijimtaria e tij, vetë prania i tij në qarqet letrare botërore, në Universitetet prestigjioze të botës, e dëshmojnë këtë gjë. Bota nuk të pranon kollaj. Xhevdeti i përket një bote tjetër dhe nuk është më ai që ka nevojë për ne, jemi ne ata që kemi nevojë për të. Jam i bindur që poezia e tij, pavarësisht se ka qëndruar jashtë klaneve dhe sferave të ndryshme, do të ketë shumë pasues që do ta adhurojnë.

Fjala e shkrimtarit

ENDE I DËGJOJMË TMERRET E TOPLICËS

Është mirë të lexoni librin "Beteja e Toplicës" dhe të bindeni se me qindra e mijëra pleq, gra e fëmijë bëheshin shkrumb e hi, ose të lexoni për tmerret e Çamërisë, prej nga grekët dëbuan me dhunë të paparë popullsinë shqiptare


Ali PODRIMJA

Gjatë historisë, jeta e shqiptarëve ka qenë shumë e vështirë, nën sundimin e huaj shekullor. Ende i dëgjojmë tmerret e Toplicës - kur serbët u rrëmbenin nënave fëmijët dhe i hidhnin në fuçi me ujë të nxehtë, prej nga të gjerët nuk zgjohesh-

in më; apo kur pleq e fëmijë i hidhnin në stufa zjarri dhe i digjnin si të ishin patate. Është mirë të lexoni librin "Beteja e Toplicës" dhe të bindeni se me qindra e mijëra pleq, gra e fëmijë bëheshin shkrumb e hi, ose të lexoni për tmerret e Çamërisë, prej nga grekët dëbuan me dhunë të paparë popullsinë shqiptare. Diçka e

ngjashme ndodhi edhe në Lumë të Hasit, për çka flet edhe serbi Dimitrije Tucoviq, ndonëse për këtë rrëfejnë edhe pleqtë që me sytë e tyre kishin parë teksa gjaku rridhte si lumë. Terror, djegie, vrasje, vjedhje, dhunime, krime, spastrime etnike të shqiptarëve gjithandej Kosovës e të trojeve arbërore. Vetëm brenda gjashtë

muajve (tetor 1912-mars 1913) nga soldateska serbe u masakruan mbi 25,000 njerëz. Edhe në Gjakovën time rrugët ishin përplot kufoma, dhe për këto tmerre autentikisht rrëfen korrespondenti i luftës i Vjenës, Leo Freundlich në broshurën e tij "Shfarosja e Shqiptarëve" (Albaniens Golgatha), të botuar në Vjenë më 1913.



Me fatin e asnjë populli tjetër nuk është luajtur lojë aq e keqe sa me shqiptarët; me interesat e asnjë populli tjetër nuk është bërë tregti e verbër në Ballkan e Evropë sa me shqiptarët; dhe për këtë dihet se kush është fajtor, thotë ky autor. Pas gjithë këtij tmerri, kërkohet që Arbëria të copëtohet dhe të mos i mbesë as shenjë as gjurmë. Pse ekzistonte e gjithë kjo urretje ndaj një populli që kishte dhënë shumë trima e figura historike, është e pashpjegueshme. Tmerre të ngjashme përjetuam edhe gjatë okupimit nga regjimi shtetëror serb e jugosllav i Millosheviçit, për çka jam dëshmitar edhe vetë dhe për çka ngrita zërin si njeri e si poet në shumë shkrime e tubime ndërkombëtare. Muzat nuk heshtin as kur topat e hanxharët gjëmojnë. Poetët nuk kanë heshtur asnjëherë gjatë luftërave e revolucioneve të mëdha shoqërore, gjatë krimeve e padrejtësive të mëdha, gjatë ndeshjes me fashizmin e komunizmin në shekullin e kaluar. Edhe në shkrimet di-skursive kam ngritur zërin, bashkë me një grup të vogël intelektualësh, kundër letërsisë socrealiste, për çka gati e paguam me kokë. Ndjenjat shpirtërore, ngjarjet e mëdha dhe drejtësitë ndaj popullit tim kanë bërë që të merrem me poezi. Në ish-regjimin komunist jugosllav pata shkruar vjershën "Kosova është gjaku im që nuk falet", dhe për pak përfundova në burg, si shumë shqiptarë të tjerë. Por, fati deshi dhe më shpëtoi shkrimtari Esad Mekuli, të cilit gjithnjë i jam mirënjohës dhe i përkulem. Roli i poetit të vërtetë është që kurë të mos heshtë ndaj ngjarjeve të pahijshme shoqërore dhe ndaj padrejtësive që u bëhen popujve o in-

dividëve. Mbi konturet e misterit të quajtur politik u ngrit dhe ekzistenca, edhe identiteti, edhe paqja njerëzore. Nga një mesazh, të themi, mund të ngrihet dhe një rezolutë, një çështje e etnisë. Nëse shteti shqiptar nuk ka politikanë të tillë, nuk do të thotë se krijuesit shpirtërorë nuk e kishin emocionalisht më afër shpirtit At-dheun dhe Kombin. Një pjesë e tyre që nga Rilindja e këndej u shkrinë në vargje për këto çështje madhore. (Fragment nga intervista e fundit e poetit tonë të shquar)

Në fokus

POLITIKA KULTURORE: SI ËSHTË DHE SI DUHET TË JETË!

Shpesh hasim në përkufizimin se politika publike është ajo që qeveria ose ndonjë organ apo institucion tjetër shtetëror, vendos të bëjë ose jo në një fushë të jetës shoqërore, në mënyrë analoge, politika kulturore do të ishte shuma e aktiviteteve të qeverisë që lidhen me kulturën ose çfarë vendosin të bëjnë qeveritë ose të mos bëjnë në sferën e kulturës

Nga Metin IZETI

Ekzistojnë përkufizime të shumta dhe të paqarta formale të politikës kulturore. Disa prej tyre janë të gabuara sepse tregojnë për një kuptim të gabuar të këtij termi, dhe variojnë nga të kuptuarit e politikës kulturore si proces i ndërthurjes së vlerave kulturore në politikë, si proces i kultivimit të politikës, pra hu-

manizimit të proceseve të banalizuara dhe sferës së vulgarizuar të politikës, pasi bëjnë interpretimin se me këtë term bëhet një ndërhyrje e caktuar politike në sferën e kulturës. Edhe pyetja se kush mund të jetë subjekt i politikës kulturore ngre dyshime: a është shteti dhe organet e tij, organizatat joqeveritare, partitë politike, institucionet dhe organizatat kulturore, apo ndonjë subjekt

shoqëror mund të jetë bartës i vepërimit kulturo-politik? Është paragjykim që artistët dhe punëtorët e kulturës nuk duhet të kenë lidhje me politikën kulturore sepse politika në thelb është në kundërshtim me kulturën, si dhe që njerëzit e kulturës që merren me politikë kulturore nuk kanë nevojë për njohuri për mekanizmat e vendimmarrjes, krijimin e strategjive, menaxhimit,

marketingut dhe politikave publike. Nga ana tjetër, nëpunësit shtetërorë që merren me politika kulturore përfitojnë nga njohuritë e historisë së artit, trashëgimisë kulturore, arkeologjisë, historisë, bibliotekarisë, muzeologjisë, turizmit kulturor, industrive kulturore etj.

Qëllimet e politikës kulturore



Qëllimi përfundimtar i politikës kulturore është të stabilizojë sistemin e përgjithshëm kulturor të një vendi dhe të kontribuojë në mënyrë aktive në zhvillimin e përgjithshëm të tij, si dhe të rrisë kapitalin kulturor, kryesisht duke mbështetur krijimtarinë kulturore. Qëllimi i politikës kulturore është shumë i gjerë dhe varion nga menaxhimi i sistemit kulturor, miratimi i ligjeve në fushën e kulturës dhe artit, përcaktimi i modelit të financimit, përcaktimin e pozitës dhe strukturës së Ministrisë së Kulturës në sistemin qeveritar duke u kujdesur për institucionet kulturore dhe eventimet kulturore me peshe të të gjitha komuniteteve brenda shtetit, mbrojtjen dhe afirmimin e trashëgimisë kulturore, mbështetjen për shtëpitë botuese dhe kinematografinë, mbështetjen mediatike, afirmimin e subkulturës në zhvillimin e turizmit kulturor dhe industrive kulturore. Vendimi për politikën kulturore dhe zbatimin e saj është një proces kompleks në të cilin marrin pjesë së bashku organet shtetërore, organet e administratës lokale, institucionet kulturore, organizatat joqeveritare dhe artistët dhe organizatat e tyre profesionale. Është gjithashtu e rëndësishme që gjatë krijimit të politikës kulturore ajo të lidhet me politika të tjera publike, veçanërisht me politikën arsimore, politikën ekonomike, turizmin dhe shkencën, komunikimin, politikën sociale dhe të jashtme. Ne, me shumë të drejtë, shpesh e shtrojmë pyetjen mbi bazën e së cilës mund të vlerësojmë nëse ekziston një politikë kulturore në shoqërinë tonë. Në qarqet tona nuk është e pazakontë të dëgjohet mendimi se politika kulturore nuk ekziston thjesht sepse efektet e saj nuk janë të njohura për publikun ose publiku vlerëson se ato nuk kanë kontribuar mjaftueshëm për të krijuar një sistem kulturor të qëndrueshëm dhe modern, në të cilin dihet saktësisht se kush çfarë roli ka dhe në çfarë qëllimi çojnë ato role. Pra, nëse shteti pranon përgjegjësinë për kulturën, siguron mjete në buxhet për nevojat e sektorit të kulturës, nëse miratohen rregullore nga organi legjislativ që rregullon marrëdhëniet në fushën e kulturës, atëherë shteti duhet të ketë parasysh edhe ndërtimin e filozofisë

së kulturës dhe jo kjo veprimtari të mbështetet në inercion dhe rutinë.

Politika etnocentrike kulturore

Çdo analizë e shoqërisë RMV, përfshirë edhe segmentin kulturor, gjithsesi, duhet të nisë nga realiteti shoqëror. Ky realitet na tregon se shoqëria jonë është një shoqëri e ndarë. Baza e copëzimit të shoqërisë në të gjitha aspektet e jetës është dominimi absolut i parimit etnik. Arsyet thelbësore për mosekzistencën e politikës së mirëfilltë kulturore të RMV qëndrojnë në ndarjet etno-politike të shoqërisë dhe në mosperceptimin real të këtij fenomeni. Struktura e politikës kulturore në RMV, për fat të keq, gjeneron etnopolitikë dhe ndarje etnike të vendit në të gjitha sferat e jetës shoqërore, duke përfshirë edhe kulturën. Prandaj, shkaku i mosekzistencës së një politike të unifikuar kulturore tek ne gjendet në etnocentrizmin kulturor, plogështinë e ministrive ekzistuese, tranzicionin jo të plotë të konceptit socialist të kulturës, modelin dominues të financimit të kulturës, mungesën e inventivitetit të drejtorëve të institucioneve kulturore, mungesa e njohjes në sferën e biznesit të tregut, mospërfshirja në konceptet e menaxhimit kulturor, në konceptet e industrive kulturore dhe turizmit kulturor. Arsyet thelbësore për mungesën e një politike kulturore nuk qëndrojnë në sferën e kulturës, ato gjenden në bazën etno-politike të shtetit, e cila, në parime mendore, shkakton ndarjen etnike të shoqërisë në të gjitha sferat, përfshirë edhe atë kulturore. Duke vënë në dukje se problemet e kulturës dalin nga sfera politike, e vetmja zgjidhje mbetet, për fat të keq, angazhimi politik i artistëve si një faktor domethënës që mund të ndikojë në ndryshimin e raportit të shtetit me kulturën. Gjegjësisht, pothuajse asnjë ndryshim thelbësor në atë marrëdhënie nuk është e mundur përmes ndikimit të kulturës në politikë, por më tepër se është e nevojshme që artistët të angazhohen politikisht, dhe kështu të përpiqen të ndryshojnë raportin midis shtetit dhe politikës ndaj kulturës. Domethënë, jashhtë kësaj, artisti nuk ka akses në fushën politike, ku merren vendime për jetën e kulturës

dhe artit, nëse nuk luan në fushën e tyre, ndërsa ata që luajnë në këtë fushë nuk e kanë haberin e kulturës dhe artit. Nëse artistët vendosin të qëndrojnë në hapësirën e tyre, në bazën kulturore-prodhuese, duke bërë punën me ndërgjegje dhe përgjegjësi, përjetojnë poshtërim ekstrem, mosrespektim për punën dhe profesionin. Prandaj, një politikë unike kulturore në RMV do të jetë e mundur kur ndarja etno-politike do të shfuqizohet dhe do të objektivizohet në të gjitha segmentet shoqërore (arsim, sport, hapësirë mediatike, etj.), përfshirë edhe në sferën e kulturës.

Modeli i politikës kulturore

Duke qenë se shkaqet e mosekzistencës së politikës kulturore tek ne nuk gjenden në sferën e kulturës por në sferën politike, heqja e atyre shkaqeve presupozon transformimin e bazës politike, pra heqjen e etnopolitikës dhe etnizimit të përgjithshëm të shoqërisë. Përveç sa më sipër, një supozim thelbësor për vendosjen e modelit të politikës kulturore në RMV do të ishte transformimi i të kuptuarit ekzistent sekondar të rëndësisë së kulturës për shoqërinë dhe kthimi i saj në vendin që e meriton në shoqëri. Domethënë, kuptimi i kulturës ende dominon ekskluzivisht si pjesë që e ngarkon buxhetin dhe si shpenzime publike të kota. Modeli i politikës kulturore do të duhet të ndryshojë atë pikëpamje dominuese të kulturës dhe të nxjerrë në pah rëndësinë e kulturës si një nga faktorët kryesorë në zhvillimin mendor, etik, por, pse jo edhe ekonomik dhe social të RMV-së. Kuptimi mbizotërues i kulturës si konsum dhe rifokusimi vetëm në mjetet e konfirmimit dhe afirmimit të identitetit etnik ngadalëson rimëkëmbjen dhe zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi. Krijimi i një politike unike dhe pa standarde të dyfish-ta kulturore presupozon një ndryshim në modelin kulturor. Politika kulturore nuk mund të mbështetet më në parimin se kultura është ekskluzivisht përgjegjësi e shtetit. Në vend të modelit aktual të politikës kulturore, që redukton menaxhimin kulturor në politikën e zgjidhjeve ad hoc, financimit dhe bashkëfinancimit të projekteve pa kriteret e qarta,

ndikim politik dhe etnik në shpërndarjen e fondeve, ndikim politik në zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve kulturore, mungesa e qëllimeve strategjike - politika bashkëkohore kulturore në RMV duhet të ketë parasysh edhe postulatet e mëposhtme:

- Ministria e Kulturës duhet të jetë funksionale dhe përgjegjëse për vendosjen dhe zbatimin e politikës kulturore në territorin e të gjithë shtetit dhe njëjtë për të gjithë. Kjo në asnjë mënyrë, nuk duhet të nënkuptojë anulimin e kompetencës për zbatimin e politikës kulturore në nivelet më të ulëta të organizimit shtetëror;
- Alokimi i fondeve nëpërmjet normave tatimore për fondet për kulturë dhe vendosja e lehtësirave tatimore për ata që investojnë në kulturë;
- Transformimi i të kuptuarit të kulturës ekskluzivisht si pjesë e shpenzimeve publike, pra ndërgjegjësimi për rëndësinë e kulturës për zhvillimin mendor, artistik, social dhe ekonomik të vendit;
- Lehtësimin e zhvillimit të barabartë të kulturës institucionale dhe të pavarur;
- Investimi në turizmin kulturor dhe industritë kulturore;
- Lidhja ndër-institucionale e kulturës me ekonominë, turizmin dhe ekologjinë - e cila do të ndikojë në krijimin e vendeve të reja të punës, zhvillimin social dhe përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës;
- Transformimi i modeleve ekzistuese organizative dhe menaxhuese në institucionet kulturore dhe rritja e alokimeve nga buxheti për përmbajtjen programore dhe projektore;
- Produktet kulturore pjesërisht t'i nënshtrohen valorizimit të tregut;
- Ndryshimet në kuptimin e rëndësisë së kulturës për shoqërinë duhet të shoqërohen me ndryshime në legjislacion;
- Në shoqërinë e RMV-së kultura duhet të jetë një faktor që kontribuon në forcimin e kohezionit social dhe luan një rol të rëndësishëm në procesin e pajtimit dhe bashkëveprimit shoqëror;
- Në epokën e globalizimit të përgjithshëm, mbrojtja dhe afirmimi i trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale duhet të mundësojë mbijetesën dhe ndërtimin e identitetit grupor/kombëtar.

Në shiritin e kohës

SI E KAM NJOHUR FAIK KONICËN...

Unë isha i shkurtër e i bëshëm, Konica ishte i gjatë e i thatë, kështu që të dy do të dukeshim si Don Kishoti me Sanço Pançën të arratisur nga ndonjë cirk

Fan S. NOLI

E kam takuar Konicën për herë të parë më 1909. Ishte diçka që nuk kam për ta harruar kurrë. Më kishte shkruar nga Londra se do të vinte në Boston i veshur me kostum shqiptar. Ideja ishte që të dilte fotografia

e tij në gazetë dhe të shfrytëzohej rasti për të propaganduar çështjen kombëtare shqiptare, e cila ka qenë pasioni i gjithë jetës së tij. Unë mbeta i shtangur. Si prift ortodoks i modës së vjetër, në atë kohë unë vetë mbaja një mjekër të gjatë të zeze, përtëcilën më duhattë pranojse

nuk u pëlqente djemve të Bostonit. E merrja me mend se sa do të dëfreheshin ata djem po të më shihnin duke ecur me një burrë të veshur me fustanellën shqiptare, ndonëse nuk kisha parë kurrë ndonjë fustanellë greke, një lloj fundi i balerinave. Unë


isha i shkurtër e i bëshëm, Konica ishte i gjatë e i thatë, kështu që të dy do të dukeshim si Don Kishoti me Sanço Pançën të arratisur nga ndonjë cirk. Sa u habita këtë herë kur pashë se djemtë e Bostonit e harruan gjithçka lidhur me

mjekrën time dhe thjesht zunë të shihnin Konicën me adhurim. Atëherë e kuptova se fustanella shqiptare nuk ishte fustanellë qesharake greke, por diçka që i ngjante kiltit të skocezëve dhe se i përshtatej shumë një burri të pashëm si Konica. Meqë ra fjala, lexuesi mund ta gjejë në librin e Konicës ndryshimin ndërmjet kostumit grek dhe veshjes shqiptare: është e vërtetë se grekët e kanë përshtatur nga shqiptarët, por ata u përpoqën ta stërhollojnë saqë e bënë një veshje grash me aq sa mundën. Veshja e Konicës nuk ishte e vetmja gjë që më habiti. Thjesht mbeta pa mend kur ai nisi të më "mësonte" për çdo gjë në botë. Ishte njeri me kulturë të lartë. Gijom Apoliner, një shkrimtar dhe mik i tij, e ka quajtur "enciklopedi shëtitëse" që e fliste frëngjishten si një francez. Një shkrimtar tjetër, Zhyl lë Metrë, ka shkruar për të: "Ky i huaj që e shkruan kaq mirë gjuhën tonë". Si studiues i pasionuar i muzikës, Konica e adhuronte shumë Wagnerin. Një nga gjërat e para që bëri ai pasi u takuam ishte të më tregonte për Wagnerin dhe operat e tij. Me këshillën e tij e pashë për herë të parë Parisfalën, kur u dha më 1910 në Boston. Në varrimin e tij, tridhjetë vjet më vonë, duke e ditur se sa shumë e donte Wagnerin, iu luta organistit të luante muzikën e Wagnerit nga kreu deri në fund. Ka disa fakte që mungojnë në librin e papërfunduar të Konicës, fakte për Shqipërinë, që i kam mësuar prej tij. Për shembull, Konica flet për krenarinë e malësorëve shqiptarë. Zonja Durham e pranon këtë në librin e saj "Brenga e Ballkanit". Kur përshkruan shpërndarjen e ndihmave në Maqedoni gjatë dhjetëvjeçarit të parë të shekullit të njëzetë, ajo na tregon se si gratë fshatare e rrethonin ditë e natë, duke i kërkuar ushqime dhe rroba. Ata vendoseshin rrotull shtëpisë ku banonte ajo dhe nuk largoheshin derisa të merrnin diçka. Edhe kur u shpjegoi se nuk kishte më asgjë për t'u dhënë, ato nuk shkuleshin. Kur zonja Durham va-

jti në Shqipëri, priste që t'i ndodhte njësoj. Për habinë e saj, askush nuk iu afrua për t'i kërkuar ndihmë. Konica përmend edhe faktin se zonja Durham ka qenë një adhuruese e madhe e amvisës shqiptare. Ajo mendonte se vetëm amvisa holandeze mund të krahasohej me të për pastërtinë. Zonja Durham kishte të drejtë. Mjafton të shkosh për vizitë në shtëpitë e shqiptarëve në Shtetet e Bashkuara dhe mund ta shohësh dallimin ndërmjet amvisës shqiptare dhe shumë prej fqinjëve të saj që nuk janë shqiptarë. Një gjë që e ka lënë jashtë Konica është fakti që fqinjët ballkanas e italianë kanë shpifur se shqiptarët janë të egër e të pamëshirshëm. Zonja Durham na thotë se kjo nuk është e vërtetë. Ajo kishte parë fshatarët sicilianë se si i rrihnin pa mëshirë kuajt dhe gomerët, por kurrë nuk kishte qenë dëshmitare se si një shqiptar rrihte një kafshë. Unë e kam vënë re edhe vetë kur kam udhëtuar me kalë në Shqipëri. Sa herë vinim te ndonjë copë rrugë e vështirë, ishim të detyruar të zbrisnim dhe kafsharët gjithnjë përdornin fjalët përkdhelëse për t'u dhënë zemër kafshëve, si për shembull: "Hajde, vëlla. Ec, orbir; Nuk është dhe kaq e vështirë. Do ta kalojmë". Një shpifje tjetër e përhapur nga fqinjët tanë, është se shqiptarët qenkan njerëz që nuk u shtrohen ligjeve. E vërteta është krejt e kundërt. Ata u binden shumë më tepër se gjithë fqinjët e tyre. Statistikat e rajoneve të policisë në qytetet amerikane ku ka shqiptarë dëshmojnë qartë se ata janë nga grupet më të mira ndër të gjithë të ardhurit e huaj. Përvoja ime e gjatë më ka vërtetuar se shqiptarët u binden ligjeve në Shqipëri po ashtu siç u binden në Shtetet e Bashkuara. E keqja është se, kur fqinjët e Shqipërisë përpiqen të shkelin tërësinë e saj tokësore, atëherë shqiptarët "e paligj" ngrenë krye. Kur përshkruan pamjet e bukura të Shqipërisë, Konica përmend shumë turistë të huaj që e kanë admiruar këtë vend. Një emër, që megjithatë

mungon, është ai i prozatorit, dramaturgut dhe kritikut muzikor francez, Roman Rolanit, i cili në njërin nga librat e vet flet për "kodrat e bukura të valëzuara të Shqipërisë". Unë për vete i kam soditur nga maja e malit Tomor dhe nga kështjella e Krujës, kryeqyteti i vjetër i Skënderbeut. Nuk kam parë gjithë jetën time gjë më të bukur. Mjaft shtesa mund t'i bëhen kapitullit të Konicës për vetitë luftarake të shqiptarëve. Për shembull, kalorësit shqiptarë u bënë proverbialë në gjithë Evropën pas vdekjes së Skënderbeut. Gjithë mbretërit dhe sundimtarët e Italisë, Francës, Britanisë së Madhe kanë marrë kalorës të lehtë shqiptarë për ushtritë e tyre. Konica më ka thënë një herë se në shekullin e shtatëmbëdhjetë, kur francezët kërkonin të lavdëronin një kalorës, shpreheshin: "E nget kalin si një shqiptar". Kemi disa dokumente italiane që flasin për kalorësinë shqiptare dhe që na shpjegojnë se si Skënderbeu e shpëtoi mbretin Ferdinand të Napolit me kalorësinë e vet të lehtë. Sipas dëshmisë së historianëve bashkohës, Ferdinandi e kishte humbur davanë kur e braktisën banorët feudalë dhe u bashkuan me Rene Anzhuanë, që ishte rivali i tij francez dhe që pretendonte fronin e Napolit. Dihet mirë se ushtritë mercenare të Rilindjes asnjëherë nuk bënë ndonjë betejë të vërtetë. Ata kujdeseshin jo për lavdinë ushtarake, por për pagat. Zakonisht krijohej një komitet i përbashkët i të dy ushtrive rivale dhe vendoste kush do të shpërblehej me fitoren. Për shembull, kur njëra nga ushtritë kundërshtarë kishte epërsi të padyshimtë si numër, asaj i jepej fitorja pa e zgatur shumë. Kur ushtritë ishin të barabarta nga numri dhe komiteti nuk mund të merrte vesh se cila palë mund të fitonte, atëherë kurdisej një betejë e shtirë, në të cilën nuk dëmtohej ose nuk vritej askush, me përjashtim të ndonjë aksidenti. Por kjo manovër shërbente për të ndihmuar komitetin e përbashkët që të merrte një vendim. Diçka e ng-

jashme ndodhi kur Skënderbeu zbriti në Itali me kalorësinë e vet të lehtë. Komandanti i ushtrisë kundërshtarë, konti Piçinino dhe Skënderbeu rregulluan një betejë të tillë të shtirë për të parë se cila nga të dy ushtritë do të kishte më shumë shanse për të marrë fitoren. Dy reparte të zgjedhura nga ushtria shqiptare dhe italiane bënë një paraqitje të kalorësisë dhe të aftësisë luftarake. Shqiptarët e fituan ndeshjen dhe kështu u mbyll gjithë kjo histori. Italianët asnjëherë më nuk e kundërshtuan epërsinë e kalorësisë shqiptare. Natyrisht, me turqit ishte një punë krejt tjetër. Atëherë Skënderbeu i duhej të bënte betejë reale dhe të arrinte fitore reale. Turqve nuk u bënte përshtypje asnjë paradë. Skënderbeu ka qenë, pa dyshim, një gjeneral i madh dhe ai meriton nderime të mëdha për kryqëzatën e tij heroike kundër turqve. Por ne nuk duhet të harrojmë se edhe ushtarët e tij meritojnë pjesën e tyre të nderit. Kryengritja shqiptare e viteve 1910 - 1912 kundër turqve tregoi se luftëtarët e çetave shqiptare ende e ruanin trimërinë dhe forcën e gjallë që kishin dëshmuar në kohët e vjetra në Skënderbeun. Vetëm për vetëm ata i mundën turqit, marshuan në Selanik dhe e detyruan qeverinë turke t'u jepte autonominë. Pas disa muajsh iu desh gjithë kombeve të Ballkanit që të bashkoheshin për t'i mundur po ata turq. Më 1920 atje u përsërit po ajo histori e përjetshme. Shqipërinë e kërcënonte copëtimi. Italia kishte pushtuar Vlorën dhe prapatokën e saj deri në Gjirokastër. Fqinjët e tjerë kërkonin copat e tyre sipas traktatit të fshehtë të vitit 1915. Vetëm një zë u ngrit për të kundërshtuar, ai i president Wilson. Por ai mjaftoi për të ngritur kombin. Malësorët shqiptarë të bregdetit jugor qenë të parët që u ngritën, pastaj i ndoqën edhe të tjerët. Brenda pak muajve italianët u hodhën në det dhe u detyruan ta linin Vlorën dhe rrethin e saj. Rreth njëzet vjet më vonë,



më 1940 grekët, pothuaj shtatë herë më të shumtë si numër sesa shqiptarët, nuk mundën ta përsëritnin këtë marifet, ndonëse kishin mbështetjen e flotës angleze dhe të forcave ajrore angleze, që i penguan italianët të sillnin përforsime. Tani disa fjalë për vendin e Konicës në historinë e Shqipërisë së sotme. Si mysliman dhe si përkrahës i një familjeje të vjetër aristokratësh nga Shqipëria e jugut, Konica kishte të gjitha mundësitë që të fitonte poste të larta në Perandorinë Turke, ku Shqipëria bënte pjesë, që pas vdekjes së Skënderbeut. Në të vërtetë, shumë shqiptarë të tjerë gjatë shekujve

ishin ngjitur në postet më të larta të Perandorisë Turke. Për shembull, kur Konica ishte i ri, Vezir i madh ose kryeministri i Perandorisë Turke ishte Ferid Pasha, një shqiptar nga Vlora. Por kjo karrierë nuk e tërhiqte Konicën. Ai mendonte se misioni i tij ishte të luftonte për pavarësinë e Shqipërisë. Nga viti 1897 deri më 1912, dy nga pionierët më të shquar të pavarësisë së Shqipërisë kanë qenë Konica dhe Shahin Kolonja, botuesit e dy revistave shqiptare, që dolën jashtë: "Albania" dhe "Drita" përkatësisht. Gjatë sundimit turk shqiptarët kishin harruar gjithçka për lavdinë e tyre të kaluar nën Skënderbeun.

Konica ka qenë njeriu që e rizbuloi dhe e popullarizoi Skënderbeun e flamurin e tij, shqipen e zezë dykrenare në një fushë të kuqe. Ky flamur u bë simbol i pavarësisë kombëtare dhe më në fund u ngrit në Vlorë më 1912 nga Ismail Qemali, kur Shqipëria u shpall shtet i pavarur. Konica është quajtur si krijuesi i prozës moderne shqipe. Kur unë vendosa të bashkohesha me kryqëzatën për pavarësinë e Shqipërisë, e para gjë që më bëri përshtypje ishte mungesa e plotë e veprave letrare shqipe me vlera artistike. Por kur vajta në Egjipt më 1903, një atdhetar shqiptar, Spiro Dineja, më dha vëllimet e

revistës "Albania" nga viti 1897 deri më 1903. I lexova të gjitha nga faqja e parë deri tek e fundit dhe atëherë e mësova se në shkrimet e Konicës ne e kishim atë që na duhej: letërsinë e mirë shqipe. Për më tepër, Konica zbuloi dhe popullarizoi shqiptarë të veprimtarisë letrare si Kristofordhi, Mitkoja, Fishta dhe Zako Çajupi. Me këshillën dhe udhëzimet e tij unë përktheva disa vepra nga Shekspiri, Ibseni, Edgar Allan Poeja dhe Don Kishotin e Servantesit. Të gjithë autorët shqiptarë që vijjnë pas Konicës janë nxënësit e tij, duke përfshirë dhe shkruesin e këtyre radhëve.

Interpretime

SHTËPIA E SËMURË

Libri SHTËPIA E SËMURË hapet me poezinë moto Kështjella, që i përmbledh të gjitha objektivat që i synon shkrimtari: shkrimin e ri, protestën krijuese, qëndrimin ironizues ndaj realitetit


Nehas SOPAJ

Poeti Teki Dërvishi, i cili në krijimtarinë e tij do të bëjë me gisht kah e keqja (morale, shoqërore, kombëtare e sociale), i cili në të gjitha llojet letrare, poezi, prozë e dramë, do ta reflektojë kohën dhe hapësirën konkrete dhe i cili në veprat e tij do të theksojë për herë të parë sintagmën *këtë libër do ta shkruaj përsëri*, sikur na bën me dije se njeriu për jetë të vet s'bën asgjë tjetër, pos që e shkruan vetëm një libër të tij të vetëm, librin e jetës së tij. Kjo sintagmë metaforike, duke nisur prej librit SHTËPIA E SËMURË e deri në krijimet e tij më të reja, do të përsëritet si koncept si në poezi e roman, ashtu edhe në dramën poetike, kjo me synim që në të gjitha këto lloje letrare, në fakt, t'i nënshtrohet një sistemi sinkretik të përpunimit artistik, përmes të cilit do ta shprehë besnikërisht botën e brendshme të njeriut, duke e ngërthyer atë në të, pra raportet e heroit të tij lirik me rrethën dhe botën rreth tij. Këtë metaforë letrare, do ta ndërtojë me sukses në të tri llojet letrare, por në të tri këto lloje letrare të botës së gjerë krijuese te ai do të prijë *liriku mbi epikun dhe dramatikun*, një fah origjinal i tij, që duket sheshit se dominon mbi llojet e tjera. Këtë e dëshmon si në librat me poezi lirike, ashtu edhe në romanet dhe dramën poetike - dramën me natyrë thjesht lirike dhe romanet me elemente të theksuar të lirizmit. Një mori elementesh gjuhësore, gjenealogjisht, e dëshmojnë burimësinë e thjeshtë lirike të mbarë krijimtarisë krijuese. Ato tregojnë se fjala e tij letrare, për nga natyra, është thjesht lirike, kurse lirika është lirikë e pastër, një dell purolirik. Bota e tij letrare, koncepti për letërsinë dhe botëkuptimi i tij i përgjithshëm gnoseologjik për botën dhe jetën, është fah i lindur i artistit Libri SHTËPIA E SËMURË hapet me poezinë moto *Kështjella*, që i përmbledh të gjitha objektivat që i synon shkrimtari: shkrimin e ri, protestën krijuese, qën-

drimin ironizues ndaj realitetit, metaforën konkrete - *shtëpinë e sëmurë* që mund ta marrësh si të duash, qoftë Jugosllavinë e vitit 1978, vendin dhe kohën e "lumluturisë" së "vëllazërim-bashkimit", ku socializmi titist mugullonte me "mirëqenie", "pacifizëm" dhe "lumturi" (lexo saktë: shtypje, dhunë, padrejtësi ndaj shqiptarëve, borxhe prej më shumë se 20 milionë markash gjermane Perëndimit, që vonë do të paguhen me zhbërje të shtetit nga faqja e dheut si kreature artificiale), qoftë Kosovën me zërin protestues të poetit, që nuk e do "atin e dheun", që d.m.th. nëntekstet, të cilat lexuesi mund t'i marrë me drojë, për shkak se gjithçka aty shqiptohet me ironi, alegori dhe sarkazëm, por që koagulohet me protestë, herë të hapur e herë të mbyllur. Të mos harrojmë se është koha e censurës, një kohë kur krijuesit përpiqen ta krijojnë lirinë e munguar me anë të shkrimeve "të vështira" (I. Rugova), një kohë kur frymohej brenda ngushticave të manovrimit të atyre vakumeve dhe të atyre ngricave të mendimit, kur rrallë jepej mundësia që njerëzit ta thonë atë që realisht e mendonin. Këtu, në poezinë moto *Kështjella*, poeti flet i deprimuar dhe i irrituar totalisht nga keqja që atij vijon ngashtë, nga një prej dhomave të shtëpisë së sëmurë dhe që është mbledhur si një shpirt që do të dalë jashtë vetvetes, sepse atij i ka dalë majë hundë të jetuarit e këtyllë. Prandaj ai zbret në pathos, në shkallët e një realiteti skajshmërisht të hidhur. Këtu flet një shpirt njeriu pa ekuivoqe, duke iu drejtuar Perëndisë që ta shpëtojë nga kjo odë e shtëpisë së sëmurë, ku ai gjendet pa dëshirën e tij e duke këlthitur me zë të lartë: "unë nuk e dua atin e dheun". Teksti duhet kuptuar figurativisht - porosia e autorit duhen lexuar me kuptimin çfarë është standardi i përgjithshëm ontologjik dhe gnoseologjik i një kulture lexueshmërie, që të mund të kuptohen lehtë aludimet e poetit me një tekst me nëntekst të mbyllur. Pra, figurat duhet kuptuar ashtu si i përdor autori, në mënyrë që teksti të receptohet drejt. Brenda 23 vargjeve,

poezia mëton të jetë sa poezi moto, poezi gesllo, poezi odë, po kaq edhe poezi himni e shpirtit njerëzor, që aspirojnë lirinë, një klithmë për liri që del

nga kaosi i shpirtit të ndezur nga ankthi ku gjendet dhe prej nga dëshiron të dalë në sferat e gjera pa shtrëngesë, në fushat e lira pa kufizime.



KËSHTJELLA

Perëndi

Ti po më do shumë

Kaq shumë sa duhet vetëm martiri

Kurse unë jam një qen me zgjebe, një mace e zezë

Vetëm sipër gafës nuk kam plagë që qelbet

Pse më detyron të të frymoj

Mos më mundo!

Të ishe diçka që mund të të prek me dorë

Unë do të kisha djegur

I ngjaj muzgut të Ulan Batorit...

...bishtit të miut, xhenazes së gjallë

Protesta ime është tepri e bishtit të këputur

Të zhapinit kur përpëlitet

Më urre një herë si Poen

Të ndjej si zgjohet balsam i një Baudelaire - i të ri

Gjuhën po e hedh si pluhurin mbi bar

Më theri me singi në zemër Ivan Grozni

Katër shekuj më parë

Më le të dal e të ik nga kjo dhomë e sëmurë e Kështjellës

Në një paqenësi tjetër më jetëso, në trajtë kafshe, pa gjuhë

Me fjalët e mia, mua të vetmin, mos më helmo!

Dua të dal nga kjo odë e sëmurë

Dua të ik... dua të ik...

Unë nuk e dua atin e dheun!

Shkurtimisht dhe tekstualisht, nga ky shkrim ligjërimit/rrëfim i vetës së parë, që flet me zë të lartë, e mësojmë këtë kallëzim: ti, Perëndi, mirë që po më do mua shumë, kaq sa duhet vetëm një martir, por unë s'e meritoj këtë të mirë tënden, sepse unë jam vetëm një qen me zgjebe, një mace e zezë etj., andaj si po më do mua kur unë nuk të dua ty?; andaj krejt çka mund të bëj tash unë është vetëm të të djeg ty (po të kisha mundësi, kuptohet); vështrëmë pa këzmë mirë dhe dot të bindesh se unë

ingjaj muzgut të Ulan Batorit, bishtit të këputur të zhapinit, xhenazes së gjallë; prandaj ç'po të duhem unë ty kur unë s'jam për t'u dashur, por për t'u urreyer? Kështu, ti më mirë e ke të më urresh, më urre si Poen (E. A. Po, poeti më i dashur i autorit) për shembull, prandaj më lejo të ndjej si zgjohet balsami i Baudelaire-it të ri në mua, se mua kahmot më ka ther singia e Ivan Groznit; po pra, unë po dua të dal nga kjo dhomë e sëmurë e Kështjellës, prandaj në një paqenësi tjetër më jetëso, në trajtë kafshe pa gjuhë, sepse: protesta ime është tepri e bishtit të këputur / të zhapinit kur përpëlitet. Pas gjithë këtij rrëfimi të lirë timin, që i ngjet një maksime a paradoksi të shqiptuar si ironi e thellë, vargu i fundit i kësaj poezie të ngarkuar me dykuptimësi, aludime, ironi dhe sarkazëm, sikur e shpjegon gjendjen e ankthit e të kaosit të brendisë së heroit lirik: unë nuk e dua atin e dheun. Ky varg me dy metafora të mëdha (Ati, Dheu) sikur mëton t'i shpjegojë gjakimet e alternativave të kuptimeve të ndryshme që mblidhen në një kuptim të vetëm si më lart. Ky është leximi i parë, i lirë, i poezisë që brenda vetes i ka përfshirë tërësitë semantike të figurave narrative, të cilat janë transparente për receptim nga lexuesi. Për një interpretim të saktë të aludimeve të kësaj poezie, pastër lirike e kontekstuale, lus lexuesin për ta mikrolexuar saktë dhe pa hipoteka poezinë edhe një herë, ashtu siç ka dalë në libër, për t'u bindur se vargun e fundit - unë nuk e dua atin e dheun, figurat simbole, at e dhe, duhen lexuar me germa të mëdha, pra At e Dhe, që ta kemi sa më të qartë peshën e fjalëve të theksuara si figura, për çka e ka fjalën autori. Duke e lexuar këtë poezi, por edhe poezitë e tjera të librit Shtëpia e

sëmurë, lexuesi fiton përshtypjen për natyrën e saj si poezi eksperimentale, thellësisht ironike, dhe me një alegori të dukshme e të qëllimshme, me një dritësim të një vërtete, që në kohën kur qe botuar, më shumë se e guximshme, paraqitet tepër e kulturuar, që d.m.th. se ky tip poezie brenda vetes i kishte gërshetuar të gjitha përvojat e lexueshmërisë dhe të angazhimit letrar të autorit, aq sa kishte ndikuar edhe në emancipimin e vargut shqip, duke e bashkërenduar atë në piedestalin e shkallës më bashkëkohore jashtë shqipes. Poezia ka një repertor figurash që flasin për matje me të arriturat fundore të kohës në arenën ballkanike, por edhe europiane: kultura e fjalës dhe e mendimit me të tjerët duhen baraspeshuar që mesazhi poetik i saj të kuptohet saktë dhe pa gabim. Pak është të thuhet se kjo poezi është tip i poezisë së protestës (e cilësuar ashtu që atëherë në kohën kur qe botuar), pra poezi e një angazhimi të moderuar. Ajo, në të vërtetë, është një poezi tipike postmoderne, thënë me gjuhën e kohës sonë, kur edhe ajo kishte lindur. Pra, poezitë e këtij libri janë ironi e kohës që e lamë pas, pasqyrë besnike që e portretizon profilin e shkrimtarit disident, i cili arrin ta thotë atë që e mendon, qoftë edhe kur i kishte ndjekësit prapa, censurëkuqë e bredharakë, që vërtiteshin si hije të zeza. Poezia moto Kështjella, brenda rrëfimit të saj, i ka "djegat" e shpirtit në majë të thërimeve brendapërbrenda vetes - të thuhet e vërteta në konditat kur ajo duket e pamundur të thuhet: Perëndi... unë nuk e dua Atin e Dheun. A ka më qartë se kjo protestë.

Qasje

LIRIKA E LUFTËS NGA FATOS ARAPI

Fatos Arapi ishte 13 vjeç kur filloi Lufta e Dytë Botërore. Në këtë moshë fëmijërore, njeriu ka formuar pjesën më të madhe të personalitetit të tij, prandaj ai u rreshtua në radhët ushtrisë antifashiste. Këto dëshmi interesante gjenden herë pas here në poezinë e tij.

Nga Bernard ZOTAJ

Temën e lirisë Fatos Arapi e ka trajtuar në lirikën e luftës, veçmas të Luftës së Dytë Botërore, një realitet që poeti e ka prekur me dorë, e për të cilin ka një kujtesë dhe dëshmi të patjetërsueshme. Lirika e luftës është ndërtuar mbi raportet e njohura tradicionale, pasi më së shumti ajo është shkruar në një kohë kur vepronte mekanizmi i censurës. Në të bien në sy reliktet, raportet e drejtpërdrejta mes subjektit dhe figurave të luftës, kryesisht dëshmorët e lirisë. Lirika e luftës, motivet që

burojnë nga ky realitet shqiptar kanë qenë të trajtuara që në periudhën e parë të poezisë së poetit, qoftë në poezi apo vjersha, po edhe në poemat "Drejt qindra shekujsh shkojmë" dhe "Alarme të përgjakuara", poema që nuk i shkëputën dot metodës së realizmit socialist. Duke qenë një ithtar i paepur i çështjeve të lirisë në kuptimin universal, jo rrallë në poezinë e Fatos Arapit hasen nota patetike, të cilat përbëjnë dhe atë zonë të epërme të karakterit luftarak, në të cilin plekset një lloj patosi revolucionar, që lidhet posaçërisht me motivin e lirisë.

Në vëllimin poetik "Drejt qindra shekujsh shkojmë", Arapi ka një buqetë poetike për dëshmorët që ranë në kërkim të lirisë për Shqipërinë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Cikli "Në varrezat e dëshmorëve në Vlorë", ku poeti shfaqet në një lloj komunikimi të drejtpërdrejtë, veçmas me Luftën e Dytë Botërore, të cilën e vlerëson si një luftë të drejtë dhe vazhdim i traditës shqiptare për liri. Poezia "5 maji", përveçse ka një "ligjërimit" të detyrueshëm politik si "Partia vjen./ si ai prindi, që birin ka këtu...", duke qenë letërsi e

realizmit socialist, ajo mbart një metaforë të fuqishme, që shpjegon lidhjen e fortë të Shqipërisë dhe të shqiptarëve me lirinë, kujtimin dhe nderimin e saj, ndaj poeti e mbyll poezinë: "Atdheu i ri ngrihet... po ndodhka dhe kështu;/ vitet shkojnë tutje...ju vini tëhu". Në katërmbëdhjetë poezitë e këtij cikli, që Fatos Arapi ka shkruar për dëshmorët e luftës nga Vlora, mjaftueshëm lexuesi mund të formojë një mozaik, një tablo mjaft domethënëse, ku spikat ndjenja e lirisë, ëndrra e lirisë, patosi revolucionar,

lidhja e fortë që Lufta e Dytë Botërore pati me popujt, dëshmorët që kanë falë rininë e tyre dhe moshën më të bukur për këtë tokë të lashtë, e cila ndër shekuj ka mbijetuar e ka mbetur "tragjike si një këngë e përgjakur,/bërthamë legjendash e maleve tona...", e cila sado e vogël, sado e sulmuar, sado e kafshuar, ajo ka mbetur përjetësisht tokë arbore. Fjala "arbore", në këtë rast përdoret si përkujtim i kohës së Skënderbeut.

Dëshmorët e Atdheut

Cikli për dëshmorët e Atdheut i ka mundësuar poetit të "raportojë" një element të rëndësishëm të psikologjisë popullore lidhur me luftërat e drejta, për të cilën gjejmë mbështetje të madhe ndër masat popullore, përgjithësisht në vendet e varfra dhe të prapambetura në raport me marrëdhëniet kapitaliste në prodhim. Në poezinë që i kushtohet dëshmorit Piro Palla, vargu i parë i saj "pranë fjalës Bukë është fjalë Liri\ pavarësisht se bëhet fjalë për Shqipërinë, poeti e çon mendimin e lexuesit te njeri nga burimet e fuqizimit të luftërave çlirimtare, veçmas të Luftës së Dytë Botërore, parë në konceptet ekonomike, që poeti i njëjti mjaft mirë, në popujt ballkanas dhe të gjithë popujt tjetër të Lindjes, që vinin më së shumti nga shtresat e varfra, shtresa të cilat gjatë kësaj kohe ishin zhytur në varfëri e mjerim, si rezultat i zhvillimit jo të drejtë të oligarkisë kapitaliste të Europës Perëndimore. Përmes subjekteve lirike, të cilat në fund të fundit përbënin dhe realitetin e kohës, poeti arrin të krijojë kronikën jetësore, kushtet dhe burimet e pakta ekonomike me të cilat përballëshin shqiptarët në përgjithësi, si në qytet dhe në fshat, por edhe Vlora e tij, të cilën ai e njëjti mjaft mirë. Dëshmori shegert Fiqiri Muka, vjen në ciklin e dëshmorëve përmes një syri të hollë dhe kritik për realitetin e kohës, ku poeti shkruan: "Fati i grisur i një shegerti,/ Shorti i verbër i një jetimi,/ Kërcënimi i egër i Kryemjeshterit./ Treçerek leku në ditë shpërblimi...", duke sjellë përveç një detaj poetik, që nis me një konstatim real jetësor, por në pasazh ka një informacion të dendur, si në një kronikë lufte, e cila e ndez akoma më shumë brenda shpirtit njerëzor ndjenjën e lirisë, që shfaqet akoma më shumë dhe si protestë. Ndërsa përkujtimi për dëshmorin Jani Mone është një simbiozë komplekse për lirinë, e cila i paraprin gjithë ciklit "Në varrezat e dëshmorëve në Vlorë", ajo përbën në vetvete një kredo të pazakontë që poeti mund ta ketë shkruar në ndonjë rast tjetër. Thuajse gjithë motivet që e ushqejnë ciklin e dëshmorëve të Atdheut si: Teli Ndini, Xheladin Beqiri, Kastriot Muço, Mustafa Matohiti, Shyqyri Alimerko, Fejzo Gjomemaj, Mitat Dauti, Lefter Sallata, Pirro Palla, Fiqiri Muka, Jani Mone, Fadil Dauti, Zaho Koka, Hysen Qino, Sulo Didi, Dalan Daljani, përbëjnë një dëshmi të rëndësishme për Luftën e Dytë Botërore, e cila në poezinë e Fatos Arapit zë një vend të rëndësishëm e njohur ndryshe si lirika e luftës. Në këto poezi shquan një ndjenjë sinqeriteti dhe vërtetësie, poeti nuk i zmadhon ngjarjet dhe bëmat e luftës. Atë e ka prekur thellësisht moshja e re e luftëtarëve, të cilët janë dallëndyshet e para që ndiejnë stinët


e mira të kombit dhe vendit, përndryshe numri më i madh i të rënëve në luftë nuk do të ishte nga të rinjtë. Ndryshe, prej shumë poetëve të tjerë, por dhe të krijimtarisë së gjerësishtme dhe shumë subjektsh të temës së luftës, e cila zë gati gjithë kohën e poezisë së realizmit socialist, qoftë edhe të poetëve të rinj, poezia, d.m.th. lirika e luftës, të cilën e lëvroi Fatos Arapi nuk është ngritur mbi strukturën imagjorative. Në të nuk ka shumë gojëdhëna, nuk ka mitizim, frymë baladash, si një përvojë e përdorur gjerësisht në vend, me një frymë folklorike, por në to ka vërtetësi, janë ngjarje e detaje që poeti në fëmijërinë e tij i ka parë vetë me sytë e tij, andaj ato janë të ndjera thellësisht në shpirtin e tij, janë të thjeshta, shprehëse dhe mbartin emocione të vërteta.

Orientim historik në anën e lirisë

Betejat që shqiptarët bënë gjatë Luftës së Dytë Botërore, në një konflikt të ashpër global janë një e vërtetë e padiskutueshme, ajo është një ngjarje që tregoi orientimin historik të shqiptarëve në luftërat e tyre, duke qëndruar në anën e arsyeshme të lirisë. Siç është shënuar që në çështjet e formimit të poetit Fatos Arapi, ai ishte një poet me aftësi të mirëfillta të njohjes dhe të studimit të historisë, kështu që cikli i luftës nuk ka dalë jashtë kornizës së të vërtetave historike, përveç diskursit poetik që i përshkon këto të vërte-

ta të mëdha, që sollën këta njerëz të thjeshtë të Vlorës dhe të vendit të tij. Natyrisht, në këto poezi, për shkakun e burimeve jetësore të të rënëve që poeti ka zbuluar artistikisht në ciklin e dëshmorëve, kanë të bëjnë me figuracionin, "ligjërimin" e brendshëm të krijimeve, elementet motivues, timbrin revolucionar, ku natyrisht, siç thotë poeti Ali Podrimja: "... janë dëshmi e një ekzistence që po merrte formën e vetdrejtpeshimit se ishin 'brenda kokrës së grurit': gjyshërit, stërgjyshërit, prindit, me, të tjerë et tjerë...", gjithsesi në një luftë të tillë, shqiptarët arrinin që aktet e të rënëve, rast pas rasti i kthenin në mbushje të radhëve partizane gjatë kësaj lufte të shek. XX. Përveç traditës luftarake, të luftërave të shumta që shqiptarët kanë bërë në historinë e tyre, për të siguruar jo vetëm mbijetesën, territoret tokësore dhe emrin e tyre në historinë e popujve e të kombeve, një tjetër përvojë e tyre është lufta për të ruajtur identitetin kombëtar. Fatos Arapi ka rezultuar se si një nga luftërat më të mençura dhe më të rëndësishme që kanë bërë, fjalimi i Skënderbeut kur erdhi në Shqipëri dhe në Besëlidhjen e Kuvendit të Arbërit në Lezhë, janë të rëndësishme, pasi në të ka një të vërtetë të madhe lidhur me çështjen kombëtare të shqiptarëve. Më tej duke shtresuar akte mbijetese dhe ekzistenciale në ndërgjegjen dhe memorien e kombit, sa që ato kanë rëndësinë e mi-

tit, i cili zgjohet ndër shqiptarët sa herë bëhet fjalë për çështjet e lirisë. Në mes lirikës dhe të rrëfimit për luftën, poeti ka arritur t'i shmanget ndjesisë së tij fëmijërore. Në jetën e çdo njeriu ka një vend të rëndësishëm dhe që nuk mund të harrohet kurrë, fëmijëria që poeti e shfaq në vjersha dhe poema për luftën. Duken të zakonshme qiejt me avionët e luftës, deti me anijet e ushtrive të huaja, shtetrrethimi në rrugicat e qytetit, helmetat nazifashiste, fytyrat e mërzitshme të ushtarëve dhe oficerëve pushtues dhe konvencione të tjera të kësaj lufte, në kujtesën fëmijërore të poetit thuhet "kështu e kam parë unë luftën". Ai merr përsipër rolin e një të vërtete të madhe, të një dëshmitari, i cili kërkon domosdo të tregojë dëshminë e tij. Fatos Arapi në kohën e luftës ishte 13 vjeç kur filloi Lufta e Dytë Botërore. Në këtë moshë fëmijërore, njeriu ka formuar pjesën më të madhe të personalitetit të tij, prandaj ai u rreshtua dhe në radhët ushtrisë antifashiste. Këto dëshmi interesante gjenden herë pas here në poezinë e Arapit. Pavarësisht trajtimit në poezi, poeti e ka shfrytëzuar historinë në përmbajtjen që ai u ka veshur rastet, figurat, kohën, mendimet, të cilën e quan dhe një "mesjetë të pavarrosur". Ushqimi që kishte çdo luftëtar dhe shqiptar nga e kaluara, nga legjendat, nga baladat dhe nga këngët e luftës. (dita)



Qasje

“MOJ E BUKURA MORE”, KËNGË RITUAL APO KËNGË ATDHETARE

Moreja nuk është një emërtim zëvendësues për Arbërinë, metonimi e saj, pavarësisht se Moreja ishte land i arvanitëve qysh në shekullin XIII. Kjo këngë nuk ka lidhje me ndonjë vetëdije atdhetare për vendlindjen e humbur, por me kultin e varreve të të parëve



Nga akad. Shaban SINANI

Për këngën “Moj e bukura More” poetët dhe studiuesit arbëreshë kanë shkruar e dhënë mendime origjinale përgjatë dy shekujve. Ajo është kthyer në shenjë identiteti e mbijetese të arbëreshëve. Kjo këngë, siç na ka dëshmuar Matteo Mandalà, gjendej e kopjuar edhe në Chodice Chiutino (1708), ndërsa D. Camarda e botoi në librin *Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua Albanese*. Megjithëse me vetëm shtatë vargje, kjo këngë prej shumë dekadash deri sot gjendet midis dy leximeve: njëri atdhetar e tjetri ritual-fetar. De Rada, në shenimin për lexuesin italian të *Rapsodive* të tij, duke u pajtuar me mendimin e Vincenzo Dorsës, pohon se këtë këngë ... in Sicilia, gli albanesi di Palazzo Adriano, cantavanli sul loro monte detto “Delle Rose”; quelli del Mezzojuso sul monte sovrastante; quelli del Contessa e della Piana su i monti rispettivi, S. Maria del Bosco e

Pizzutta. In Calabria fanno parte de’ Canti di Russalle o feste patrie antiche, celebrate ne’ giorno di Pasqua. “Moj e bukura More” ishte një këngë që kishte të kremten e vet, që këndohej për të shoqëruar ritin e mbledhjes së trëndafilave në ditën e rosalia diem, për të nderuar varret e të parëve, të cilët nuk kishin një shenjë diku në viset arbëreshe, por në përfytyrim lidheshin me një vend që quhej More. Qysh prej Dorsës, deri te Candreva, “Moj e bukura More” është kënga që përkujton vendin dove sono sepolti il padre, la madre e il fratello. Për shekuj me radhë ajo ka shoqëruar ritin e përsëritjes në varret imagjinare të një prius parrenstë fisit, për të cilët dihej se ishin në More. Këtë çështje e ka sqaruar tashmë studiuesi Francesco Altimari. Për rolin që kanë pasur malet dhe lartësitë në botën arbëreshe në ritualin e rushajave, një e kremte tipike përsëritjeje, na dëshmon dhe vëllimi poetik i Francesco Crispi-t – Glaviano-s, me titull Mbi malin e

truntafilevet (Sul Monte delle Rose) botuar pas vdekjes. Moreja në këtë këngë kujtohet jo si ars patria i arbëreshëve, por si vendi ku duhej të përmbarohej riti i stolisjes së varreve të të moçmëve. Moreja me Arbërinë nuk janë në të njëjtat raporte si Itaka me Greqinë në poemat antike. Zhvendosja e sforcuar tematologjike prej rrafshit ritual tek ai atdhetar ka bërë që kjo këngë të humbë thujse gjithë strofën e dytë dhe në mënyrë të rregullt vargun e fundmë: Mori e bukura Morë çë t’lë, më se t’pë!
Atje kam u zonjën mëm,
atje kam u tim’ vellà,
atje kam u zôn tat
të mbuluar nën dhë.
O e bukura Morë
çë t’lë më së t’pë!
Disiplinimi i leximeve, një dukuri që preku për shumë kohë gjithë letërsinë shqipe, duke përfshirë dhe atë gojore, pati çuar deri në ndryshimin e tipologjisë së llojit e nën-llojit, jo vetëm në këtë rast. Kjo këngë

gjerësisht u trajtua si një këntik mirëfilli atdhetar. Një arsye mund të ketë qenë ateizmi, që nuk pajtohej me shumë rituale të jetës e të vdekjes. Por arsyeja kryesore ishte se në këto studime përmbajtja atdhetare ishte në krye të hierarkisë dhe ia kalonte çdo përmbajtjeje tjetër. Ky këntik i shkurtër arbëresh u çlirua lehtësisht prej vargut të fundmë: të mbuluar nën dhë, gjithë mbuluar ndenë dhë, që shpreh thelbin e saj, si këngë kujtimi për të parët e qëmoçëm, varret e cilëve kanë mbetur larg dhe vajzave arbëreshe nuk u mbetej gjë tjetër veçse lulet e mbledhura t’i mbanin në duardheritine vjetërta përmbushin vetëm në mënyrë simbolike. Moreja i ka shqetësuar studiuesit me një lloj vetëdije mbi atdhetare edhe për shkak të topos-it grek si kujtimi më i përveçëm i arbëreshëve, duke e kuptuar si një emërtim zëvendësues për Arbërinë, si metonimi e saj. Përpjekja për ta lexuar këtë këngë në mënyrë hiperatdhetare nuk ka kursyer edhe emërtimet e përveçme.

Në një botim të viteve 1980 në një tribunë dygjuhëshe shqip dhe anglisht që botohej në San Francisco të SHBA, Moreja u zëvendësua edhe gjuhësisht me Madhë, si një formë fonetike dhe shmangur prej Mamadhe, Mëmëdhe (në anglisht përkthehet Motherland). Në këtë variant Moreja nuk është atdhe i nënkuptuar, por atdheu vetë. Për të përjashtuar çdo interpretim, që mund të lejonte të kuptohej se teksti ishte i përshtatur, botuesi shenjon se prej gjyshes kishte dëgjuar se kënga ishte kënduar nga emigrantët shqiptarë të shekullit të fundmë, ndër të cilët ishte dhe Gjoni. Vitet e fundme janë bërë përpjekje për ta rindërtuar këngën "Moj e bukura More" si një trashëgimi gojore jo e arbëreshëve, por e arvanitëve dhe drejtpërsëdrejti si këngë patriotike që këndohet në nderim të Arbërisë, dheut të të parëve. Kjo poemë, e kthyer në këngë, nuk u përket krijimeve të poezisë gojore të arbëreshëve, por atyre të arvanitasve, thuhet në hyrjen e Antologjisë së poezisë arvanitase, ku ajo është përfshirë si poemë. Si çdo herë, kur në urdhrin e studiuesve të vërtetë hyjnë me zotësi vullnetarët e shkencës, jo vetëm teksti, jo vetëm gjeneza e tij, jo vetëm autorësia e kronologjia, por edhe çdo gjë tjetër, mund të ndryshohet. Kështu, në këtë parathënie, shënjohej se poema lindi në vitin 1534, kohë kur rreth 20.000 mijë arvanitas me në krye kapitenin Andrea Doria largohen nga Korona e Moresë në drejtim të Italisë së Jugut. Dhe pikër-

isht largimit të kësaj mase të madhe të popullsisë arvanitase nga trojet dhe shtëpitë e tyre u kushtohet poema "O e bukura More", që u kthye në himn për të gjithë popullin arbër:

Petkat e të mirat tona

Na i lamë te Korona

Krishtin na kemi me ne

Oj e bukura More

Thell të plas, me lot ndër si

Na të lipisnjëm, Arbëri!

Petkat e të mirat tona

Na i lam te Korona

Shën Mërinë kemi me ne

Oj e bukura More!

Thell të plas, me lot ndër si

Na të lipisnjëm, Arbëri!

Petkat e të mirat tona

Na i lamë te Korona

Papën na kemi me ne

Petkat e të mirat tona

Na i lamë te Korona

Papën na kemi me ne

Oj e bukura More!

Thellë të plast', me lot ndër si

Na të lipisnjëm, Arbëri!

Qeti: Shihni jet e re,

Na tha Dorja, zoti Ndre,

Lipim qellnjëm ka do vemi

Se buartim mallin e s'e kemi

Me këtë zemër, me këta si

Klajëm keq këtë Arbëri!

Malet tanë me lis e driza

Të bukur sheshe me muriza

Të bukur kroje, të bukur gropa

Oj e bukura More!

Thellë të plast', me lot ndër si

Na të lipisnjëm, Arbëri!

Qeti: Shihni jet e re,

Na tha Dorja, zoti Ndre,

Lipim qellnjëm ka do vemi

Se buartim mallin e s'e kemi

Me këtë zemër, me këta si

Klajëm keq këtë Arbëri!

Ndallandishe e lerë e lerë

Kur të vish ti njatër hjerë

Vjen të vish ti te Korona

Dherat të huaj hare s'kanë

Se s'mbëllin printët tanë

Prindë, luftuat me thik më dorë

Ndërpër shi e ndërpër bore

Ni ju lëm pa një qiri

E pa një vajim. Oj Arbëri!

Të bukur gjerdhe me fallopa!

Jemi e vemi ndë Itali

E më s'ju shomi me këta si!

Luajtëm valle nd'atë More

Shtumë kangjele ndë ato hje Klishtë

tona të bukura

Shpizit tona të nderuara!

Ni vjen turku, turku i zi

E tërpron klishë e shpi

E s'gjën më shpit' e tona!

Më së gjën trima hajdhjar'

Po ngë një qen, çë kloft i vrar!

Kur u nistin gjithë anitë

E dherat tanë iktin ka sitë

Burrat gjithë me një vajtim

Thirrtnin grat me një vajtim,

Dil e hana ti, Stihji!

Oj More! Oj Arbëri!

Nën trysni të tilla, kanë ndodhur ndryshime kategoriale, prej nderimit për të parët tek malli e dashuria për atdheun, prej lirikës rituale tek poezia atdhetare. Edhe në poezinë bashkëkohore arbëreshe "e bukura More" zhvendoset nga atje dhe dikur në këtu dhe sot: E bukura More e sprasme është këtu ku jam. Këtu kam û zotin tatë, këtu kam û zonjën mëmë Këtu kam edhe tim vëlla, gjithë mbuluar në këtë dhë. Moreja nuk është një emërtim zëvendësues për Arbërinë, metonimi e saj, pavarësisht se Moreja ishte land i arvanitëve qysh në shekullin XIII. Kjo këngë nuk ka lidhje me ndonjë vetëdije atdhetare për vendlindjen e humbur, por me kultin e varreve të të parëve. Dëshira e studiuesve për ta atdhetarizuar përtej kumtit të brendshëm, ka çuar jo vetëm në ndryshimin e përkatësisë tipologjike, nga këngë rituale përshpirtjeje në himn për Shqipërinë, por dhe e ka banalizuar thelbin e saj. (dielli)

Vështrim

KOLIQI, TREGIM-TARI DHE NOVELISTI MODERN

Koliqi tashmë është shkrimtar i rëndësishëm në historinë e letërsisë sonë, veçanërisht në historinë e prozës. Si prozator modern, Koliqi sjell në prozën shqipe të gjysmës së parë të shek. XX risi në formë, në tematikë dhe përmbajtje

Arben PRENDI

Ernest Koliqi është pranuar tashmë në studimet letrare të këtyre viteve si krijues i shumanshëm që u dallua, si poet, prozator e dramaturg, studiues i letërsisë së shkruar dhe asaj gojore, eseist, themelues revis-tash, përkthyes, hartues antologjish dhe për disa vite me radhë profesor në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe të Universitetit të Romës "La Sapienza", themelues i Institutit të Studimeve Shqiptare etj. Koliqi, siç shprehet studiuesi Anton Berisha është "personalitet i shumanshëm dhe shumëfish i rëndësishëm i kulturës sonë" apo siç cilëson shkrimtari Martin Camaj: "shtyllë e shkrimit shqip". Po ashtu përcak-

timi që Koliqi përdor për Fishtën si: "interpret i shpirtit shqiptar", mund të përdoret me të njëjtin qëllim për atë vetë, Koliqi është interpret i psikës së shqiptarit. Vepra e këtij krijuesi është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me botën shqiptare, ajo është pjesë e ndikimit jo vetëm artistik por edhe shoqëror, ndërsa ishte analizuuese, zhbriuese e vlerësuese e përhershme e saj. Vepra e Koliqit është pritur me interes në kohën e botimit të saj dhe tani. Në të gjitha studimet është nënvizuar shumanshmëria e veprës dhe roli i këtij autori në lëvrimin e tregimit dhe novelës shqiptare, si themelues dhe krijues i tregimit dhe novelës moderne shqipe. Në novelat dhe tregimet e tij "Hija

e maleve" (1929) dhe "Tregtar flamujsh" (1939), përmes rrëfimit artistik që është parësor për prozatorin, Koliqi zbërthen psikologjinë e shqiptarit të kohës, pengesave dhe vështirësive të tij për t'u përfshirë në rrjedhën e qytetërimit dhe përparimit shpirtëror e material; pengesave kulturore e psikologjike në radhë të parë, pastaj edhe të pengesave sociale dhe historike. Këtë e dëshmon edhe bota e pasur e personazheve të novelave, tipat dhe karakteret, përkatësia e tyre nga të gjitha shtresat dhe moshat e shoqërisë. Malësorë e qytetarë, fshatarë e intelektualë të shkolluar në universitetet perëndimore, tregtarë e rrufjanë politikë, mësues e meshtarë, materialistë e ideal-

istë, gra dhe burra, të rinj e të reja; një arkiv artistik i botës psikologjike të shqiptarit verior, të gjysmës së parë të shekullit XX. Përmes këtyre personazheve, Koliqi tenton të analizojë një tranzicion të rëndësishëm për shoqërinë shqiptare dhe mentalitetin e saj, shkëputjen nga shumë forma dhe rregulla të jetës tradicionale malësore apo tradicionale qytetare dhe përfshirjen në qytetërimin e ri modern me orientim europianoperëndimor, qytetërim me të cilin Shkodra i ka pasur lidhjet gjithnjë të afërta, qytetërim prej të cilit Shkodra është ushqyer me kulturë dhe modele. Dhe për Koliqin ashtu si për Konicën problemi është tek psikologjia e individit, i cili duhej të shkë-



putej nga rëndesa e modelit të jetës tradicionale, nga rëndesa e elementëve negativë të këtij modeli, për të përqafuar një model më bashkëkohor që ka në bazë kulturën e jetës dhe jo atë të vdekjes. Jo rastësisht personazhet konfliktohen për këtë arsye, pse kjo është çështje jetike, çështje zhvillimi dhe emancipimi; arsye e mjaftueshme që shqiptari të mbetet me sahat te koha e Kanunit të Lekë Dukagjinit, apo edhe më keq, te sahati i kohës së perandorisë turke. Në prozën e Koliqit, vihen re elemente të simbolizmit dhe psikanalizës, por këto elemente nuk janë thelbësore, dhe të qëllimshme. Ato më shumë duhen parë siç thotë studiuesi Anton N. Berisha, në një rrafsh më të gjerë, për arsye se botën e brendshme të individit, kontekstet e ngjeshura e të tendosura dhe shqiptimin e ndjesive shpirtërore, i ndeshim të trajtuara në mënyra të ndryshme edhe në krijime e letërsisë gojore në përgjithësi, apo në letërsinë gojore shqiptare, para se sa të lindte teoria e psikanalizës dhe freudizmi. Anton Berisha edhe disa shenja të simbolizmit në prozën 18 e këtij autori, i lidh me simbole të trashëgimisë sonë letrare ose mitologjike, që në prozën e Koliqit janë funksionalizuar në mënyra të ndryshme. Dilemat dhe pikëpyetjet psikologjike të shqiptarit, shkrimtari i vesh artistikisht me elemente mistike apo misterioze, në funksion të rrëfimit, që sigurisht ka parësor anën artistike, por edhe në funksion të shpjegimit të embrionit të neurozave psikologjike të personazheve. Sikurse Freud nënvizon rëndësinë e fëmijërisë në jetën njeriut, ashtu Koliqi artistikisht i drejtohet botës së hershme shqiptare; besëtytnive, riteve, miteve, përrallave, legjendave, figurave mitologjike, rregullave kanunore që bënë jetë të gjallë,

në popull për shekuj; si "fëmini" e psikes së personazheve. Personazhet nuk mund të interpretohen as nuk mund të kuptohen pa këtë shtresë të personalitetit të tyre, që megjithëse nuk është në vetëdije sepse kohët kanë ndryshuar, gjendet ende në pavetëdije, në formë primitive. Elementet nga bota parake shqiptare në aspektin psikologjik, marrin funksione simbolike. Ngjyrimin në jetën e gjallë në popull i shtohet edhe një ngjyrim simbolik, me natyrë artistike dhe psikologjike që shndërrohet edhe në një kod për zbërthimin e neurozës emocionale, psikologjike të personazheve. Shkrimtari bashkon kështu një projektim tredimensional, të botës së personazhit, ku dimensionin i parë është ai primitiv, në pavetëdije, dimensionin i dytë ai i përjetimeve dhe ndijimeve, mendimeve të momentit dhe dimensionin i tretë një përzierje e tyre, që prodhon një kaos shpirtëror dhe psikologjik prej të cilit pasojnë neuroza me pasojë të rënda, por edhe veprime tragjike, siç ndodh me personazhin kryesor të novela "Gjaku". Konica të "Një ambasadë e zulluve në Paris" (1924), ashpërsisht i stigmatizonte bashkatdhetarët e vet si një turmë zullujsh, që nuk ishin në gjendje të bëhen komb, kurse Koliqi të njëjtën kërkesë e shtron në novelën "Gjaku" në mënyrë më të rafinuar: "A ka send ma të mrekullueshëm në këtë botë se me i sjellë qytetnimit një kombi zhytë në errsinën e padijes?" duke e parë çështjen e daljes nga errësira e traditës negative dhe e kapërcimit të modelit moral të traditës si një çështje parësore për njeriun dhe shoqërinë shqiptare. Personazhet që marrin përsipër një mision të tillë kalojnë përvoja dramatike dhe tragjike, që janë në fakt edhe përvojat dramatike dhe tragjike të intelektualit apo të riut shqiptar në realitet.

Ata duhet të kalojnë nëpër unazën e zjarrtë të konflikteve të shumëfishta: së pari me veten, instinktet e vjetra që nuk janë shtypur plotësisht nga kultura, së dyti me mjedisin, të afërmit, shoqërinë, së treti me institucionet morale apo institucionet inekzistente të shtetit të ri. Por për shkrimtarin, ndoshta konflikti i parë që duhet zgjidhur është ai psikologjik, brenda njeriut, ku flenë instinktet e vjetra të shtypura përkohësisht në pavetëdije, por që me t'u dhënë rasti dalin me agresivitet dhe në mënyrë të paparashikueshme në sipërfaqe, në vetëdije siç do të thoshte Freud. Mësuesin Doda të novela "Gjaku", pikërisht se i ka shtypur këto instinkte, rrezikon të shndërrohet i papranueshëm për mjedisin ku jeton. Përplasja në këtë novelë është kontrastuese dhe e lashtë: ajo mes dritës, (qytetërimi, kultura) dhe errësirës (padija, zakonet negative). Mësuesi Doda frymëzohet nga "drita", kultura e jetës, dija e marrë në universitet, mjedisi i tij nga "errësira", padija, instinkti, tradita negative, që çojnë në takim me vdekjen. Koliqi si personazhi i tij mendon se arsimi, kultura, janë një mjet i rëndësishëm për ta shkëputur shoqërinë shqiptare nga tradita negative, një mjet i rëndësishëm për të rritur brezin e ri me një botëkuptim tjetër. Vrasja e vëllait, e vendos heroinë në një pozicion të vështirë, të cilin as e mendonte ndonjëherë. Ky moment shërben edhe një herë, për një projektim tredimensional të personazhit. Aty zbulohet bota e tij shpirtërore, reale. Realiteti i plagos njerëzit idealistë atëherë kur nuk e presin dhe atyre u duhet ose të luftojnë deri në fund, ose të kapitullojnë. "Diçka zgjohej në shpirt të tij, diçka që deri atë ditë kishte fjetë në fundet e errëta të pandërgjegjes"- përshkruan trazimin psikologjik të personazhit, ndërsa

kujtimi i vëllait të vvarë e mundon. Ky përshkrim i qartë psikoanalitik më kujton një përcaktim të Freudit për natyrën psikologjike të njeriut: "Çdo jetë pra është e dyfishtë. Posh-të në pavetëdije ne ekzistojmë në 19 tërësinë tonë, ne jemi e Dikurshmjaja dhe e sotmja, njeriu primitiv dhe ai i qytetëruar, përzierje e turbullt ndjenjash, mbeturina arkaike të një Uni më të gjerë të lidhur me natyrën lart, në dritë të kthjellët e të fortë ne jemi vetëm Uni i vetëdijshëm që ekziston në kohë". Doda, i pushtuar nga këto përzierje ndjenjash kontraktore bëhet edhe personazh tragjik. Qëllimi i jetës së tij: qytetnimit i vendit të tij, mbetet një projekt i ndërprerë, ndaj të cilit ai është edhe i gatshëm të flijohet, siç edhe flijohet në fund të novelës, duke u dorëzuar vetë në xhandarmëri pasi vret gjaksin e tij, me qëllim që shteti të nisë të funksionojë, kjo në fakt e dallon nga një gjakmarrës i zakonshëm. Doda nuk është një gjakmarrës i rëndomtë, por beteja që zhvillohet në të përfundon në favor të zakonit, kundër qytetnimit dhe vetë ideve të Dodës, që thotë se "gjaksor janë të gjithë ata që derdhin gjak njeriu". Te Koliqi, nuk mungon kritika e ashpër për të metat e përparimit shpirtëror dhe atdhetar të shqiptarit, në mënyrë të dallueshme në novelat "Gjaku" dhe "Tregtar flamujsh". Te "Tregtar flamujsh", Koliqi me personazhin e tij të preferuar: të riun ëndërrimtar e idealist që kthehet nga studimet jashtë shtetit me ndjenjën e mallit për atdheun dhe përgjegjësinë për t'i shërbyer familjes por edhe atdheut; (kujtojmë këtu "Studentin në shtëpi" të Migjenit) e qesëndisë pa kompromis mentalitetin anadolak, të tregtarit të vogël që s'le asgjë pa shitur vetëm e vetëm që të pasurohet sadopak, shet edhe flamuj kombëtarë... Flamuj të cilët nuk po

i shiteshin, dhe për këtë fajëson poetin e ri, mësuesin që nuk u ngjallë njerëzvendjenjateduhuraatdhetare. Sa më shumë ndjenja atdhetare aq më shumë flamuj të shitur, aq më shumë fitime për tregtarin e vogël, që mbetet në këtë mënyrë edhe më i vogël dhe më i cekët. Ky tregtaruc, siç thuhet në Shkodër, me këtë tregim hyn në ligjërimin artistik dhe publicistik shqiptar si simbol i gjithë asaj kategorie njerëzish, që për interesa personale janë gati të shesin gjithçka, qytetin e tyre, atdheun, gjuhën, flamurin... çdo gjë që mund të blihet. Ndërkaq disa tregime elementin mistik apo mitologjik e kanë pikërisht si element simbolik që zbërthen kodin e gjendjes shpirtërore - psikologjike të personazheve. Të tilla mund të jenë, "Nusja e mrekullueshme", "Kur orët lajmojnë", "Zana e fundme". Veçanërisht "Nusja e mrekullueshme" është një tregim lirik në të cilin elementi mitologjik fsheh neurozën e "dashurisë së pamundur" të malësorit shqiptar, ose të dashurisë si "sekret" mistik. Koliqi tashmë është shkrimtar i rëndësishëm në historinë e letërsisë sonë, veçanërisht në historinë e prozës. Si prozator modern, Koliqi sjell në prozën shqipe të gjysmës së parë të shek. XX risi në formë, në tematikë dhe përmbajtje. Strukturën e tregimit, novelës, e përsosi nga pikëpamja kompozicionale, si as-

jëherë më parë në prozën shqipe, duke u mbështetur së pari në përvojën e prozës shqiptare dhe europiane, veçanërisht asaj italiane dhe së dyti në modelin e rrëfimit gojor shqiptar. Ndërsa nga ana tematike ai e pasuroi prozën e këtyre viteve me një larmi temash, që nga tema intime e deri te tema sociale. Në përmbajtje analizohet bota e brendshme plot dilema dhe kundërshti e njeriut shqiptar dhe njëkohësisht bota morale, psikologjike e shoqërisë shqiptare. Zbulesa psikologjike e qenies njerëzore është ndër përmbajtjet më domethënëse. Për ta realizuar këtë përmbajtje autori i drejtohet shpesh analizës psikologjike të "dhomës së errët" (Niçe) të qenies njerëzore. Analizës psikologjike të marrëdhënies së njeriut përmes kësaj "dhome të errët" me realitetin, grupin social, hapësirën dhe kohën në të cilën ekziston. Në tregimet dhe novelat e dy vëllimeve "Hija e maleve" dhe "Tregtar flamujsh", Koliqi i kushton rëndësi të veçantë portretizimit bindës të personazheve, si personazhe të botës shqiptare, dhe si personazhe, qenie njerëzore. Ky portretizim është shpeshedhetnikabazëe analizës së botës së brendshme të njeriut. Shpesh edhe domethëniet artistike e kuptimore janë të lidhura me mënyrën e ndërtimit të portretit të personazheve.

Në plazmimin e këtyre portreteve autori ndërthur elemente sa të formës aq edhe të përmbajtjes, ku elementi përmbajtësor është dominant për të krijuar karakterin e dallueshëm të personazheve njëri nga tjetri. Si personazhe të botës shqiptare, personazhet e Koliqit bartin 20 gjithë ngarkesën emocionale, psikologjike, të shqiptarit i cili gjendet në kapërcyell të dy epokave, epokës tradicionale të dominuar nga tradita zakonore dhe epokës moderne të dominuar nga kërkesa për një model të ri jete, kryesisht ndikim nga kultura e shkruar, nga shkollimi brenda vendit apo nga modeli i jetës perëndimore, kryesisht ndikim nga shkollimi në universitetet europiane. Ndërsa si personazhe - qenie njerëzore, ato përshkohen nga trajta të vuajtjes dhe dhimbjes, të dhëna në formën e trishtimit, melankolisë për fatin e qenies njerëzore, për ikjen e moshës rinore, mosrealizimin e ëndrrave ose të ndjenjave, deri në formën e pikëllimit për vetë absurdin e jetës apo të vdekjes së qenies njerëzore. Këto personazhe përshkohen nga vuajtja ekzistenciale e qenies. Përmes saj na zbulohet një botë shpirtërore shumë komplekse e personazheve, gjë e cila, mendoj, i afron ata edhe tani me botën e lexuesit. Shumë prej personazheve që përshkohen prej kësaj

vuajtjeje dramatike në mënyrën e vet, janë personazhe idealistë që e pësojnë në konflikt me realitetin dhe të përditshmen. Çka përbën një element tjetër modern në prozën e Koliqit, dhe në prozën shqiptare. Prozat e Koliqit shquhen për shprehjen lakonike dhe strukturën e ngjeshur, aq sa mjaft prej tyre përmbajnë elementë që mund të shtjellohen edhe më tej, në lloje të tjera të prozës. Autori përdor emërtimin "novela" për këto proza, por një pjesë e mirë e tyre për shkak të përfundimit të shpejtë të veprimit dhe mungesës së shtjellimit më në gjerësi të episodeve, mbeten në kufijtë e tregimeve. Në modelin e rrëfimit, Koliqi, gërsheton rrëfimin si rrëfim i shkruar me rrëfim si rrëfim gojor, ndaj shpesh mjete të rëndësishme të komunikimit artistik janë përshkrimet e shkurtra, dialogjet, monologjet e ngjeshura. Në themel të prozave qëndron pothuaj gjithnjë një fabul interesante, e cila fillon dhe mbaron shpejt, me një zhvillim klasik të veprimit, shpesh duke ndjekur rrjedhën logjike dhe kronologjike të tij. Sa i përket shprehjes artistike mund të themi se proza e Koliqit përshkohet nga lirizmi dhe nga ngjyrimi poetik i shprehjes artistike, cilësi këto të tekstit të prozës moderne. (Gegnia)

Pikëpamje

GJUHA SHQIPE, NJË TRASHHËGIMI E VYER QË DUHET MBROJTUR

Gjuha shqipe është tipari i vetëm që i lidh e i bashkon si komb shqiptarët dhe i dallon ata nga kombet e tjera; ajo është një trashëgimi e vyer që na kanë lënë të parët

Rami MEMUSHAJ

Shqetësimi për gjuhën shqipe është poaqivjetërsadhe historia e shkrim-it të saj. Gjon Buzuku iu vu punës për hartimin e "Mesharit", sepse "gjuha jonë nukë kish gja të ndigluom n së Shkruomit shenjtë, n së dashunit së botës së sanë", si një përpjekje për ta mbrojtur, ndërkohë që trysnia e gjuhës turke mbi të po vinte duke u shtuar. Gati një shekull më vonë, Frang Bardhi, duke parë rrezikun që i kanosej shqipes nga kjo trysni e gjuhës së pushtuesit, mori penën t'i hidhte në fjalor fjalët shqipes, siç

thotë ai "me nimuem mbë nja anë giuhënë tanë, gji po bdaretë e po bastardhohetë sa më parë të ve" (që po humbet e po priset me të kaluar të kohës). Me këtë shqetësim De Rada, Naimi dhe gjithë plejada e veprimtarëve të Rilindjes punuan me mish e me shpirt për ta lëvruar shqipen e për ta spastruar nga turqizmat e shumë të kishin depërtuar në leksikun e saj. Në ditët tona shqipja është ngritur në shkallën gjuhës standarde, që është shkallë më e lartë e zhvillimit të një gjuhe. Ajo sot është gjuhë zyrtare e tri shteteve, duke shërbyer në të gjitha

funksionet e një gjuhe standarde: si gjuhë e administratës, e shkollës, e shtypit, e shkencës dhe e letërsisë. Megjithatë, edhe sot, në epokën e globalizimit, kur Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut janë vende të hapura dhe kontaktet e shqiptarëve me botën janë të shumëfish-ta e të përditshme, rreziku i "bastardimit" të shqipes për të cilin fliste Frang Bardhi para katërqind vjetësh është i madh. Bastardimin e shqipes e ndihmon jo vetëm ndikimi i gjuhëve të kulturave të mëdha, sidomos i anglishtes, mbi shqipen, po edhe mungesa e plotë e kujdes-


it të shtetit dhe e institucioneve shkencore që merren me studimin e gjuhës. Ky ndikim shfaqet sidomos në fushën e fjalorit, ku, si rrjedhim i nevojave që ka sjellë zhvillimi i vrullshëm i disa degëve të shkencës dhe teknikës, po edhe i publicistikës etj., në shqipe kanë vërshuar qindra e qindra fjalë të huaja të reja. Ndër to ka fjalë që janë të nevojshme për shkak se i mungojnë gjuhës sonë, si termat e fushës së informatikës, por edhe ka edhe shumë fjalë të panevojshme, pasi për konceptet e dukuritë që emërtojnë këto huazime, shqipja ka fjalët e veta.

Të përdorur në të folur e të shkruar, këta barbarizma i humbin ligjërim-it bukurinë dhe forcën shprehëse që i jep fjala shqipe, e bëjnë gjuhën "të drunjtë". Vërsimi i fjalëve të huaja sjell me vete pasoja jo vetëm për leksikun, po edhe për rrafshet e tjera të gjuhës. Fjalët e huaja që vijnë në shqipe nëpërmjet të folurit bartin me vete edhe mënyrën e theksimit karakteristik për gjuhën nga merret fjala. Si rrjedhim, ka marrë të përhapur shqiptimi edhe i fjalëve të shqipes me theks në rrokjet e para, si në anglishte, dhe jo me theks në rrokjen e fundit, siç është në natyrën e gjuhës sonë. Kështu, dëgjojmë përditë të thuhet kóvid dhe jo kovíd, stamátin (një bar) dhe jo stamatín, féjsbuk në vend të fejsbúk, vódafon në vend të vodafó etj. Sa shumë ka depërtuar kjo mënyrë theksimi e fjalëve, duket sidomos në shqiptimin nga

brezi i ri i të shkolluarve i emrave dhe i emërtimeve të përveçme. P.sh., dëgjojmë shpesh të shqiptohen me theks në rrokjen e parë edhe emra të përveçëm të traditës, si Ántoneta dhe jo Antonéta, Bójken dhe jo Bójkén, Hásan dhe jo Hasán, Rámi dhe jo Ramí, Téki dhe jo Teki etj. Por fjala e huaj bart me vete jo vetëm theksin, por edhe morfologjinë dhe sintaksën e gjuhës nga është marrë. Kështu, shqiptimi i emrave në rrokjen e parë e bën të vështirë edhe lakimin e tyre, pasi shtohet numri i rrokjeve që vijnë pas theksit, ndërkohë që shqipja e ka të kufizuar këtë numër. Mirëpo përdorimi i emrave të huaj, të përveçëm e të përgjithshëm, pa format përkatëse rasore të shqipes prek sistemin e gjuhës sonë, e cila shekuj me radhë u ka bërë ballë trysnisë së gjuhëve të huaja me strukturë tjetër gramatikore. Dhe, nëse do t'i hapet

rruga theksimit në rrokjen e parë dhe përdorimit të emrave pa mbare-sa si në gjuhët që nuk e lakojnë emrin, ne do t'i sakrifikonim dy hallka të rëndësishme të sistemit gramatikor të shqipes. Ashtu si të gjitha gjuhët e kombeve të vogla, gjuha jonë do të ketë nevojë edhe në të ardhmen të huazojë nga gjuhët e kulturave të mëdha. Ajo do të mbetet një gjuhë e hapur ndaj këtyre gjuhëve e kulturave, por kjo nuk do të thotë se duhet të heqim dorë nga përpjekjet për të ruajtur identitetin e saj, për të ruajtur atë që e bën shqipen të veçantë në mesin e gjuhëve europiane. Mbrojtja e gjuhës nga bastardimi është detyrë e shoqërisë shqiptare, e shtetit, e institucioneve që merren me gjuhën, i shkollës, por edhe i konsumatorëve të mëdhenj të gjuhë - televizionit dhe shtypit. Është e pafalshme që gjuha jonë vijon të mbetet ende e pambro-

jtur me ligj të posaçëm; që sot kanë humbur si profesion korrektorët (lektorë) e redaktorët letrarë dhe që vetë akademitë e shkencave botojnë libra të pakorrekta e ta paretaktuar; që institutet e gjuhësisë dhe akademitë e shkencave nuk ndjekin zhvillimin e gjuhës dhe nuk botojnë periodikisht lista të fjalëve të reja që këshillohen të përdoren dhe të huazimeve të panevojshme që nuk këshillohen të përdoren; që shkolla (veçanërisht në Kosovë e në Maqedoninë e Veriut) nuk është vendi ku duhet të kumbojë ligjërimi i folur standard. Gjuha shqipe është tipari i vetëm që i lidh e i bashkon si komb shqiptarët dhe i dallon ata nga kombet e tjera; ajo është një trashëgimi e vyer që na kanë lënë të parët, e cila duhet mbrojtur e mbrothësuar. (g.sh)



Tregim

RRËZIMI I MONUMENTIT

Ridvan DIBRA

Monumenti duhet rrëzuar. Për një mijë e një arsye. Po ju kujtoj vetëm dhjetë prej tyre, të cilat, gjithësi, mund të mos jenë kryesoret: 1. Është i madh, tepër i madh, dhe si i tillë lëshon gjithandej një hije të rëndë e të zezë, e cila (sidomos në pranverë, kur njerëzit janë të dëshiruar për diell) bëhet fort e padëshirueshme. 2. Është ngritur në qendër të Egobokës, krejt në qendër, dhe si i tillë tërheq vëmendjen e të gjithëve, vëmendje që (sidomos muzgjeve, kur dielli mërgohet) mund të përqendrohet edhe te

monumentet e tjerë. 3. Është i vjetër, tepër i vjetër, dhe si i tillë kuturbon gjithandej një duhmë të rëndë, e cila (sidomos në të zbardhur, kur njerëzit janë të vëmendshëm ndaj aromave të reja) bëhet fort e neveritshme. 4. Është themeldobët, tepër themeldobët, dhe si i tillë priret sa djathtas majtas, prirje që (sidomos në ditë të paqëndrueshme, kur fryjnë stuhi të forta) bëhet fort e rrezikshme. 5. Është punuar pa shije, tepër pa shije, dhe si i tillë pjell gjithandej kopje të tijat, të cilat (sidomos tashti, kur skulptorët janë të lirë të gdhendin ç'të duan) mund të mos ishin kaq të ngjashme me

originalin. 6. Është ngritur nxitimthi, tepër nxitimthi, dhe si i tillë krijon iluzionin se gjërat e mëdha mund të sajohen shpejt, iluzion që (sidomos natën, kur ëndrrat kanë pushtetin) bëhet fort joshës. 7. Është sajuar prej një materiali të dyshimtë, tepër të dyshimtë, dhe si i tillë ngjall debate për origjinën, origjinë që (sidomos darkave, kur njerëzit janë të ngeshëm) bëhet fort e diskutueshme. 8. Është zgavruar e ngrënë, tepër është zgavruar, dhe si i tillë po bëhet çerdhe për lloj-lloj shpendësh, të cilët (sidomos në periudhat e shumimit, kur vërsijnë mizëri) glacojnë gjithandej. 9. Është

ndryshkur e shfytyruar, tepër është ndryshkur, dhe si i tillë ka humbur shkëlqimin fillestar, shkëlqim që (sidomos tashti, kur mbijnë gjithandej monumente të rinj) kujtohet fort rrallë. 10. Është rrjepur nga përkëdheljet e shikimet, tepër është rrjepur, dhe si i tillë ka humbur linjat e hershme, linja që (sidomos dikur, kur ishin të rrallë monumentet) lakmoheshin fort shpesh. ***

Monumenti duhet lënë në këmbë. Për një mijë e një arsye. Po ju kujtoj vetëm dhjetë prej tyre, të cilat, gjithësi, mund të mos jenë kryesoret:



1. Është i madh, tepër i madh, dhe si i tillë lëshon gjithandej një hije të plotë e të dendur, e cila (sidomos në verë, kurdiellidjegezshuripamëshirshëm) bëhet fort e dëshirueshme. 2. Është ngritur në qendër të Egobokës, krejt në qendër, dhe si i tillë tërheq vëmendjen e të gjithëve, vëmendje që (sidomos muzgjeve, kur dielli mërgohet) mund të shpërqendrohet te monumentet e tjerë. 3. Është i vjetër, tepër i vjetër, dhe si i tillë përhap gjithandej një aromë të fisme, e cila (sidomos në të zbardhur, kur njerëzit janë të vëmendshëm ndaj erërave të reja) bëhet fort e këndshme. 4. Është themeldobët, tepër themeldobët, dhe si i tillë priret sa djathtas majtas, prire që (sidomos në ditë të paqëndrueshme, kur fryjnë stuhi

të forta) bëhet fort mbresëlënëse. 5. Është punuar pa shije, tepër pa shije, dhe si i tillë stimulon gjithandej ngritjen e monumenteve të tjerë, të cilët (sidomos tashti, kur skulptorët janë të lirë të gdhendin ç'të duan) mund të ishin krejt të ngjashëm me origjinalin. 6. Është ngritur nxitimthi, tepër nxitimthi, dhe si i tillë dëshmon se gjërat e mëdha mund të sajohen shpejt, dëshmi që (sidomos natën, kur ëndrrat kanë pushtetin) bëhet fort joshëse. 7. Është sajuar prej një materiali të dyshimtë, tepër të dyshimtë, dhe si i tillë ngjall debate për origjinën, origjinë që (sidomos darkave, kur njerëzit janë të ngeshëm) bëhet fort enigmatike. 8. Është zgavruar e ngrënë, tepër është zgavrruar, dhe si i tillë po bëhet çerdhe për lloj - lloj

shpendësh, të cilët (sidomos në periudhat e shumimit, kur vërshojnë mizëri) cicërojnë gjithandej. 9. Është ndryshkur e shfytyruar, tepër është ndryshkur, dhe si i tillë ka humbur shkëlqimin fillestar, shkëlqim që (sidomos tashti, kur mbijnë gjithandej monumente të rinj) kujtohet fort shpesh. 10. Është rrjepur nga përkëdheljet e shikimet, tepër është rrjepur, dhe si i tillë ka humbur linjat e hershme, linja që (sidomos dikur, kur ishin të rrallë monumentet) përbuzeshin fort shpesh.

...Sidoqoftë, ata të tre, edhe pse të varfër e të papërvojë në realizimin e ndërmarrjeve të tilla, u betuan

për rrëzimin e monumentit. Dy të parët, më të rinjtë e më entuziastët, morën përsipër detyrën më të rëndë e më të vështirë: përgatitjen e lakut dhe vendosjen e tij në qafën e monumentit. Kurse të tretit, më plakut e më pak entuziastit, iu la një detyrë disi urithore: gërmimi përreth e dobësimi i themeleve. Rrëzimin përfundimtar, mandej, mund ta bënin fare lehtë edhe fëmijët. Në të ardhmen, pas shumë e shumë kohësh, kur ata të tre të jenë kalbur nën dhë dhe kur Egoboka të ketë nevojë për një monument të ri në qendër të saj, do të shpërthejnë debate të ashpra rreth faktit se kush e meriton atë: dy të rinjtë entuziastë, apo urithi?

(mars - prill 2003)

Tregim

ZAKONE PAR-AMARTESORE

Hasinta ESKUDOS

Midis Klaudios dhe së dashurës së tij ka një lidhje, e cila, gjatë dy muajve, përgjithësisht, po rrjedh kafeneve, kinemave, parqeve dhe hoteleve familjare. Pra, një dashuri rruge, siç e mendon ai vetë. Por koha kalon dhe Klaudios i

lind dëshira që ta çojë vajzën në shtëpinë e tij, sepse dashuria ka faqe të ndryshme dhe një nga ato është: ta ballafaqosh të dashurën me rrethin familjar, pra, ta shpiesh qenien e dashur midis mureve të jetës së përditshme. Nganjëherë shock-u i kontrastit është aq i fortë sa dashuria prishet.

Kështu që Klaudio do ta dijë nëse kjo lidhje do të jetë e gjatë dhe serioze, prandaj, duhet ta çojë në shtëpi. Duhet parë se si duket e dashura aty midis mobilieve, nëpër dhomat e shtëpisë. Duhet ta prezantojë atë me të ëmën, një plakë e imët, e zvogëluar nga osteoporosis, e rrëgjuar dhe tejet e rrud-

hur, gjithmonë e veshur me të zeza, e cila duket sikur nuk kupton çfarë ndodh rreth saj. Se si mundet që një qenie njerëzore të arrijë në atë gjendje aq të thyeshme, në të cilën gjendet e ëma, Klaudio nuk e di. Prandaj, përditë i lutet ndonjë Zoti të padukshëm, tek i cili beson, që të

mos i ndodhë kurrë e njëjta gjë. Më përpara të vdes, mendon ai, se të katandiset ashtu: një kukull qesharake, veshur me të zeza dhe e mbetur në mëshirë të të tjerëve. Pra, Klaudio vendos ta ftojë të dashurën në shtëpi që ta njohë e ëma. Vajza, duke menduar se gjërat janë serioze dhe po shkojnë për së mbari, u gëzua shumë. Ndërsa po përgatitet për këtë njohje familjare, ajo e lë imagjinatën të fluturojë, duke e parë veten të martuar me Kludion, i cili kurrë nuk ia kishte zënë në gojë martesën. Ai as për të ëmën nuk i kishte folur ndonjëherë, kështu ajo e përfytyron nënën e Klaudios një grua trupgjatë dhe të bukur, me fytyrë të ngjashme si e tij. Imagjination se do ta presë gjithë buzëqeshje dhe se do bëhen mikeshë me njëra-tjetrën. Për këtë është e sigurt. Kështu, Klaudio e merr të dashurën dhe e çon te rruga ku ai jeton, pastaj fut çelësin te porta 312. Korridori i brendshëm është pak i errët dhe duhet ndezur një dritë. Vajza shikon se shtëpia është e vogël dhe e ngushtë. Kur Klaudio i thërret së ëmës, vajza dëgjon murmuritjen e një gruaje, e cila përgjigjet nga thellësia e një dhomë në të majtë të saj. Është salloni dhe aty është plaka. Vajza zhgënjehet disi, për të mos thënë zhgënjehet shumë. E zë frika se do të kalojë një mbrëmje të mërzitshme dhe se nuk do të mundet të bisedojë lirshëm me të dashurin, por, gjithsesi, mundohet të sillet sa më këndshëm. Duke qenë se plaka nuk mund të gatuj, Klaudio blen ushqim të gatshëm dhe i vendos nëpër pjata. Vajza e ndihmon dhe, pothuaj në

heshtje, ulen të tre për të ngrënë. Plaka kërkon që të ndezin radion. - Sonte kemi festë, - thotë ajo. - Jo çdo herë darkoj me një vajzë kaq të bukur, siç jeni ju. Vajza qesh. Mendon se plaka durohet dhe se mund të bashkëjtohet me të, po të qe se do të jetonin të tre bashkë. Pas darkës, të tre rehatohen në divanin e sallonit dhe shikojnë televizor. Klaudio, i ulur midis dy grave, e kap vajzën për dore. Ajo pret që, në ndonjë çast, ai t'i thotë të dalin, apo t'i bëjë shenjë të përshëndetet me të ëmën, për t'i thënë se po ikin. Gjithsesi, edhe pse ai e çoi në shtëpi, duhet të rrinë pak kohë vetëm, të paktën, t'i japin njëri-tjetrit ca puthje. Pororëtkalojnë dhe Klaudio nuk thotë asgjë. Kështu, ajo bëhet ca e paduruar, por nuk do të jetë e pasjellshme dhe të iki e zemëruar. Ajo, kurrësi, nuk do të prishet me të dashurin, të cilin po vëren tek rri gjithë qejf në divan, duke parë televizor, atje, midis së ëmës dhe së dashurës. Në orën 11, plaka thotë se ka ardhur ora për të fjetur. Pasi ngrihen të tre, vajza mendon se, më në fund, do të mbetet vetëm me të dashurin. Por, ndërsa plaka shkon drejt dhomës së gjumit, Klaudio e kap të dashurën për dore dhe shkon pas së ëmës. Vajza mendon se duhet ndihmuar plaka për ta mbuluar apo diçka të tillë dhe, qetësisht, e shoqëron. Plaka ulet në shtrat, heq këpucët dhe shtrihet mbi çarçafë, ashtu e veshur, siç ishte. Ndërkohë, i shpjegon vajzës: - Klaudio e ka zakon që të shtrihet këtu me mua, derisa të më zërë gjumi. Ma merr mendja se nuk do të mërziteni që të na shoqëroni.

Vajza, e habitur, shikon nga Klaudio, i cili fillon të heq këpucët. - Jepi, hiqi këpucët, nuk do të zgjasë shumë, - i thotë ai, duke buzëqeshur. Ajo, disi e turbulluar, i bindet. Ndërsa Klaudio shtrihet, ashtu, midis grave. Në të djathtë ka të ëmën dhe në të majtë të dashurën. I kap dorën së ëmës, po ashtu edhe së dashurës dhe i vë mbi gjoksin e vet. Që të tre janë shtrirë praptas. Plaka i thotë Klaudios që t'i tregojë diçka, çfarëdo qoftë, që zëri i tij ta bëjë të kotet dhe ta zërë gjumi. Vajza e çuditur dhe e mërzitur plotësisht, bëhet pishman dhe thotë me vete: Jo, nuk mund të kalojë kështu jeta bashkëshortore. Befas Klaudio kthehet nga ajo dhe i pëshpërit: - E zuri gjumi. - Epo, atëherë ikim. Por ai buzëqesh dhe i mërmërit te veshi: - Eja, do të bëjmë dashuri këtu. - Ku?! - Këtu, në këtë shtrat. Mamaja po fle, nuk shikon gjë. - U çmende?! Por, ndërsa flasin, ai e prek, e puth, e kafshon dhe kundërshtimi i vajzës duket se po përzihet me dëshirën, me turpin, me epshin dhe me mizorinë e pranisë së plakës në gjumë të thellë, veshur me të zeza, si një kufomë. Më në fund, mashkulli arrin t'i penetrojë vajzës gjysmë të zhveshur. Pastaj dashuria vazhdon me më shumë pasion, sesa të qenëshin plotësisht vetëm. Për momentin, vajza shqetësohet se lëvizjet dhe rënkimet e të dyve mund të zgjonin plakën, por sa herë që i hedh sytë anej, shikon se ajo fle pa lëvizur fare.

Pastaj edhe të dashuruarit fletë. Kështu i gjen mëngjesi i së nesërme të tre. Kur vajza zgjohet, plaka nuk ndodhet në shtrat, ndërsa Klaudio ende fle. Vajza do që ta zgjojë, por ai hungërin dhe kthehet në krahun tjetër. Atëherë, ajo ngrihet dhe shkon në kuzhinë, ku gjen plakën që po përgatit kafën. - Mirëmëngjesi, zonjë. - Mirëmëngjesi, goce. Si fjetët? - Mirë, shumë mirë. - E di. Të gjitha kështu thonë. Klaudio përherë sjell të dashurat e tij dhe pasi hamë darkë, të tre fletë në atë shtrat. Unë idëgjoj kurbëjnë dashuridhëndihem e ringjallur, sepse kujtoj e rijetoj ato kohë të largëta dhe të bukura. Pa shikomë, a nuk dukem e rinuar sot?

Marrë nga libri: Jacinta Escudos "Tregime të ndyra", 1997

(Në shqip: Bajram Karabollli)

Hasinta Eskudos (1961), shkrimtare salvadorenje. Veprat më të shquara letrare të saj janë: Poema (1984), "Tregime të ndyra" (1997), "Zhgënjimi", roman (2001), "Lumturi shtëpiake dhe gjëra të tjera të frikshme", tregime (2002), "A - B - Qefini", roman (2003) botuar nga Shtëpia Botuese Ndërkombëtare ALFAGUARA. Është e para shkrimtare salvadorenje që kjo shtëpi botuese prestigjioze i boton një roman. Me këtë roman Hasinta Eskudos fitoi çmimin "Mario Monteforte Toledo" (2003).



Poezi: Vlora Ademi

KRONIKË

24 mars '99, e mërkurë, Kosovë

Ora njizet

Sokëllimë

Kohë e nemitun

Katrahurë

Dymijë e dyqind e tetëdhjetë orë ankth.

Të tjerat shifra ndryshonin përditë.

Po përballeshin epokat n'sytë tanë.

N'pafuqinë e t'qenit njeri

Ah, sikur t'ishim zogj...

Zogj!? Çfarë zogjsh bre... N'cilin qiell me fluturue don?

Ah! Po sikur t'ishim bebe t'paleme n'bark!? Sa mirë. S'kishim

me kuptue, as gja s'kishim me pa, derisa t'kish mbarue...

Hmmm... Jo s'ban. Jo-jo, s'ban! Na gjejnë edhe aty.

1 maj '99, e shtunë, Prizren

M'i caktuen njizet e katër orë me i trusë qysh t'muj shtatëm-

bëdhjetë vjet jetë në një çantë.

Çka t'la?

Çka t'marr?

2 maj 99, e diel, Morinë

«Marš odavde!»

Ma degdisën rritën.

E askurrkundshme u bana.

Po e kapërceja veten dhe një brez toke njëherësh.

N'shpinë dy prilla t'thyem, fotografitë me shokë dhe një em-

blemë, dhuratë prej një moshatari.

Ai herët kish marrë malin me e matë trimninë me te, unë

timen e matja tue e kalue kufinin, me te t'mshfun n'xhep.

Paradoks.

'00-'22, Kosovë

Ajo erdh!

Erdh e përgjakun, e gjymtuemë, e me vrraga...

E kuqja nisi me u ba si unë.

Ndërroi ngjyrë.

E përqiellte e ngrystë u ba. Njajtë si do... që mbetën gjallë.

Të tjerët,

ata t'Marseve.

Ah! Ata t'pavdirët...

Namës së tyne po i druhem.

BOSHI I BIRIT

Përdita ime e mungueme,

dëshirë që ma prapton pritjen,

si n'pritjen e ngjizjes tande mbrenda meje dikur.

Ashtu po e mas kohën

me shikimin dikah

herë përtej, matanë,

e herë qiellit përjetë

Ka net kur, mbërthye n'këmishën tande gjithë gritha t'mal-

lit,

mundohem me ia krijue vetes do andrra,

me ë zhba një çast,

me zor me i hapë retë me bërryla

e mos me i lanë me na e zanë dritën n'pritë.

E t'mshefi...

herë mbas magjes,

herë mbas bunarit,

herë mbas shpinës s'nanës

mbrapa diellit ndojherë...

T'i qet nana një palë krahë shpinës e t'vërviz dikah

e mbarue kur ketë katrahura, kthehem

për dore t'kapi, në gji t'shtrëngo.

e ta shoh rritën, burrnimin ta shoh me sy përditë.

Zot!

Po qysh mujte aq gjakftohtë me e pa atë dramë?

Qysh mujte me ma shtrenjtue kaq shumë biletën e lirisë?

T'pati thurë nana çorapë prej leshi t'murrmë

mos me t'nirhtë kambët dimnit.

Tash, sa herë aviten dimnat, marrohem prej tyne.

Qenka dashtë që nana n'vend t'çorapëve me të pasë thurë një

tjetër nafakë

me lesh t'bardhë

për mu'

për ty.

Nanës, bir t'paça,

Nji shenjë veç, ma ço aman!

Se sot e atë ditë

veç frymës tande i lutem e i falem,

sot e atë ditë përditë agjinoj

për erën tande,

flokun,

fjalën,

lojën,

shtatin,

dorën tande.

Ah!

Veç ajo dorë mundet me m'i mshelë sytë

e me m'përcjellë në tjetrën anë.

UNË - AJO

I mblodha copat e trupit

nji kah nji qosheve t'ferrit

bashkë me pullat e këmishës,

tue pyetë veten qysh me i dalë dritës prap përpara.

U ula n'prag t'odës me e lidhë fatin nyje

e mallkova me loçkë t'shpirtit

nderin,

pragun,

uratat,

ditën e martë,

pritën n'ograjë

e pjellën e nanës

pse m'kishite ba.

Për herë t'parë u rashë n'dy gjuj zotave,

jo me iu lutë,

se lutjet nuk kishin kuptim ma.

Por i gjykova pse grue m'kishin ba.

(Kah duhet me ia nisë prap me jetue?)

Mbasi e gërreva me thoj,

ia pshteta ballin tokës

dhe m'dolën para tana çastet e lumtuna.

U ktheva, e preka lëkurën me dorë.

Ende ishte e njomë

Veç paskan tentue...

Veç paskan tentue me m'lanë pa shteg,

pa fron,

pa emën,

pa kunorë...

U çova!

Me flokët të thinjun mbrenda natës

e përpiva dhimbën me zor,

mbasi e pashë n'sy vrasjen time si t'padëshirueme.

Nji qilim t'ri ia shtrova vetes para

dhe peshën e arsyes e ngarkova mbi shpatulla

I shkunda gjurmët e trishtimit prej trupit

për nanën,

për çikën

për motrën

e njizet mijë të tjera si unë.

Dhe zgjodha me e marrë ma t'vështirën udhë;

zgjodha me rrnue.

ATË DITË M'U ÇOR DRITA E SYVE

E kam pa tek m'del hija e shpirtit prej trupi

e trishtueme

E kam pa t'harlisun tuj m'u largue me kryet mbajtë n'dy duer

Nuk pata as za, as forcë, as kohë me iu lutë.

Doja me i thanë: Rri!

Ku po shkon?

Rri me mue!

M'dil zot!

Atë ditë nuk pata as Zot.

I pari shpinën Ai ma ktheu.

Mandej baba mandej

tre vllaznit

burri mandej.

M'veçuen kolone

Ma prenë atë t'shkretë udhë.

Qyqe mbeta vetëm.

Asnjani nuk iu ba me m'rokë për krahu

Asnjani t'nesërmes zot nuk m'i duel.

Nuk e di a i kanë mshelë sy e vesh

gjak damarëve a u ka ecë

kur trupit tem shfryhej e psh kazermash

Atë ditë ua kam pa skajin t'kqijave

Atë ditë turrat e trupit i kam pa tuj m'fluturue me ia mshelë

sytë ditës

Atë ditë e kam pa sa i pamitër asht një burrë

Asnjani nuk e qiti hapin me m'i dalë para fatit

as burri,

as vllaznit,

as baba,

as Ai.

Nga ditari i Lasgush Poradecit

“UNË JAM NJË TIP I ÇUDITSHËM, JAM I LIRË”

Është gjithnjë befasi, pothuaj e pa-përfunduar, sa herë lexojmë diçka origjinale nga Lasgush Poradeci, qoftë poezi, apo ditarë – si dy letrat që ka publikuar pak kohë më parë, e bija e Lasgushit, Marija. Herë pas here ajo e mban gjallë lexuesin, e sidomos me këtë ushqim shpirtëror të epërm, pasionantët e gjuhës së lirë të poetit. Në këtë rast shkojnë dhe dy letrat që po botojmë, që mbajnë datën e hershme të viteve 1945 dhe 1972, të shkruar në dy kohë të rëndësishme. E para kur sapo ishte vendosur regjimi komunist, dhe në të dytën kur shqiptarët ndjenin një farë atmosfere lirie, por, në fakt, ishte instaluar përfundimisht regjimi diktatorial dhe tashmë ishin ekzekutuar intelektualë e shkrimtarë, politikanë e tregtarë dhe vendin po e qeverisnin hienat e komunizmit. Ashtu siç i ka sjellë Maria, i botojmë të plota këto dy letra si më poshtë:

Tiranë, e Mërkurë 24 Tetor 1945: Ora 11 isha në Ministri i Kulturës Sejfulla Malëshova, i shpura materialin e vëzhgimeve të mija mi Naim Frashërin për botim kritik të lirikës së Naimit. “Botim kritik” i thashë “s’mund të bëhet, dyke mos patur dorëshkrime të mjaftuarshme. Do të bëj vetëm një botim kriteri” i thashë, siç e kisha parashtruar dhe në raportin t’im përpara se të vete në Poradec. Pastaj në lidhje me vjershën që kish botuar jashtë më 1928 dhe e botoj dhe tashi mora fjalën dhe i thashë: “Do të ishte një çnderim për mua sikur t’ju nderonja se jeni ministër, po unë ju nderoj dhe ju pyes në cilësinë t’uaj si vjershëtor. Juve kini bërë një gabim në poezinë t’uaj që rishtyptë tashi kundërmeje, sepse gjërat që thoniatje kundër meje nuk i përgjigjen të vërtetës po përkundër. Kur është jashtë njeriu, mund të gabohet dhe ju ishit atëhere jashtë. Po tashi që gjindeni në Shqipëri dhe që jeni në gjëndje të kontrolloni jetën t’ime me shumë lehtësi, të afirmohet një mos-e vërtetë për mua, s’është liri po robëri. Sejfullaj: “aty (në poezi) unë nuk them si ishit, si jini, po si do bëheshit”, Unë: “Po juve në atë poezi thoni: “të blenë me para”, “të futnë në kuvli”, dhe në shënimin që i kini bërë vjershës simjet më 1945 thoni: “hyri në pellgun oportunist”, dhe “u bë poet dallkaut”, dhe shënoni vetë që vjersha është shkruar më 1928”. “Juve thoni ashtu, po mua s’më ka blerë kurrë njeri as me para as pa para, as jam futur në kuvli, as kam qënë as do jem

oportunist, as jam bërë as do bëhem dallkaut, po kam rrojtur dhe rroj si njeri i thjeshtë dhe i ndershëm vetëm me rrogën t’ime, si profesor që jam emëruar në bazë të diplomës s’ime. Unë as e njihja Zogun as s’e njoha kurrë ndonjë herë, as shkela ndonjë herë në Parlament, po rrojta gjithnjë i tërhequr, si kurdoherë sipas naturës s’ime; nuk shkrojta kurrë as për Zogun as për ndonjë tjetër siç bënin të tjerët si p.sh. A. A. që ish ministër dhe i bënte poezi Zogut, si F.V. që ish deputet dhe i bënte edhe ay Zogut poezi. Ato poezi quhen dallkaukllek, oportunizmë, kuvli, jo poezia ime që fluturon e pastër dhe e lirë përmbi dobitë dhe vogëlsirat njerëzore. Poezia për mua është lirija absolute e shpirtit dhe një poezi që futet në relativitetet e shoqërisë dhe të kohës, në dallkaukllek që d.m.th. politikë humbet karakterin e lirisë suverante të shpirtit – konditë sine qua non e artit të vërtetë. Unë nuk e lejoj veten që ta ve poezinë t’ime në shërbim të kontigjencave shoqërore, sepse unë jam një tip i çuditshëm, jam i lirë. Mua njeriu mund të më vjedhë 100, 200, 300 napolona, sikur t’i kisha, po karakterin t’im si njeri, si artist independent, s’m’a vjedh dot, s’m’a merr dot kurrë! S’m’a ble dot njeri kurrë!” Sejfullaj tha: “do flasim një herë tjetër më nge” dhe unë ika dhe hyri Gjeneral Kolonel Koçi Xoxe.

Lasgush

Tiranë, e Djelë 9 Janar 1972: U takova me 4 kosovarë 30-35 vjeçarë, intelektualë të ardhur prej Kosove për qëllime kulturele, pas 2 javë, më tha njëri, do shkojmë për në Kosovë. Nuk më njihnin personalisht, u entuziazmuar që më njohë, njëri poet më tha: “jeni i adhruar në tërë Kosovën, rinija entuziazmohet me juve, ju-a kemi botuar në Kosovë të 2 volumet e poezive”. Njëri prej tyre më tha: “Ky është poet, ka qënë nënë influencën tuaj, ju ka imituar etj”. Ay më tha: “e kam për nder të jem influencuar prej Lasgushit”. Unë: “s’ka influencë, nuk lot rol influenca në poezi, në krijimin artistik. Influencë, imitacion, plagjiat, reminiscencë, çdo referencë ose lidhje ose relacion etjerash si këto terma, nuk ekzistojnë në poezinë e vërtetë. Poezi e vërtetë quhet një poezi, e cila është origjinale. Poezi origjinale është ajo poezi, e cila, gjith dyke qënë tangjente me poezinë e tjetrit, e ka përdorur atë tangjente vetëm si material brut, si

lëndë e parë, por prej kësaj materjeje prima ka krijuar një origjinalitet fondi dhe forme dhe stili t’atillë, sa ajo del me atë origjinalitet të krijuar prej poetit, si një poezi më vete, si një krijim i ri, krijim që s’mund t’i-a gjesh shëmbëllën në tjetër poezi, sepse ajo tashi është një gjë më vete, një kontribut i ri në gjithë poezinë ekzistente. Me këtë origjinalitet, ajo e justifikon veten të ekzistojë midis similitarevetësaj, sikrejtindipendente. Similitar s’do me thënë identik, po kategori e veçantë dhe veçantinë e saj i-a kërkon origjinaliteti i saj, origjinaliteti fondi, forme, shprehjeje, stili, dhe sipër së gjithash konceptioni – të gjitha këto të pakraharsueshme aspak me poezi tjetër. Krijimi i ri nuk tutet prej krijimeve anës, d.m.th. prej similitareve, prej similitaritit. Këto dheshumë të tjerashpjegime i thashë poetit kosovar rreth imitacionit, influencës që siç tha ay tjetri kolegj i tij ishte prej Lasgushit. Ay (më vjen keq që s’ja mora emrin) mbeti i kënaqur, dhe fitoj kurajë prej shpjegimeve të mija, u duk nga fjalët që më tha pastaj

– dhe unë i thashë duke e kurajësuar zemërbardhësisht: “bëni poezi, krijoni poezi, mos kini frikë prej poezisë së Lasgushit, sepse duke qënë i zoti të krijojë njeriu poezinë e tij, origjinale, siç thamë s’trembet prej tjetrit. Ay që krijon një krijim të ri, nuk trembet prej tjetrit, sepse krijon një gjë të re. Si të trembet krijonjësi prej krijesës së tij, prej krijesës së tij të re, origjinale? Poeti, kur është i zoti të krijojë një poezi të re sipas këtij princip që është i vetmi princip poetik nuk ka frikë, s’trembet prej krijimit të tij, por përkundër, gëzohet dhe gëzohet me gëzim të madh, me gëzim të madh sepse i fal botës një gëzim të ri, një gëzim tjetër midis gëzimeve të tjera, dhe ay që i fal tjetrit një gëzim të ri s’trembet prej kësaj të falure prej kësaj dhurate po gëzohet me gëzim absolut për gëzimin absolut d.m.th. gëzimin origjinal që ay i fal të tjerëve nga zotësija e tij. Tashi ne mund të themi në këtë akord të tjera, po njësoj janë tërë të tjerat, esencial, ecenca e poezisë është poezia origjinale, d.m.th. origjinaliteti poetik.



Profile

OLEN ÇEZARI, ARTISTI GJENIAL NGA PIQER- ASI

Dëgjuesit e violinës së tij, kudo në botë, mahniten, jo vetëm nga mjeshtëria hyjnore e artit të Olen Qezarit, po edhe nga dhuntia e jashtëzakonshme e gjenialitetit të tij, që e nisi "rrugëtimin në udhën e bukur, po shumë të vështirë të artit"



Miho GJINI

Kushdo që e di se ekziston ky njeri që shprehet kështu, për humbjen e gjetjen e vetvetes dhe ky është Oleni me pesë germa, mjeshtri i violinës që prek telat e shpirtit njerëzor, si të ishte një i dërguar i Perëndisë, inspirues i humbjes së vetëdijes në rrokjen e të gjithë botës, të bën të heshtësh fare, të ulësh kryet a të thërrasësh si ai: "Ku jeni, o njerëz"?! Gjenial?! Unë nuk e kam quajtur veten në këtë mënyrë, -thotë ai ne një intervistë televizive në "Albania News", me shumë modesti. Ky është një përkufizim që ta cakton bota!...", duke kujtuar më pas gjithë "udhën e vështirë" të vetes, që nga fëmijëria e tij, jo fort e lumtur, kur ushtrohej me orë të tëra, për t'i dhënë "shpirt njerëzor" telave të violinës, tek vështronte fëmijët e tjerë nga dritarja e shtëpisë së tij në Durrës, kur ata loznin me top e brohorisnin, sa "çanin qiellin", gjersa të bëhej një "Qytetar i Botës", për ta duartrokitur

si artist të tij i gjithë Durrësi e Tirana, mandej Roma, Vjena, Nju Jorku, Rio De Janeiro, Parisi, Madridi e Salzburgu. Si në një film, ku madhështia fshihet pas thjeshtësisë së njeriut! Se ai, Olen Qezari, i kishte që të dyja, edhe humbjen e fëmijërisë e të rinisë, me heshtjen e vetvetes, që lidhej pazgjydhmërisht me punën e tij titanike që bënte në vetminë e tij, tepër i duruar, këmbëngulës e i heshtur, po edhe vlerën e madhe të fituesit, të ngadhënjimit në shkallët e dijes e të artit, si edhe të protestave individuale kundër së keqes, ndotjeve të atmosferës dhe të luftërave që gjymtojnë e vrasin njeriun me ëndrrat e së ardhmes. Se është edhe virtuoz si njeri, veprimtar i Paqes dhe një nga luftëtarët e parë kundër të gjitha llojeve të pandemive vdekjeprurëse e luftërave shkatërruese, si tani, kur bombat bien mbi qytetërimin ukrainas, mbi fëmijët e porosalindur e mbi pianofortet e violinat e artistëve të këtij vendi të lire, para se të jetë gjenial në muzikë, një Pag-

anin i dytë, që i bëri telat e violinës, të shpirtërohen e të njësohen, bashkë me shpirtin e tij prej artisti të lindur, me gjenialitetin e vet. Dhe ky djalë i mirë e pasionant, i thjeshtë e me plot humor, është nga një fshat i Jugut të Shqipërisë, nga Piqerasi ynë, ku mali puthet me detin e ku këndojnë zogjtë e panumërt nëpër degët e mandarinave erëshumë... Me "krahët hapur" tani nëpër botë, në përsosjen e njerëzimit, që duhet ta "rifilloj jetën nga muzika", thotë ai me zë të lartë! Po. Se jemi nga ata piqerasiotë që i kanë, po këtu "rrënjët e tyre", që marrin me këmbë gjithë "udhët e jetës" e që përsëri vijnë këtu, në vatanin e vet, me kulturën, artin e dashurinë e tyre ndër duar. Se gjithçka ka ndodhur, është bërë e nuk zhbëhet më. Nga që jemi lerë, po këtu, po edhe të shpërndarë në të gjitha skajet e rruzullit tokësor, qytet më qytet, fshat më fshat. Që nga Australia, në eks-tremim më jugor të Globit,-nga ku, një fshatari ynë i mërguar aty, plasi pa e parë Piqerasin tërë jetën e vdiq

rrugës, duke ardhur, që të vdiste po këtu,- e gjer në skajin më verior, në Kanada e Irlandë, apo atje më poshtë, në zemrën e tokës, nga kalon "meridiani i zjarrit", në Brazilin plotë Diell, tek ngrihet monumenti madhështor i Jezu Krishtit, mbi krahët e të cilit do të "këndoje Ave Maria" edhe violina magjepsëse e Olen Qezarit nga Piqerasi, duke u lutur për paqen, si në një meshë madhështore... Ai ka lindur në Durrës, më 4 shkurt të vitit 1975, po origjinën familjare, prej këndeje e ka, nga Qezarajt e Piqerasit, shtëpitë e të cilëve, rresh-tohen njëra pas tjetrës në "Rimin e Dedazve", sikundër e quanin dikur, rrugicën me kalldrëm që varret më të poshtë, deri në "Dedegjon", në sheshin e "Dedës (dhe) Gjonit", ngritur si puçkë mbi kodrinën nën ullinj, pas shtëpisë sime fundore, nga ku duket e gjithë hapësira e detit që nga malet e Llogorasë, ku shkrepin vetëtimat në dimër e gjer në ishujt e Korfuzit grek, më përtej detit, si të ishte një amfite-

atër i mbuluar nga qielli i "qëruar" a i kaltëruar si deti, që duket sikur shtrihet deri te këmbët e tua... "Dera e Qezare" ishte në Piqeras, fisi më i gjerë e më i kulturuar, që e kishte parë botën dhe që "botën" e kishte sjellë në Piqeras... Si kulturë po e po, por edhe si "art i të paraqiturit", si etikë e vlagë, emocioni i pashlyer i përsosmërisë së natyrës e të vetë jetesës së piqerasiotit mërgimtar, si bir i saj. Që të gjithë Qezarajt ishin kurbetllinj, venin e vinin nga vendet e tjera të Europës, deri më përtej, në Amerikë e Australi. Ndërsa Greqinë e Italinë e kishin "një vrap pele", duke vajtur andej me fellukat e varkat e tyre. Asnjërin nga Qezarajt nuk e shihje pa kostum veshur, kurdoherë elegantë, sqimatarë e të mençur. Ata ishin në një vëllazërim të përhershëm, edhe pse në "trungun familjar" qenë degëzuar, sipas kohës e rrjedhave të jetës. Edhe muret e shtëpive të tyre dykatëshe, i patën thujtë të ngjitura, si vazhdime të njëra-tjetrës, që nga shtëpia e Alie e deri në shtëpinë e Çeçe. Shtëpi të bukura nga brenda e nga jashtë, me avllira e oborre të bollshme, ku kundërmonthe vasilikoja, me çati të mbuluara me qeramidhe "galika" e me tavane nga brenda, të skalitura në dru, me disenjo, vizatime e tarikota të gdhendura me merak. Gjer tek mobiljet e sëndukët e sjella nga Korfuzi, Bari e Malta. Pënjëzërit, si ishin? Koço Qezari ngjante me aristokratët e vonë. Pavlo Qezari qe një ekonomist e financier që s'e kishte shokun e dytë, për nga mençuria. Petro Qezari qe një mjeshtrë tepër i zoti i elektronikës, që sapo kishte hyrë në Sarandë, bile edhe në fshatin tonë, nëpërmjet radiove dhe aparateve televizive. Niko Qezari e Kiço Qezari që përfunduan në Amerikë, e kishin "futur Amerikën" brenda shtëpiave të tyre. Këtë rrugë ndoqi edhe Stefan Qezari, gjyshi i Olenit, drejt Amerikës, i apasionuar pas aktrimit, duke

"shkelur" kështu ëndrrën hollivudiane. Ndërsa i biri, Roberto Qezari, u ngul në Durrës, duke u bërë inxhinier i zoti, krijoi aty familjen e tij, deri sa solli në jetë edhe këtë njeri gjenial të muzikës, që do të bënte për vete mijëra e mijëra spektatorë të botës së kulturuar, me artin e tij të interpretimit, përmes atyre telave të violinës, që e "fshehin botën", si me magji, me emocionet që i takojnë vetëm cicërimave të zogjve e melodive të tyre magjepsëse. Pa harruar të përmend, midis Qezarajve, vajzën e përjetshme, Lolën e famshme që shkëlqente në të gjithë Bregun, për bukurinë e saj po kaq magjepsëse, që, sikundër më thoshte nëna ime, "kështu qëndroi e mbeti Lola e Qezare, në tërë jetën e saj, si ikonë e bukurisë së rrallë dhe nuk u martua kurrë, ngaqë kërkonte e vazhdimisht kërkonte për jetën e saj burrin ideal, të bukur e të gjatë, pa "zorrë në bark", me elegancën e qeparizave! Si në një çmenduri përrallore përreth së bukurës, në kërkim të përsosmërisë hyjnore... Po, a nuk ishte një "çmenduri", koncerti i këtij artisti, i improvizuar mbi krahun e monumentit gjigand të Jezu Krishtit, midis tokës e qiellit, njeri prej projekteve spontane, spektakulare e të jashtëzakonshme të tij, pa lindur ende Dielli e kur njerëzit në Rio De Janeiro ishin ende në krahët e gjumit, që violinisti nga Piqerasi i priste atje që të zgjoheshin bashkë me diellin, përmes melodive të magjishme të instrumentit të tij, drejtuar "Marisë së shenjtë" atje lartë, ndërkohë që një vogëlushe mblidhte tufën e "luleshqerrave" atje poshtë, që t'ia shpjerë këtij artisti të "marrosur", i cili do të zgjonte e mahniste me artin e vet mbi një milion spektatorë brazilianë që u mblodhën vetiu atje, poshtë syrit të tij, të befasuar, kur violina i qe kthyer tashmë në një gjymtyrë të shpirtit dhe kameramani i shtrirë mbi krahun e "Birit të Perëndisë", filmonte këtë akt çmen-

durie të bukurisë e të përsosmërisë së Olen Qezarit, jo më pak të çmendur, tek qielli qe mbushur me zogj shtegtarë, si të ishin dhe ata spektatorë qiellorë, nga të tjera planetë?! "Përrjetova kështu çaste të rralla të jetës sime, humbjen e vetvetes, thotë artisti, tek shikoja nga "krahu i Krishtit" miliona spektatorë të vetëmbledhur, si me magji e midis tyre njerëz që qanin! O ZOT I MADH! Qe hera e parë që shoqëroja edhe lindjen e diellit me violinën time! Përrjetova i lumturuar njëherë nga shtatë mrekullitë që ka bota e që përbëjnë projektet e mia të së ardhmes, ëndërrimet e artit tim. Paskëtaj më pret mrekullia e "murit kinez", i tha ai mbesës piqerasiote Evi Reçi, gazetares së "Vizion Plus", tek drejtonte emisionin e saj "Jeta ime në tingujt e violinës" më 19 prill 2019... Dhe dëgjuesit e violinës së tij, kudo në botë, mahniten, jo vetëm nga mjeshtëria hyjnore e artit të Olen Qezarit, po edhe nga dhuntia e jashtëzakonshme e gjenialitetit të tij, që e nisi "rrugëtimin në udhën e bukur, po shumë të vështirë të artit", fëmijë 5-vjeçar, me koncertin e parë në publik dhe që, brenda moshës 18-vjeçare mbaroi tre konservatore të muzikës: në Tiranë, Romë e në Vjenë, si një talent gjenial, që i vjen tepër rrallë "Botës Muzikore"! Për t'u kurorëzuar edhe si interpretuesi më i mirë i Mozartit në Salzburg, ku edhe perfeksionohet si muzikant klasi nën drejtimin e Ruxhero Riçit! Dhe më pas, në një koncert me violinë me pjesë të Paganinit fiton çmimin Ndërkombëtar "Foyr des Artistes". Perfeksionimi i tij do të vazhdojë pa reshtur, sidomos në Amerikë, për muzikën klasike, po edhe për interpretimet në gjini të ndryshme muzikore (jazz, black, soul, hip-hop, rap, country), duke tërhequr kështu vëmendjen e kompozitorit Danny Elfman, me të cilin edhe do të bashkëpunoj me sukses. Rikthimi i

tij në Itali i referohet një veprimtarie muzikore të ngjeshur e akoma më të suksesshme, me programin "Partia Doppia" që drejtohej nga Pipo Baudo, me krijimin e grupit "Licbhaber Konzert Trio", së bashku me kitaristin Xhiusepe Pistoneve dhe flautisten Aleksandra D'Andrea, me interpretime nga repertori i Mozartit, Rossinit, Hajden, Debussy, Piazolla, Kurt e Weill. Ai do të jetë super aktiv në turne të vazhdueshme nëpër Itali, Zvicër, Portugali e gjetkë së toku me këngëtarë famozë si Luçio Dalla, Ana Oksa, Luka Barbammo, Veronika Lock e me shumë kantautorë të njohur, duke qënë me ta i pranishëm dhe në festivalin prestigjioz të Sanremos. Olen Qezari, sikurse njihet në publik, do të duket edhe në titrat e filmave artistik si kompozitor ("Italiani", "Nuk mbaron këtu", "Koha e dashurisë" dhe të një filmi të Peter Razait që fitoi çmimin e parë në Teksas për vitin 2005). Duke mos u mjaftuar me kaq, Oleni themelon Shtëpinë Diskografike "OLENART", boton albumin e parë muzikor "Befasime" me pjesëmarrjen e artistëve italianë, shqiptarë, amerikanë, brazilianë e tj. (ku përfshihet edhe këngëtarja jonë Elsa Lila), sidhe më pas, themelon Bandën Muzikore "Orkestra Internazionale Klandestine", me të cilën, në vitin 2009, zhvillon edhe një turne në Shqipëri, duke përfshirë në të sopranon Inva Mula dhe pianistin Genc Tukiçi. dhe një turne në Shqipëri, duke përfshirë në të sopranon Inva Mula dhe pianistin Genc Tukiçi. Po, ai do të njihet edhe si këngëtar, që do ta mahniste publikun e Romës me këngën shqiptare "Luleborë" e që do të çudiste pasagjerët e nxituar në aeroportin "Fiumicino", tek i binte violinës si muzikantët e varfër të rrugës, me maskë në fytyrë, si të bënte kështu edhe lutjen e fundme kundër Pandemisë,



si një "murtajë" shfarosëse që kishte zaptuar njerëzimin. Le të ishte edhe kështu, një njeri kundër së keqes shoqërore, qoftë edhe për pakëz buzëqeshje e kënaqësi shpirtërore. Pse të mos ishte edhe një gaztor si ai Charles Chaplini që thoshte se "dita më e humbur në jetë është dita kur nuk qeshim". Duke ia shpërblyer kështu, mundimin nënës së tij, mësueses së muzikës Lavdije Qezari, violinistes së papërtuar të shkollës së muzikës së Durrësit, dora e së cilës, për pesë vitet e para që e lidhur pazgjdhmërisht me dorën e këtij muzikantitëvogëletëmadh njëkohësisht, që vetë Perëndia ia kishte dërguar, për të emocionuar miliona fëmijë, burra, gra e pleq... Me magjinë përcjellëse të violinës së tij, ai arriti që të përplotë edhe sytë e spektatorëve më të rrallë të jetës së tij koncertale, të tre papëve të Vatikanit: Papës Pali II, Papës Rotzinger e Papës Françesko... Edhe koncerti madhështor i 12 artistëve shqiptarë, midis të cilëve Olen Qezari do të ishte Violina e Parë, shoqëruar në piano nga Genci Tukiçi e në praninë e sopranos shqiptare me famë botërore Inva Mula, me rastin e 500-vjetorit të Heroit tonë Kombëtar dhe zhvilluar po në Selinë e Vatikanit, përpara shenjtërisë së TIJ dhe Papatit, tek të cilët Skënderbeu ynë gjeti edhe mbështetjen si luftëtar -mbrojtës i krishterimit. Qe një event i rrallë ky koncert i paparë dhe madhështorë, ku artistët shqiptarë derdhën gjithë talentin e tyre e u këndoï zemra nga brenda. "Unë interpretoj kudo në botë, ka deklaruar violinisti ynë, po për mua, Tirana mbetet Tiranë". Ai ka dhënë këtu dy koncerte të mrekullueshme, me shumë dëshirë, duke derdhur ndër to gjithë talentin e tij si muzikant, më së tepërmi i linjës klasike e i asaj moderne, nga ku ndjehet temperamentin e tij jugor e mesdhetar, si gjithmonë energjik e pasionant, me spontanitetin e tij të veçantë e improvizues. Në shumicën e herës, pa i parë partiturat! Partiturat e autorëve më të mëdhenj botërorë, marrin jetë nuanca e shprehje të reja interpretuese. Pasi ai ka punuar mbi to me orë të tëra. "Që kur isha fëmijë, thotë mjeshtri Olen, ushtrohesh 4-6 orë në ditë, me violinën time të shtrenjtë, ndërsa kur më duhej të dilja përpara konkurrimeve koncertevendërkombëtare 8-10 orë në ditë". Gjerisa midis supit, e rrëzës së nofullës ravijëzohej në mavi ana fundore e instrumentit. Dhe vetëm atëherë violina e tij e dashur, mundej "të fliste" vetiu me të gjitha "gjuhët e botës". Melodia e tij violinistike sikur merr ngjyrat që ka ylberi, ka hapësirë e rrëmben shpirtit të panumërta njerëzish, duke u bërë vetiu e gjithëpushtetshme dhe e pavdekshme... Italianët, tashmë janë mësuar me të, ta quajnë edhe "të tyre" dhe, meqenëse Olen Qezari banon atje, e ngaqë germën Q e shqiptojnë me C, në versionin e italishtes, - do ta thërrasin përherë "Cesare" e jo pa veneracion, duke e paraqitur atë ndër eventet artistike që i realizon aq bukur si "Violinisti gjenial italo-albanëz", sikundër edhe e rrëfe-

jnë ata, në shumicën e rasteve. E që do ta ngatërronte njëren prej gazetareve tona televizive, se mos kishte të bënte gjë vërtetë me Perandorin Cezar a me dinastin e tij?! Një tjetër gazetar e tepron shakanë a padijen e tij, duke e pyetur artistin, me një ngasje shpotitëse fort të trashë se "Çfarë e ke Jul Qesarin"(?) dhe artisti, ia kthen "me të njëjtën "monedhe" se e kishte "kushëri të 17-të"... Po, le ta thërrasin si të duan, qoftë edhe me mbiemrin e Qesarit, perandorit të Romës, qoftë sikur ta quante edhe ai veten, me këtë "trill artistik", të pranuar nga kushdo artist modern i botës së kulturuar... Realisht ai është tani një shtetas italian, qysh kur mbërriti në Romë 14 vjeç djalë, për të përfunduar edhe Konservatorin e Shën Çeçilies në moshë 17 vjeçare. Por, deklaroi ai me krenari, "Unë kam në trungun gjeneologjik të familjes, gjurmë të hershme shqiptare, ashtu sikundër edhe greke e italiane, duke e ndër veten tipik mesdhetar, pra ndihem njëkohësisht si një "urë lidhëse" ndërmjet dy kombeve tona, shqiptar e italian, madje e konsideroj veten Ambasador të Kulturës Italo-Shqiptare", -përfundon Olen Qezari intervistën e tij të datës 28.11.2018 në kanal televiziv shqipar "Albania News". Dhe ja se ç'thonë ata që e kanë njohur nga afër atë e familjen e tij: Lefteria Lazri (Bitri): "Kam jetuar në Durrës, si shumë familje piqerasiote dhe e njoh mirë Roberto Qesarin, të atin e Olenit, sikundër e quajti gjyshja e tij, -mjeke pediatre e nderuar në Durrës, kur ai lindi me këmbë të mbarë. Babai i Robertit, Stefan Qesari, ishte nga fshati ynë, Piqerasi, po ai iku në Amerikë dhe e la djalin, vetëm me nusen e tij, pa u kthyer më". Rajmonda Kondi (Reçi), bijë Piqerasiote, Violiniste edhe ajo, me banim në Durrës gjithashtu, që e ka njohur Olenin dhe e përshëndet atë si "komshiun e saj" që i kishin dyert e të parëve të tyre, përballë njëra-tjetrës, thotë se "Oleni ishte një djalë i vogël, me një talent të madh. Mësimet e para i mori nga nëna e tij që ishte violiniste, po, mos të harrojmë se edhe gjyshi i tij, Fani, ishte aktor, që u largua nga Shqipëria e shkoi në Amerikë, në Hollivud..., pra, tek ky djalë, ishte, -si të thuash-, "damari i artistit" i trashëguar! Aq më tepër se, mamaja e tij, Lavdija, ishte violiniste, një mësuese muzike shumë e mirë, që nga duart e saj kanë dalë shumë violinistë të talentuar që sot janë kudo nëpër botë...". Sanije Hoti, -aktore e Teatrit "Aleksandër Moisiu" të Durrësit, - thotë se "unë Olenin e kam njohur shumë pak, kur ishte ende fëmijë dhe e ëma, Lavdija, e merrte çdo ditë për dore dhe e çonte te Shkolla e Muzikës". Dirigjenti Bujar Llapaj thotë se "Olen Qezari është një muzikant artist i kompletuar, sidomos në aftësinë e tij improvizuese që rrallë herë muzikantët e kanë! Po, për të mund të flasin më mirë Inva Mula e Genci Tukiçi". Ky i fundit, pianisti Genci Tukiçi, që kur ishte fëmijë, na befasoi me këngën "Bota Rrotullohet", shprehet: "Në vitin 2016 kam pasur fatin të luaj muzikë

së bashku me violinistin Olen Qesari, në qytetin e Vjenës, në Austri. Jam befasuar nga talenti gjenial i këtij muzikanti, i cili përtej instrumentit të violinës, transmeton emocione të forta. Ai është krijuar i pashtershëm, origjinal, vetvetja... Më pas, kam luajtur me Olenin në salla të ndryshme nëpër botë, ku ai elektrizon publikun. E konsideroj shumë të pjekur, por të ri në zanat dhe dua t'ju them të gjithëve: Prisni, ai nuk e ka zbuluar akoma "diamantin" e vërtetë". Ndërsa kantautori i famshëm italian Luçio Dalla shprehet kështu: "Oleni është një ndër artistët më të mëdhenj të botës. Muzika e tij ka shtrirje të gjërë dhe forcë magjike, me repertor nga gjigandët e muzikës klasike, me muzikë jazz, nga muzika popullore, në World Music". Kur unë vajta për herë të parë mbi tokën italiane, ku ndodhej dhe një "suazë piqerasiote", që 300 e ca vite më parë, pas ardhjes aty të 18 familjeve të fshatit tim dhe Mbreti Karl i III i Napolit pati mirësinë e fisnikërinë t'i sistemonte midis Romës, Chietit e Pescarës, do të dëgjoja të flitej edhe për Olen Qesarin. Me entuziazmin që më sillte nga Brindisi mikja ime Aksinja Xhoja, e bija e Nikolinit, i cili kishte lindur po aty, në Brindisi e unë sa kisha nisur që të shkruaja edhe një libër për të, sidomos pas furoreve që ai pati me xhirimin e filmimit "Kapadani", ku do të shkëlqente për origjinalitetin e tij të mëvetshëm. Figura e Nikolin Xhojes që bërë shumë e dashur edhe për fshatarët e mi, kur u xhirua ky film i këndshëm dhe Aksinja shtoi se, përveç meje, kishte dhe një mik tjetër të rrallë, po nga ky fshat i bukur, Olen Qesarin, violinistin e mrekullueshëm, i lindur edhe ai në Durrës e me të cilin, ajo si pianiste kishte realizuar me sukses të plotë në Itali edhe disa koncerte radhazi. Qe viti 2012 e unë, po e dëgjoja kështu për herë të parë emrin e tij, tok me sukseset e tij të para në tokën italiane, ku ishin strehuar shumica e shqiptarëve, pas ikjes së madhe, me numrin e tyre më të shumtë, nga ana e Greqisë, drejtë së cilës ne iknim edhe me këmbë, natën e ditën, të lemerisur nga zgjedha e rëndë e diktaturës. Frynte tani era e lirisë, e krijimit, e zgjedhjes dhe e shprehjes. Bile edhe e vdekjes tënde ku të doje, -sikundër gjeta edhe në varrezat e këtushme, që tre shekuj më parë, emra edhe nga fisi im Gjini, po edhe Qesari, nga ai i Olenit, që Villa Badessa ku unë kisha ardhur, u kishte krijuar edhe vendprehjen e mëtejshme, diku në anën më të bleruar të fshatit të tyre, i cili të kujtonte Piqerasin gjithashtu, në një pastërti e paqllëk njerëzor... Dhe atje do të ulesha në gjunjë pranë një pllake mermeri ku ishte shkruar emri i Milit e Qesare, nga dera e ish komshinjtë të familjes time të hershme, përbri varreve të Duke e të Silvestre! Po vitet, dekadat e shekujt "rrjedhin", si lumenjtë, tek gjurmët njerëzore mbeten si të gjalla! E, tek dëgjoja intervistën e parë të Olenit në Shqipëri, do më pëlqente shumë kur tha se ai ishtenjë "ambientalistiçmendur, mbi tokë e mbi det... kundër ndotjes që na kthehet mbrapsht edhe ndër tryezat

tonal!", do ta doja edhe më tepër këtë artist e njeri, i cili del jashtë vetes së vetë e mendon e lufton, i vetëdijshëm, për një jetesë normale, pas kënaqësive estetike e magjisë që të fal arti, me komunikimin e ndërsjellë... Do të njihesha kështu, së afërmi nga larg, me botën e gjerë shpirtërore të një njeriu të thjeshtë e zemërbardhë, me aftësi e dhunti të jashtëzakonshme, me të cilin mund të miqësohesh shumë shpejt e ai të të bëhet tepër i afërt me komunikimin e vet të natyrshëm, si edhe me një humor shpërfillës. Dhe disa projekte të bukura e të arrira artistikisht të tij takojnë çasteve në përditshmërinë e vet në rrugë, në kafene e restorante, apo në foajetë e sallat e koncerteve. Kështu, do të njihesha me një këngëtar të talentuar si Mandarinin, me të cilin do të bëheshin aq miq sa ta sillte atë edhe në Shqipëri, për një koncert të përbashkët, a t'ia linte paraqitjen e koncertit tjetër të radhës një gaztori të panjohur, që e takoi krejt rastësisht në një restorant të Tiranës. Është fjala për Bes Kallakun, me të cilin u bënë edhe miq, në jetë e në skenë. Pra, kemi të bëjmë me një artist të kudondodhur, me etikën më normale e të kulturuar të komunikimit, që di të kërkojë e menaxhojë vetë, midis artistëve e të realizojë atë që ai e quan "familja ime muzikore". Me devizën e tij origjinale që "t'i bëjë njerëzit të lumtur përmes muzikës", duke mos harruar asnjëherë se "duhet të luftosh për lirinë tënde". Që të fitosh dhe kurrë të mos humbasësh. Pa le të sakrifikohej për njerëzit, si Jezu Krishti! Me mesazhe të tilla ai do të kompozojë edhe këngën "Tërë jeta në një çast" që do të bëhet shumë e njohur, jo vetëm në Itali, po edhe në Kanada, Japoni, Hollandë, Belgjikë e kudo nëpër Europë. Si një artist poliedrik Oleni ideon edhe skenografinë e koncertit të tij famoz të viteve të fundit që ka si sfond kryesor detin. "Kam zgjedhur detin si kornizë të spektaklit sepse kam lindur në Durrës, por edhe për të sensibilizuar spektatorët për të respektuar mjedisin, për më tepër se atje, gjithnjë e më shumë po hapet në mënyrë tragjike varri i mijëra ikanakëve, por edhe rruga e shpresës për një jetë më të mirë për dhjetëra mijëra të tjerë. Këtyre njerëzve u dëktojë koncertet e mia", përfundon Olen Qezari mesazhin e tij human.... Kritika muzikore thekson se spektatorët e shumtë e përjetojnë, e ndjejnë dhe gëzohen me repertorin e Olen Qesarit (Qesari), në ato koncerte me intensitet të madh dhe me interpretimet me talent të rrallë, që tërheqin spektatorin në një atmosferë muzike që të emocionon, të mrekullon e të orienton drejt një "melting pot" zërash dhe ngjyrash. Duke filluar me notat e "Valles Hungareze" të Johnnes Brahms, duke vazhduar me "Tarantellën" e Rossinit, me këngët e bukura shqiptare. Oleni, me ritmet e melodive, të çon te Led Zappellini dhe Jimi Hendrix, nëpërmjet një udhëtimi magjiplotë muzike... I magjishëm edhe ai.

(Athinë, 2022)

NUMRI I ARDHSHËM MË 30 MARS

HEJZA

15 Mars, 2024

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:
Jeta Rexhepi - Shala & Rexhepi

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000